Gjithsej orë për arsimin profesional-teorik		**7**	**252**	**6**	**216**	**7**	**231**	
3.	TRAJNIMI PRAKTIK							**deri 40%**
3.1.	Mësim praktik	**7**	**252**	**13**	**468**	**15**	**195**	
3.2	Praktika feriale	**-**	**nga 10 deri 20 ditë**	**-**	**nga 10 deri 20 ditë**			
Gjithsej orë për aftësimin praktik		**7**	**252**	**13**	**468**	**15**	**195**	
Gjithsej orë (1+2+3)		**32 (34)**	**1152+36 (1224+36)**	**32 (34)**	**1152+36 (1224+36)**	**31 (33)**	**1023+33 (1089+33)**	

1 Një orë nga Sporti dhe aktivitetet sportive (nga viti i parë deri në të tretin) realizohet në kuadër të ekipeve sportive të shkollës dhe nuk përfshihet në orarin javor të orëve.

Plani mësimor për vitin e parë është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 08-10581/3, datë 31.08.2017, ndërsa plani mësimor për vitin e dytë dhe të tretë është miratuar nga

ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 12-1440/3, datë 12.02.2018. Zbatohet në klasat: 110, 209, 310.

Drejtimi: MAKINERI
Profili arsimor: MEKANIK I KAROSERISË (Program i reformuar)
Kohëzgjatja e arsimit: tre vjet

Nr. rendor	Fusha programore dhe lëndët mësimore	Viti dhe fondi i orëve						
		I		II		III		Përfaq. në %
		javë	vit	javë	vit	javë	vit	I - III
1.	ARSIMI I PËRGJITHSHËM							deri 40%
1.1.	Gjuhë dhe letërsi maqedonase, ndërsa për nxënësit e bashkësive të tjera: Gjuhë dhe letërsi shqipe, Gjuhë dhe letërsi turke ose Gjuhë dhe letërsi serbe	**3**	**108**	**3**	**108**	**3**	**99**	
(1.1.)	Gjuhë dhe letërsi maqedonase për nxënësit e bashkësive të tjera	**(2)**	**(72)**	**(2)**	**(72)**	**(2)**	**(66)**	
1.2.	Gjuha angleze	**2**	**72**	**2**	**72**	**2**	**66**	
1.3.	Histori	**2**	**72**	**2**	**72**			
1.4.	Informatikë	**2**	**72**					
1.5.	Matematikë	**3**	**108**	**2**	**72**	**2**	**66**	
1.6.	Fizikë	**2**	**72**	**2**	**72**			
1.7.	Art figurativ	**1**	**36**					
1.8.	Art muzikor	**1**	**36**					
1.9.	Sport dhe aktivitete sportive1	**2+1**	**72+36**	**2+1**	**72+36**	**2+1**	**66+33**	
Gjithsej orë për arsimin e përgjithshëm qytetar		**18 (20)**	**648+36 (720+36)**	**13 (15)**	**468+36 (540+36)**	**9 (11)**	**297+33 (363+33)**	
2.	ARSIMI PROFESIONAL-TEORIK							**deri 20%**
2.1.	Teknologjia e përpunimit	**3**	**108**					
2.2.	Bazat e makinerisë	**2**	**72**					
2.3.	Komunikimi teknik	**2**	**72**					
2.4.	Elektroteknikë dhe elektronikë			**2**	**72**			
2.5.	Motorë dhe automjete motorike					**2**	**66**	
2.6.	Teknologjia e autokaroserisë			**3**	**108**			
2.7.	Teknologjia e autolyerjes					**3**	**99**	
Gjithsej orë për arsimin profesional-teorik		**7**	**252**	**5**	**180**	**5**	**198**	
3.	TRAJNIMI PRAKTIK							**deri 40%**
3.1.	Mësim praktik	**6**	**216**	**14**	**504**	**16**	**528**	
3.2	Praktika feriale	**-**	**10 ditë**	**-**	**10 ditë**			
Gjithsej orë për aftësimin praktik		**6**	**216**	**14**	**504**	**16**	**528**	
Gjithsej orë (1+2+3)		**31 (33)**	**1116+36 (1188+36)**	**32 (34)**	**1116+36 (1118+36)**	**30 (32)**	**990+33 (1056+33)**	

1 Një orë nga Sporti dhe aktivitetet sportive (nga viti i parë deri në të tretin) realizohet në kuadër të ekipeve sportive të shkollës dhe nuk përfshihet në orarin javor të orëve.

Plani mësimor për vitin e parë është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 08-10581/3, datë 31.08.2017, ndërsa plani mësimor për vitin e dytë dhe të tretë është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 12-1440/3, datë 12.02.2018. Zbatohet në klasat: 111, 311.

Drejtimi: MAKINERI
Profili arsimor: MONTUES I MOTORËVE DHE AUTOMJETEVE MOTORIKE (Paralele duale)
Kohëzgjatja e arsimit: tre vjet

		Viti dhe fondi i orëve

Nr. rendor	Fusha programore dhe lëndët mësimore	I		II		III		Përfaq. në %
		javë	vit	javë	vit	javë	vit	I - III
1.	ARSIMI I PËRGJITHSHËM							deri 40%
1.1.	Gjuhë dhe letërsi maqedonase, ndërsa për nxënësit e bashkësive të tjera: Gjuhë dhe letërsi shqipe, Gjuhë dhe letërsi turke ose Gjuhë dhe letërsi serbe	**3**	**108**	**3**	**108**	**3**	**99**	
(1.1.)	Gjuhë dhe letërsi maqedonase për nxënësit e bashkësive të tjera	**(2)**	**(72)**	**(2)**	**(72)**	**(2)**	**(66)**	
1.2.	Gjuha angleze	**2**	**72**	**2**	**72**	**2**	**66**	
1.3.	Histori	**2**	**72**			**-**	**-**	
1.4.	Informatikë	**2**	**72**	**-**	**-**	**-**	**-**	
1.5.	Matematikë	**3**	**108**	**2**	**72**	**2**	**66**	
1.6.	Fizikë	**2**	**72**					
1.7.	Sport dhe aktivitete sportive	**2**	**72**	**2**	**72**	**2**	**66**	
Gjithsej orë për arsimin e përgjithshëm qytetar		**16 (18)**	**576 (648)**	**9 (11)**	**324 (396)**	**9 (11)**	**297 (363)**	
2.	ARSIMI PROFESIONAL-TEORIK							**deri 20%**
2.1.	Teknologjia e përpunimit	**3**	**108**					
2.2.	Bazat e makinerisë	**2**	**72**					
2.3.	Komunikimi teknik	**2**	**72**					
2.4.	Motorë dhe automjete motorike	**-**	**-**	**3**	**72**			
2.5.	Hidraulikë dhe pneumatikë te automjetet motorike	**-**	**-**	**3**	**72**			
2.6.	Elektroteknikë dhe elektronikë e zbatuar te automjetet motorike	**-**	**-**	**-**	**-**	**3**	**99**	
2.7.	Sisteme për ngrohje, ventilim dhe klimatizim te automjetet motorike					**2**	**66**	
Gjithsej orë për arsimin profesional-teorik		**7**	**252**	**6**	**144**	**5**	**165**	
3.	TRAJNIMI PRAKTIK							**deri 40%**
3.1.	Mësim praktik	**6**	**216**	**14**	**504**	**18**	**648**	
3.2	Praktika feriale	**-**	**min. 10 ditë**	**-**	**min. 10 ditë**			
Gjithsej orë për aftësimin praktik		**6**	**216**	**14**	**504**	**18**	**648**	
Gjithsej orë (1+2+3)		**29 (31)**	**1044+36 (1116+36)**	**29 (31)**	**972+36 (1044+36)**	**30 (32)**	**1110+33 (1176+33)**	

Plani mësimor është miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 13-2510/2, datë 10.03.2020. Zbatohet në klasat: 210, 312.

8.18. Biblioteka

Biblioteka e shkollës duhet të ketë rol të rëndësishëm në procesin mësimor të çdo mësimdhënësi dhe nxënësi. Kjo nënkupton përfshirjen e tyre në shumë aktivitete që organizohen gjatë vitit shkollor nga biblioteka. Biblioteka duhet të zërë vend qendror në procesin e të nxënit dhe ndjekjes së mësimit. Ajo nuk duhet të përdoret vetëm për leximin e literaturës dhe materialeve nga të gjitha lëndët, veçanërisht veprave letrare të detyrueshme. Përkundrazi, është hapësirë ku mund dhe

duhet të organizohen shumë aktivitete, ligjërata, prezantime dhe debate, për dhe nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

Biblioteka jonë është qendër bashkëkohore multimediale, e pajisur me pajisje kompjuterike dhe audiovizuale. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 90 m² dhe disponon më shumë se 20.000 ekzemplarë librash. Në fondin e saj biblioteka ka zhanre të ndryshme të letërsisë artistike maqedonase dhe të huaj, literaturë profesionale, botime letrare të detyrueshme, doracakë, fjalorë, tekste shkollore dhe lloje të tjera librash.

Fondi bibliotekar i shkollës përdoret nga nxënësit, mësimdhënësit dhe të punësuarit e tjerë sipas parimit të huazimit me kartelë biblioteke për një periudhë të caktuar. Në kuadër të bibliotekës ka hapësirë të parashikuar për lexim librash, mbajtjen e takimeve, trajnimeve, garave, prezantimeve etj.

Gjatë vitit shkollor 2026/2027 do të realizohen më shumë aktivitete, me çka do të arrihet efektivitet më i madh i bibliotekës së shkollës në funksion të procesit edukativo-arsimor. Vitin e kaluar biblioteka e shkollës mori përsëri donacion prej më shumë se një mijë e pesëqind librash dhe literaturë profesionale për nevojat e nxënësve dhe mësimdhënësve.

Plani i aktiviteteve në bibliotekën e shkollës:

Qëllimet	**Aktivitetet**	**Korniza kohore**	**Personi përgjegjës**
Të rritet numri i anëtarëve të bibliotekës	- Informimi i nxënësve për mënyrën e përdorimit të bibliotekës shkollore - Informimi i nxënësve për orarin e punës së bibliotekës - Informimi i nxënësve për llojin e fondit të bibliotekës	Në fillim të vitit shkollor	Bibliotekari Kujdestarët e klasave
Të pranohen botimet e porositura të lektyrave	- Të evidentohen në librin e inventarit - Të përgatitet një listë që do të vendoset në bibliotekë	Në fillim të vitit shkollor	Bibliotekari
Të rritet interesi i nxënësve për leximin e lektyrave	- Hartimi i listave me titujt e lektyrave për secilin vit veçmas - Vendosja e listave në vend të dukshëm në bibliotekë ose shpërndarja e tyre te mësimdhënësit e gjuhës amtare - Huazimi i lektyrave dhe literaturës tjetër të nevojshme për drejtimet profesionale	Në fillim të vitit shkollor dhe në fillim të gjysmëvjetorit të dytë Gjatë gjithë vitit shkollor	Bashkëpunimi i bibliotekarit me mësimdhënësit, veçanërisht të gjuhës maqedonase dhe shqipe Bibliotekari Bibliotekari
Të përmirësohet qasja në përmbajtjet e fondit të bibliotekës	- Vendosja e një kompjuteri të ri me program për evidencën elektronike të librave	Gjatë vitit shkollor	Bashkëpunëtori profesional për informatikë Bibliotekari
Të krijohet një dosje për mbledhjen e fotografive dhe videove që lidhen me shkollën	- Mbledhja e fotografive dhe videove të realizuara më parë nga vitet e kaluara, - informimi i mësimdhënësve për ekzistimin e të dhënave dhe mënyrën e përdorimit të tyre, - hartimi i procedurës për mënyrën e përdorimit të këtij lloji dosjeje.	Gjatë vitit shkollor	Bibliotekari, bashkëpunëtorët: mësimdhënësit, nxënësit, ekipi drejtues
Të nxitet interesi i nxënësve për lexim dhe huazim të librave nga biblioteka	- Lexim letrar i veprave të autorëve të njohur - Shpallja e lexuesit më të mirë të vitit	Në marrëveshje me mësimdhënësit e gjuhës maqedonase dhe shqipe, gjatë gjithë vitit Në fund të vitit shkollor (maj)	Mësimdhënësit e gjuhës maqedonase dhe shqipe Bibliotekari

Të zgjerohen njohuritë e nxënësve që i nënshtrohen Maturës Shtetërore, Maturës Përfundimtare ose që hartojnë detyra projektuese	- Sigurimi i literaturës së nevojshme dhe rol këshillues	gjatë vitit shkollor	Bibliotekari
Të bëhet porosia elektronike e teksteve shkollore	- Listë me numrin e përgjithshëm të nxënësve në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe, sipas paraleleve dhe drejtimeve. - Numri i teksteve shkollore të dëmtuara në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe.	në fund të vitit shkollor	Bibliotekari

8.19. Kujdestaria e klasës dhe ora e kujdestarisë

Gjatë viteve të fundit i kushtohet kujdes i veçantë cilësisë së kujdestarisë së klasës dhe temave për realizimin e orës së kujdestarisë. Ekzistojnë dokumente të veçanta programore që i rregullojnë këto aktivitete, ndërsa si pasqyrim i realizimit cilësor të rolit të kujdestarit të klasës mbahen dosje të veçanta për nxënësit e secilës klasë.

Në fokus të punës së kujdestarit të klasës për vitin shkollor 2026/2027 janë parashikuar tema që mbështesin gjithëpërfshirjen në arsim, zhvillimin e tolerancës multietnike, parandalimin e dhunës në shkollë dhe tema që nxisin vetëdijen ekologjike te nxënësit, si dhe tema që lidhen me përballimin e pasojave të pandemisë.

Kujdestari i klasës, përveç përmbajtjeve të propozuara në Programin Vjetor, është i obliguar që gjatë orëve të kujdestarisë të realizojë punëtori nga Edukimi për Shkathtësi Jetësore sipas rekomandimit të BZHA-së, duke përdorur doracakun që gjendet në bibliotekën e shkollës.

Plani i përmbajtjeve për orën e kujdestarisë:

Muaji	**Java**	**Përmbajtja**
Shtator	**E para**	Njohja me dispozitat e Statutit të shkollës dhe Kodin e sjelljes së nxënësve Njohja me udhëzimet për shqiptimin e masave pedagogjike Kontrolli i dokumentacionit të nxënësve të regjistruar Dhënia e orarit të mësimit Caktimi i nxënësve kujdestarë në paralele dhe shkollë – obligimet dhe detyrat
	E dyta	8 Shtatori – Dita e Pavarësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut
	E treta	Zgjedhja e bashkësisë së klasës Diskutim për përballimin e pasojave të pandemisë
	E katërta	Debat me temë: „Multikulturalizmi – pranimi i dallimeve“ Aktivitete të rregullta në paralele
Tetor	**E para**	5 Tetori – Dita e Mësimdhënësit Informimi për rolin e Shërbimit Profesional
	E dyta	11 Tetori – Dita e Kryengritjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut Nxitja e nxënësve për pjesëmarrje në punën e klubeve shkollore Aktivitete të rregullta në paralele dhe ndërmarrja e aktiviteteve për masa pedagogjike
	E treta	23 Tetori – Dita e Luftës Revolucionare Maqedonase 24 Tetori – Dita e Kombeve të Bashkuara
	E katërta	Krijimi i shprehive për jetë të pavarur Si të arrijmë vetëbesim më të madh? Kujdesi për shëndetin dhe mirëmbajtja e higjienës personale.
Nëntor	**E para**	Debat me temë: „Diskriminimi gjinor“ – punëtori për shkathtësi
	E dyta	13 Nëntori – Çlirimi i Qytetit të Shkupit

	E treta	Plagjiatura – mbrojtja e pronësisë intelektuale
	E katërta	Çfarë është përgjegjësia shoqërore?
Dhjetor	**E para**	Java Botërore e Luftës kundër Varësive – debat me temë: „Varësia nga droga dhe alkooli“ – punëtori për shkathtësi jetësore
	E dyta	Mbrojtja e të dhënave personale – punëtori
	E treta	Debat me temë: „Roli i familjes në jetën e të rinjve“
	E katërta	Ekologji – kursimi i energjisë dhe ujit – punëtori për shkathtësi
	E pesta	Punëtori për mbrojtjen e shëndetit nga virusi COVID-19
Janar	**E treta**	Analiza e suksesit dhe viiueshmërisë në qivsmëvietorin e parë
	E katërta	Etika – çfarë është morali?
Shkurt	**E para**	Nxitja e nxënësve për pjesëmarrje në projekte dhe aktivitete të lira: „Çfarë është aktivizmi rinor?“
	E dyta	Debat – „Si ta përmirësoj suksesin dhe sjelljen?“
	E treta	Shmangia e situatave konfliktuale – punëtori për shkathtësi
	E katërta	Zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj njerëzve dhe jetës.
Mars	**E para**	Rëndësia e fjalës dhe mesazheve që u dërgojmë njerëzve.
	E dyta	8 Marsi – Dita e Gruas; 7 Marsi – Dita e Mësuesit Shqiptar
	E treta	Debat me temë: „Humanizmi“
	E katërta	21 Marsi – Dita e Ekologjisë, Dita e Pemës
Prill	**E para**	Shëndeti para së gjithash
	E dyta	Analiza e arritjeve në tremujorin e tretë dhe njoftimi i nxënësve
	E treta	21 Prilli – Patronati i shkollës
	E katërta	Punëtori krijuese – promovimi i vlerave humane
Maj	**E para**	Mbrojtja nga viruset – higjiena
	E dyta	Parandalimi i dhunës në shkollë – punëtori për shkathtësi jetësore
	E treta	Kujdesi për ndërtesën dhe oborrin e shkollës
	E katërta	24 Maji – Dita e Arsimtarëve Gjithësllavë
	E pesta	31 Maji – Dita Botërore Kundër Duhanit
Qershor	**E para**	Organizimi efikas i kohës së lirë gjatë pushimit veror
	E dyta	Marrëveshje për aktivitetet përfundimtare

Kujdestari i klasës ka mundësi ta ndryshojë temën e orës së kujdestarisë sipas nevojave specifike dhe individuale të nxënësve të klasës. Rekomandohet realizimi më i shpeshtë i punëtorive nga fusha e Edukimit për shkathtësi jetësore. Kujdestarët e klasave mund të kërkojnë mbështetje nga Shërbimi profesional për realizimin e ligjëratave dhe punëtorive për tema të caktuara për të cilat Shërbimi profesional është më i kualifikuar. Për shembull: „Edukimi seksual“, „Varësitë nga droga dhe alkooli“, „Pa paragjykime ndaj nxënësve me nevoja të veçanta arsimore“ etj.

8.20. Zbatimi i TIK-ut në mësimdhënie

Të gjithë mësimdhënësit përdorin kompjuterë gjatë realizimit të mësimit. Format më të shpeshta të mësimit me TIK janë prezantimet, interneti, simulimet etj. Zakonisht, gjatë realizimit të mësimit klasik, pak mësimdhënës përdorin programe ose aplikacione të veçanta për temën përkatëse. Shpesh realizojnë testim elektronik të njohurive të nxënësve. Mësimdhënësit dërgojnë materiale ose adresa ku nxënësit mund të përgatiten për orën, si dhe përdorin forma të tjera komunikimi me nxënësit dhe prindërit. Të gjithë mbajnë E-ditar. Më shumë se 30% e mësimit realizohet në mënyrë elektronike, ndërsa mësimdhënësit përdorin kompjuterë së paku 4-6 orë në javë. Dy herë në vit, secili mësimdhënës, në kuadër të aktivit profesional, prezanton realizimin e një përmbajtjeje mësimore me TIK në mënyrë veçanërisht krijuese, në organizim të përgjegjësit të fushës mësimore, për çka hartohen raporte dhe mbahet portofol. Mënyra dhe intensiteti i zbatimit të TIK-ut në mësimdhënie do të varen nga udhëzimet e organeve shtetërore kompetente për vitin e ri shkollor.

Fusha mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit	Dëshmi
Fusha mësimore profesionale 25 mësimdhënës nga 2 orë	50	Nga 2 gjatë një muaji	Raport Instrument për ndjekje Përgatitja për orën mësimore
Fusha mësimore kulturor-gjuhësore 13 mësimdhënës nga 2 orë	26	Nga 2 orë çdo muaj	Raport Instrument për ndjekje Përgatitja për orën mësimore
Fusha mësimore natyrore-matematikore 14 mësimdhënës nga 2 orë	28	Nga 2 çdo muaj	Raport Instrument për ndjekje Përgatitja për orën mësimore
Fusha mësimore shoqërore-humanitare 18 mësimdhënës nga 2 orë	36	2–4 orë në muaj	Raport Instrument për ndjekje Përgatitja për orën mësimore

Në Shkollë është i punësuar një bashkëpunëtor profesional për teknologji kompjuterike, i cili përveç mirëmbajtjes së kompjuterëve jep kontribut të madh në mësimdhënie dhe u ofron mësimdhënësve logjistikë dhe mbështetje për zbatimin e TIK-ut në mësimdhënie.
Shtojcë: Programi për mbështetjen me TIK të procesit arsimor

8.21. Plani për realizimin e mësimit në distancë/mësimit nga shtëpia

QSHA „Boro Petrushevski“ e Qytetit të Shkupit ka përgatitur Plan për realizimin e mësimit në distancë/mësimit nga shtëpia, nëse paraqitet nevoja. Sa i përket orarit për realizimin e mësimit online/mësimit në distancë/mësimit nga shtëpia, ai harmonizohet me orarin e rregullt të shkollës me qëllim realizimin e suksesshëm të planeve dhe programeve mësimore. Është e dëshirueshme që ora online të realizohet përmes lidhjes konferenciale me mjete/platforma të komunikimit elektronik dhe të komunikohet vazhdimisht me nxënësit, me qëllim mbështetjen e tyre të gjithanshme në këtë situatë specifike shoqërore. Mësimdhënësit kanë obligim të përshtaten shpejt dhe në mënyrë efikase me situatën specifike dhe t'i përshtatin në mënyrë adekuate përmbajtjet dhe materialet për realizimin e mësimit në distancë/mësimit nga shtëpia.

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për situatë në të cilën nevojitet mbështetje shtesë psikologjike, sociologjike dhe pedagogjike për nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit, Shërbimi profesional i shkollës është në dispozicion të tyre dhe vepron në koordinim me mësimdhënësit lëndorë dhe kujdestarët e klasave, me qëllim mbështetjen e nxënësve dhe prindërve në procesin e të nxënit dhe të jetesës.

Shkolla tregon kujdes të veçantë për arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Të gjithë mësimdhënësit, në bashkëpunim me edukatorin special dhe rehabilituesin dhe ekipin gjithëpërfshirës, u përgjigjen nevojave individuale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, me qëllim që ta përvetësojnë sa më me efikasitet materialin përmes mësimit në distancë/mësimit nga shtëpia.

Për nxënësit që janë të përjashtuar socialisht dhe nuk kanë mundësi të sigurojnë kompjuter për ndjekjen e mësimit në distancë, shkolla siguron kompjuterë të përdorur, tableta dhe laptopë. Këta nxënës kanë përgjegjësi t'i kthejnë pajisjet në shkollë pas përfundimit të vitit shkollor. Ky program lindi si rezultat i pandemisë, por përvoja tregon se çdo shkollë e përkushtuar duhet të ketë një plan të tillë në rast se paraqitet nevoja.
Në shtojcë: Plani për realizimin e mësimit në distancë/mësimit nga shtëpia

9. AKTIVITETET JASHTËMËSIMORE

9.1. Klubet sportive shkollore

Me iniciativë dhe mbështetje të Qytetit të Shkupit funksionon Klubi sportiv i QSHA-së, përmes të cilit do të realizohen aktivitetet për formimin e klubeve të futbollit dhe basketbollit dhe organizimin e garave ndërshkollore, pjesëmarrjen në të gjitha manifestimet sportive të qytetit dhe republikane, si

dhe zhvillimin e alpinizmit, çiklizmit etj. Në shkollë formohen edhe ekipe hendbolli që marrin pjesë në manifestimet e qytetit. Të gjithë nxënësit marrin pjesë edhe në krosin pranveror dhe vjeshtor në Kejin e Vardarit.

Çdo vit shkolla merr pjesë në garat e Lidhjes së Sportit të Shkollave të Mesme të Qytetit të Shkupit dhe organizon stërvitje për përgatitjen e ekipeve që do të marrin pjesë në gara. Mësimdhënës përgjegjës janë Enver Miftari, Marjan Karapandzhevski, Artan Zeqiri, Robert Nestorovski dhe Krste Vojneski, ndërsa koha e realizimit të këtij aktiviteti programor do të përcaktohet pasi të merret kalendari i garave.

9.2. Aksionet e nxënësve dhe vullnetarizmi

Gjatë këtij viti shkollor, shkolla do të zbatojë praktikën e punës vullnetare për nxënësit e shkollës dhe jashtë saj, mësimdhënës-vullnetarë dhe kuadro të tjera, me qëllim nxitjen e dashurisë dhe qëndrimit pozitiv ndaj punës, si dhe krijimin e shkathtësive dhe përvojës së punës.

Vullnetarët dhe vullnetarizmi në çdo shtet paraqesin potencial të madh njerëzor që mobilizohet vazhdimisht dhe posedon njohuri e shkathtësi relevante, të dobishme për bashkësinë. Përmes punës së tyre, vullnetarët kontribuojnë në ndërtimin e kapitalit shoqëror dhe njerëzor, rritjen e përfshirjes së qytetarëve në zhvillimin shoqëror dhe zgjidhjen e problemeve dhe nevojave të ndryshme të njerëzve në mjedisin e tyre. Vlera që ata krijojnë dhe ndërtojnë në aktivitetet e tyre është e paçmueshme, sepse ka cilësi të veçantë të pasuruar me dimensionin human të vullnetit të mirë dhe altruizmit. Nga kjo lindi ideja që aktivitete të këtij lloji të organizohen dhe realizohen edhe në kuadër të QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup.

Veprimtaritë plotësuese në qendrën tonë krijojnë mundësi për fitimin e përvojës vullnetare dhe të përvojës së punës për të gjithë nxënësit e shkollës. Ekipi menaxhues ka ardhur në idenë që, përmes një programi përkatës, nxënësve t'u mundësohet punë vullnetare sipas nevojave të shkollës. Përmes këtij programi, nxënësve do t'u mundësohet që nëpërmjet veprimtarive plotësuese që ofron Qendra t'i zhvillojnë aftësitë e tyre në drejtime të ndryshme. Përmes afirmimit dhe avancimit të vullnetarizmit do të kenë mundësi t'i zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale.

Në shkollën tonë, që nga viti 2007, funksionon Qendra e Karrierës, përmes së cilës nxënësit kanë dhe do të kenë mundësi të edukohen dhe të zhvillohen profesionalisht. Përmes ndjekjes së trajnimeve për vullnetarizëm dhe fitimit të përvojës së punës në disa fusha, ata do të aftësohen për punësim të ardhshëm dhe do të fitojnë përvojë praktike. Në këtë mënyrë do të zhvillohen aftësitë komunikuese dhe aftësitë për punë ekipore te nxënësit, gjë që do t'ua lehtësojë hyrjen në tregun e punës në të ardhmen.

Mënyra e përzgjedhjes së nxënësve-vullnetarë: Vullnetarizmi është ofrimi vullnetar i shërbimeve personale, njohurive dhe shkathtësive ose kryerja e aktiviteteve të tjera në dobi të personave, organeve, organizatave ose institucioneve të tjera, pa kompensim. Vullnetar është personi fizik vendor ose i huaj që kryen punë vullnetare. Në kuadër të Qendrës së karrierës, përmes trajnimeve që ndjekin, nxënësit njihen dhe do të njihen me programin e vullnetarizmit, realizimin dhe zbatimin e tij. Veçanërisht do të theksohet se vullnetarizmi si proces zhvillohet mbi bazë vullnetare. Të gjithë nxënësit e shkollës do të informohen për këto aktivitete përmes njoftimeve, për mënyrën e aplikimit, selektimit, rekrutimit dhe përzgjedhjes së vullnetarëve. Nëse ndonjë nxënës shpreh interes për vullnetarizëm në një nga veprimtaritë plotësuese të Qendrës, këtë do të mund ta realizojë në marrëveshje me drejtorin e Qendrës dhe personin përgjegjës për veprimtarinë përkatëse.

Puna vullnetare do të realizohet në përputhje me Ligjin për vullnetarizëm - „Gazeta Zyrtare“ nr. 82/2007. Angazhimi dhe puna e tyre do të stimulohen sipas marrëveshjes ndërmjet vullnetarit dhe shkollës. Të drejtat dhe obligimet individuale të vullnetarëve dhe organizatorëve të punës vullnetare do të përcaktohen në Marrëveshjen për vullnetarizëm.

Qëllimet e Programit:

Qëllimet kryesore:

- afirmimi dhe avancimi i vullnetarizmit te nxënësit;
- promovimi i vullnetarizmit dhe sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm;
- promovimi dhe forcimi i angazhimit vullnetar të nxënësve në QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup.

Qëllimet e përgjithshme të Programit:

- mundësi më të mëdha për punësimin e nxënësve;
- forcimi i bashkëpunimit me kompani dhe institucione;

- nxitja e aktiviteteve që përmirësojnë mundësitë për zhvillimin personal dhe profesional të nxënësve;
- përmirësimi i shkathtësive komunikuese të nxënësve;
- forcimi i ndjenjës së përkatësisë.

Qëllimet konkrete të Programit:

- futja e përmbajtjeve edukative dhe aktiviteteve praktike në kuadër të Programit të vullnetarizmit;
- krijimi i mekanizmave për nxitjen e angazhimit vullnetar të nxënësve të QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup;
- nxitja e kulturës së vullnetarizmit në kuadër të sistemit arsimor;
- bashkëpunimi i ndërsjellë i nxënësve të përfshirë në Program;
- aftësimi i nxënësve për hyrje në tregun e punës përmes vullnetarizmit;
- fitimi i përvojës në vullnetarizëm;
- shkëmbimi i përvojave dhe praktikave ndërmjet nxënësve të përfshirë në Program.

Aktivitetet përmes të cilave do të realizohet Programi:

- mbajtja e trajnimeve për tema që lidhen me vullnetarizmin;
- mbajtja e punëtorive për tema që lidhen me vullnetarizmin;
- punëtori - zhvillimi i aftësive komunikuese te nxënësit dhe puna ekipore;
- pyetësor anketues për vullnetarizmin;
- ditë të përcaktuara për vullnetarizëm;
- marrëveshje për vullnetarizëm;
- librezë vullnetare.

Rezultatet e pritshme:

- përhapja, zhvillimi dhe forcimi i kulturës së vullnetarizmit;
- nxënësit t'i kuptojnë përfitimet nga vullnetarizmi;
- nxënësit të aftësohen për punë përmes vullnetarizmit;
- nxitja e vetëbesimit te nxënësit;
- interesim më i madh i punëdhënësve për vullnetarizëm dhe më pas edhe për punësimin e nxënësve tanë;
- informim më i mirë për mundësitë e vullnetarizmit.

Rezultatet do të përmbajnë analizë të zbatimit të aktiviteteve, informacione për qëllimet e arritura dhe rekomandime për ndryshimin dhe përshtatjen e Programit dhe Planit të Veprimit me gjendjen dhe nevojat.

9.3. Veprimtari dramatike, muzikore, figurative dhe ngjarje të tjera

Përmes seksionit të dramës dhe recitimit, nxënësit do të pasurohen me njohuri dhe shkathtësi të reja nga fusha e dramaturgjisë. Ata aftësohen për interpretim të talentuar të fjalës artistike. Në veçanti u zbulohet talenti për artin skenik, lëvizjen, të folurit dhe improvizimin. Kjo nxit te nxënësit shpikshmërinë dhe kreativitetin (mësimdhënëse përgjegjëse: Silvija Mitrevska Filipova).

Përmes Seksionit multimedial „Vozit në QSHA“, nxënësit marrin pjesë në incizimin e videove, mesazheve dhe filmave të shkurtër për promovimin e Shkollës gjatë vitit shkollor (mësimdhënës përgjegjës: Koce Tapshanovski).

Manifestimi kryesor është Dita e Hapur e Shkollës, e cila ka për qëllim promovimin e Shkollës dhe ku të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit kanë rol në përgatitjen dhe realizimin e ngjarjes.

Përmes Klubit të oratorëve - të folurit publik, te nxënësit përmirësohen shkathtësitë komunikuese, fitohen shprehi dhe shkathtësi pozitive për të folur dhe nxitet fryma garuese. Organizohet mbrëmje oratorie ku nxënësit garojnë në të folurit publik. Bartëse është Lençe Tomova, ndërsa bashkëpunëtorë: Silvija Mitrevska-Filipova, Koce Tapshanovski, Bunjamin Osmani, Valdeta Kasapi;

Me të gjitha këto aktivitete kontribuohet në edukimin e plotë dhe afirmimin e nxënësve në shkollë.

9.4. Aktivitetet e lira të nxënësve - seksionet

Me qëllim nxitjen dhe kultivimin e kreativitetit dhe entuziazmit te nxënësit, mbështetjen e qëndrueshmërisë dhe këmbënguljes, krijimin e kushteve për zhvillimin e personalitetit të nxënësit dhe

krijimin e shprehive për organizim të mirë të kohës së lirë, në shkollë organizohen aktivitete jashtëmësimore të qasshme për çdo nxënës.

Këtë vit në shkollë do të funksionojnë disa seksione në lëndë të ndryshme, të cilat do të përfshijnë elemente të orientimit profesional të nxënësve në lidhje me interesin e shfaqur për lëndën konkrete. Për aktivitetet e tyre do të dorëzojnë programe dhe raporte për punën e realizuar.

Nr. rendor	SEKSIONI/ FUSHA	QËLLIMET DHE AKTIVITETET
1.	**Seksioni elektromekanik**	Fokusin e vet do ta drejtojë në përgatitjen e nxënësve për Maturën Shtetërore, përgatitjen për gara, kuize të njohurive, sigurinë në punë dhe zbatimin e praktikumeve. Këndi hulumtues – laborator për elektroteknikë dhe elektronikë; lidhja e këndit hulumtues me teorinë dhe praktikën; hartimi i udhëzuesit për përgatitjen e nxënësve për garat shtetërore; trajnim i nxënësve për të drejtat, obligimet dhe sigurinë gjatë mësimit praktik dhe punës në punëtori; punë sipas planit të veprimit për mirëmbajtje; Dita e Hapur; përgatitje për garën ndërkombëtare „Automekaniku i ri evropian 2027“ në Shkup. Gjenerimi i energjisë elektrike nga sistemet e frenimit te automjetet hibride/elektrike. Organizimi i konkursit për ide inovative nga fusha e industrisë së automobilave. Aktivitete në kuadër të iniciativës „Mësimi përmes punës“. Krijimi i strategjisë ekologjike në nivel shkolle. Përgatitja e nxënësve gjatë hartimit të punimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në gara shtetërore. Punë me nxënësit për përgatitjen e detyrave projektuese për vitet përfundimtare dhe nxitja e përgjegjësisë, kreativitetit dhe saktësisë. Hulumtim në revista online për automjete elektrike, me mundësi për hulumtim dhe mbledhje të informatave më të reja nga fusha e makinerisë. Rregullim i vazhdueshëm i tabelës interaktive për realizimin e ushtrimeve nga Mësimi Praktik dhe grupi i lëndëve të elektroteknikës. Përzgjedhja e ushtrimeve nga Elektroteknikë dhe diagnostikimi i automjeteve motorike (zbatimi i teorisë në praktikë). Realizimi i një aksioni ekologjik në QSHA „Boro Petrushevski“ – Shkup dhe selektimi i mbeturinave. Aktivitete të vazhdueshme për manifestimin shkollor me automjete motorike (hartimi i maketeve ose modifikimi i një automjeti që do të ishte karakteristik nga pamja dhe do të shërbente për nevojat e politikës së regjistrimit). Njoftimi i zjarrfikësve, policisë dhe Kryqit të Kuq për nevojat e manifestimit me automjete; takime të vazhdueshme me nxënësit.
2.	**Seksioni i drejtimit të komunikacionit**	Seksionet shkollore ekzistojnë për nxënësit e tyre. Përmes këtyre seksioneve nxënësi e njeh veten dhe aktivitetet që dëshiron t'i bëjë. Aktivitetet në seksione zhvillohen brenda dhe jashtë klasës. Mësimdhënësit që drejtojnë Seksionin e Komunikacionit fillimisht i njohin nxënësit me Programin e seksionit, mënyrën e punës dhe protokollin e realizimit të detyrave. Bëhet përzgjedhja e nxënësve të interesuar. Së bashku me nxënësit përcaktohen ditët dhe orari i aktiviteteve. Përzgjidhen nxënës për gara ndërkombëtare, rajonale dhe shtetërore. Përzgjedhja e nxënësve për kuizin e Vitit të Ri dhe fillimi i përgatitjes së tyre. Pjesëmarrja në thirrjen e Fondit për Inovacion „SFIDË PËR HULUMTUESIT E RINJ – PROJEKTE TË GJELBRA“. Formimi i një seksioni të komunikacionit me përmasa ndërkombëtare dhe program të përbashkët (R. e Serbisë, R. e Kroacisë, R. e Malit të Zi). Formimi i një ekipi nxënësish për program pilot për përmirësimin e transportit urban në Qytetin e Shkupit (numërimi i udhëtarëve, analiza e statistikave një ditë në javë për periudhë 2-mujore). Shënimi i sinjalizimit horizontal në QSHA. Kuiz-garë ndërmjet nxënësve të vitit të parë për sjelljen në komunikacion me biçikletë. Përgatitja e nxënësve gjatë hartimit të punimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në gara shtetërore. Punë me nxënësit për përgatitjen e detyrave projektuese për vitet përfundimtare dhe nxitja e përgjegjësisë, kreativitetit dhe saktësisë. Bashkëpunim me MPB-në – aktivitete me njësinë shkollore të komunikacionit. Përmirësimi i sinjalizimit nga hyrja e shkollës sonë, nga ura drejt shkollës, me qëllim rritjen e sigurisë.

3.	**Seksioni për mbrojtje nga zjarri**	Zhvillimi i kulturës së mbrojtjes nga zjarri dhe fitimi i shprehive për ndërmarrjen e masave mbrojtëse, përmes ushtrimeve, aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në gara.
4.	**Seksioni i ndihmës së parë**	Aftësimi i nxënësve për dhënien e ndihmës elementare dhe vetëndihmës.
5.	**Seksioni i matematikës**	Punë me nxënësit e talentuar dhe përgatitja e tyre për pjesëmarrje në garën „Kangur“, si dhe në garën ndërshkollore të organizuar nga Qyteti i Shkupit, dhe përgatitja e nxënësve për Maturën Shtetërore. Punë e vazhdueshme shtesë me nxënësit e talentuar dhe përgatitje intensive për pjesëmarrje në gara të ndryshme, si dhe përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore.
6.	**Seksioni i mësimit praktik**	Përgatitja e nxënësve për garat shtetërore dhe ndërkombëtare të njohurive nga mësimi praktik (diagnostikimi i defekteve në grupet dhe nëngrupet e automjeteve dhe eliminimi i tyre, plotësimi i këndit hulumtues, hartimi dhe përdorimi i mjeteve demonstruese dhe maketeve). Hartimi i maketeve ose modifikimi i një automjeti me pamje karakteristike që do të shërbente për nevojat e politikës së regjistrimit. Përgatitja e nxënësve gjatë hartimit të punimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në gara shtetërore.

9.5. Klubet dhe organizatat e nxënësve

Në shkollë do t'i kushtohet kujdes avancimit të punës së **klubeve të nxënësve**.

Nr. rendor	Klube/ organizata	Qëllimet dhe aktivitetet
1.	**Klubi i oratorëve**	Qëllimet e të folurit publik janë: përmirësimi i shkathtësive të komunikimit, fitimi i shprehive dhe shkathtësive pozitive për të folur, nxitja e frymës konkurruese. Të folurit publik është format i strukturuar dhe proaktiv i të folurit që përdoret për komunikim, informim, prezantim dhe bindje të një grupi më të vogël ose më të madh dëgjuesish. Të folurit publik dhe oratoria konsiderohen ndër shkathtësitë më të vlerësuara në shoqërinë bashkëkohore.
2.	**Klubi i fizikanëve të rinj**	Intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike përmes punës së përbashkët në projekte nga fusha e fizikës.
3.	**Klubi i informatikës**	Punë e vazhdueshme me nxënësit e talentuar dhe përsosja e aftësive të tyre në fushën e informatikës. Siguria e të dhënave gjatë përdorimit të internetit dhe komunikimit përmes rrjeteve sociale.
4.	**Klubi Automoto QSHA**	Aktivitete dhe plan veprimi për punën e Klubit Automoto QSHA për realizimin e Ditës së Hapur përmes „Tubimit të automjeteve, oldtajmerëve dhe motoçikletave“ nga e gjithë Maqedonia e Veriut dhe më gjerë, natyrisht nëse ekzistojnë kushtet për këtë.
5.	**Bendi i shkollës**	Formimi i bendit të shkollës, i cili do të marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e organizuara në kuadër të shkollës sonë.
6.	**Klubi i Kryqit të Kuq**	Zhvillimi i ndjenjës së humanizmit, solidaritetit dhe tolerancës përmes aksioneve të dhurimit të gjakut dhe trajnimeve për dhënien e ndihmës dhe vetëndihmës.
7.	**Klubi ekologjik**	Nxitja e vetëdijes ekologjike te nxënësit në drejtim të mbrojtjes së mjedisit përmes aktiviteteve të vazhdueshme gjatë gjithë vitit.
8.	**Klubi multimedial**	Qëllimi themelor është afirmimi i shkollës dhe zhvillimi i saj i vazhdueshëm, si p.sh. hartimi i videove të shkurtra për reklamimin e shkollës.

Rëndësi të veçantë në shkollë kanë Organizata rinore dhe Këshilli i nxënësve, të cilët trajtohen si trupa shkollorë.

9.6. Organizata rinore TREND

Organizata rinore në shkollë funksionon prej shumë vitesh dhe është një hapësirë e shkëlqyer për kreativitet, udhëheqje dhe demokraci në jetën e nxënësve. Përmes aktiviteteve dhe projekteve të shumta të planifikuara, edhe këtë vit do ta pasurojë jetën e nxënësve, do të merret me çështje më thelbësore që lidhen me jetën e të rinjve në shkollë dhe kontributin e tyre në bashkëpunimin ndërshkollor. Organizata rinore është e orientuar drejt rrjetëzimit të aktiviteteve shkollore në kuptim të ngushtë dhe të gjerë, organizon aktivitete humanitare dhe manifestime nga fusha e kulturës dhe ka krijuar marrëdhënie me institucione dhe OJQ. Arritjet e saj janë aktuale dhe publikohen në mënyrë transparente në rrjetet sociale.

Qëllimi themelor është afirmimi dhe njohja e punës rinore, ndjekja, vlerësimi, avancimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i saj, me qëllim sigurimin e mbështetjes cilësore, efikase dhe efektive për të rinjtë. Anëtarët e Organizatës rinore janë të përfshirë në realizimin e të gjitha aktiviteteve në shkollë.

Plani i aktiviteteve në kuadër të Organizatës rinore - TREND për vitin 2026/2027

Koha	Aktivitetet	Realizuesit
Shtator–tetor	**<u>Organizata rinore – Trend</u>** - Misioni - Qëllimet - Struktura organizative - Zgjedhja e udhëheqjes së OR – Trend - Formularët për aplikim - Intervistimi dhe vlerësimi - Hartimi i Planit Vjetor të Veprimit për punë	Lenche Tomova, S. Mitrevska-Filipova; Udhëheqja e OR – Trend
Nëntor–dhjetor	**<u>Aftësitë komunikuese</u>** - Qëllimet dhe përkufizimi - Llojet e komunikimit - Gjuha e trupit	Lençe Tomova Nxënësit nga viti I deri IV
Nëntor–dhjetor	**Të folurit publik – trajnim** - Përgatitja dhe shkrimi i fjalimit - Artikulimi i zërit - Gjuha e trupit - Kontakti me sy - Të folurit para publikut – ushtrim **Mbrëmje oratorie** Garë e brendshme e kandidatëve dhe përzgjedhja e nxënësve që do të marrin pjesë në garën e të folurit publik në kategoritë (fjalim i përgatitur, fjalim i improvizuar)	Lenche; Nxënësit nga viti I deri IV L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova, B. Osmani,

10. ORGANIZIMI DHE PJESËMARRJA E NXËNËSVE

Bashkësia e klasës është qeliza bazë e organizimit të nxënësve, ku secili nxënës ka zë. Në orën e parë të kujdestarisë zgjidhet udhëheqja: kryetari, i cili e përfaqëson klasën, udhëheq mbledhjet dhe është anëtar i Këshillit të nxënësve ; zëvendëskryetari, i cili ndihmon në organizim dhe e zëvendëson kryetarin kur ai mungon; dhe anëtari.

Mbledhjet mbahen një herë në javë gjatë orës së kujdestarisë, së bashku me kujdestarin e klasës.

Këshilli i nxënësve është trup i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha klasave në shkollë, përkatësisht nga një përfaqësues (kryetari) i secilës klasë.

Udhëheqja e Këshillit: kryetar, zëvendëskryetar dhe sekretar (zgjidhen në mbledhjen e parë konstituive), me mandat njëvjeçar shkollor dhe me të drejtë rizgjedhjeje.

Aktivitetet e Këshillit të nxënësve ndahen sipas periudhave kryesore të vitit.

Avokati i nxënësve mbron të drejtat e nxënësve dhe promovon barazinë.

Materialet e nevojshme dhe burimet financiare do të sigurohen nga buxheti i shkollës ose nga donacione, sponsorizime, projekte etj.

Shtojcë:

Plani i punës së Këshillit të nxënësve

Plani i punës së Avokatit të nxënësve

11. AKTIVITETET JASHTËSHKOLLORE

11.1. Ekskursionet e nxënësve

Në bazë të Programit vjetor të punës së Shkollës hartohet programi për ekskursionet shkollore, sipas Rregullores për realizimin e ekskursioneve shkollore në shkollat e mesme, të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës më 04.08.2025.

Me Programin vjetor të punës së Shkollës përcaktohen plani dhe përmbajtja e ekskursioneve, të cilat nënkuptojnë realizimin e pjesëve të planit dhe programeve mësimore.

Për vitin shkollor 2026/2027 janë planifikuar dy ekskursione njëditore në Qytetin e Shkupit, ku do të përfshihen nxënësit e vitit të parë dhe të dytë.

Me pëlqimin me shkrim të prindërve dhe sipas rregullores së dhënë nga MASH-i, shkolla mund të organizojë ekskursion shumëditor jashtë vendit. Iniciativën për ekskursion duhet ta japin kujdestarët e klasave të një viti të arsimit, të cilët së bashku me Shërbimin Profesional do të jenë pjesë e ekipit profesional që, me vendim të Bordit të Shkollës, do të përgatisë program të veçantë për ekskursionin e vitit aktual shkollor.

Për këtë program fillimisht do të sigurohet mendim nga Këshilli i prindërve. Programi duhet të miratohet nga Bordi i Shkollës. Ekipi profesional do të ketë obligim të hartojë Kodin e Sjelljes gjatë ekskursionit dhe të sigurojë të gjitha deklaratat nga nxënësit dhe prindërit. Ekskursioni do të realizohet duke respektuar të gjitha dispozitat e RREGULLORES për ekskursionet shkollore të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Për nxënësit që nuk marrin pjesë ose nuk shkojnë në ekskursion, shkolla organizon mësim të rregullt.

Nr. rendor	Ekipi për krijimin e programit	Lloji i aktivitetit jashtëshkollor	Viti/paralelja	Termini i planifikuar	Personi përgjegjës
1.	Kujdestarët e klasave dhe Shërbimi profesional	Tema dhe përmbajtje nga programet mësimore	Viti i parë dhe i dytë	tetor	Drejtori
2.	Kujdestarët e klasave dhe Shërbimi profesional	Sport dhe rekreacion	Viti i parë dhe i dytë	prill	Drejtori

Për planin e paraqitur më sipër, ekipi do të hartojë program dhe plan për realizimin e ekskursioneve.

11.2. Të dhëna për nxënësit e përfshirë në aktivitete jashtëshkollore

Procedura për mbledhjen e të dhënave

- Shpërndarja e pyetësorëve: Kujdestarët e klasave ua shpërndajnë anketat nxënësve.
- Mbledhja e informatave: Regjistrohen të dhëna për sportin, artin dhe prirjet profesionale.
- Afati urgjent për vitin e parë: Të dhënat për nxënësit më të rinj mblidhen menjëherë.

Sistematizimi i të dhënave

- Klasifikimi sipas llojit: Aktivitetet ndahen në sportive, artistike dhe edukative.
- Numërimi dhe kuantifikimi: Përcaktohet numri i saktë i nxënësve sipas aktivitetit.
- Grupimi sipas gjeneratës: Të dhënat renditen sipas vitit të shkollimit.
- Përditësimi i bazës: Të gjitha informacionet futen në regjistrin digjital të shkollës.

12. GARAT E NXËNËSVE

12.1. Pjesëmarrja në gara komunale, rajonale, shtetërore, olimpiada dhe gara ndërkombëtare

Nr. rendor	EMËRTIMI	NIVELI	Lënda/fusha	Pjesëmarrësit/viti	Procedura e përzgjedhjes	VENDI

1.	Automekaniku Evropian Junior 2027	Garë ndërkombëtare	Makineri	Viti i tretë	Garë shkollore	Shkup, nikoqir
2.	Ndihma e parë	Nivel qyteti	/	Të gjitha vitet	Garë shkollore	Shkup
3.	„Kangur“	Nivel qyteti	Matematikë	Të gjitha vitet	Garë shkollore	Shkup
4.	Garë në komunikacion dhe makineri	Garë shtetërore	Makineri, Komunikacion	Viti i tretë	Garë rajonale	Do të vendoset në vijim
6.	„Mbrojtja kundër zjarrit“	Nivel qyteti	/	Të gjitha vitet	Garë shkollore	Shkup
7.	Histori	Garë shtetërore	Histori	Të gjitha vitet	Garë rajonale	Shkup
8.	Biznes	Garë shtetërore - „Ndërmarrje me përgjegjësi sociale“ Junior Achievement.	Ekonomi	Të gjitha vitet	Garë rajonale	Shkup
9.	Automekanikë	Garë ndërkombëtare	Makineri	Viti i tretë	Garë shkollore	Sarajevë, Bosnjë
10.	Garë e shkathtësive	Garë shtetërore	Makineri	Të gjitha vitet	Garë rajonale	Shkup

13. AVANCIMI I MULTIKULTURALIZMIT/NDËRKULTURALIZMIT DHE INTEGRIMIT NDËRETNIK

Plani vjetor global i punës së Ekipit për integrim shkollor në shkollën e mesme është i harmonizuar me standardet gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore, me fokus të veçantë në integrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësve nga mjedise sociale të cenueshme, si dhe nxënësve që përballen me barriera kulturore ose gjuhësore.

Shkolla jonë është dygjuhëshe dhe integrimi mbi bazë ndëretnike ka rëndësi të madhe për krijimin e klimës së mirë dhe pranimin e ndërsjellë të nxënësve dhe mësimdhënësve. Me iniciativë të Qytetit të Shkupit dhe mbështetje të USAID-it, OSBE-së dhe QAME-së, shkolla jonë është përfshirë në një projekt që do ta thellojë integrimin ndëretnik në sistemin arsimor. Projekti i quajtur „Integrimi Ndëretnik i të Rinjve në Arsim“ ka filluar tashmë me parime të reja reformuese që çojnë drejt afrimit më të madh të nxënësve nga përkatësi të ndryshme etnike. Shkolla jonë është pjesë e programit për arsim të integruar, i cili filloi në vitin shkollor 2018/2019 dhe në të ardhmen do të intensifikohet. Orët e integruara dhe të përbashkëta në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe do të zhvillohen në çdo nivel arsimor, së paku me një çift mësimdhënësish, me qëllim që nxënësit e përfshirë në këtë projekt të afrohen me njëri-tjetrin dhe të forcojnë ndërveprimin. Një nga qëllimet e këtyre orëve të përbashkëta në mësimin e rregullt është avancimi i kompetencave ndërkulturore të nxënësve dhe mësimdhënësve.

Plani i veprimit për aktivitetet e integrimit ndëretnik të të rinjve në arsim

Fusha	*Aktivitetet*	*Përshkrim i shkurtër i aktivitetit*	*Realizuesit (sipas grupmoshave)*	*Termini (nga/deri)*
1. Bashkëpunimi i mësimdhënësve në planin profesional	- shkëmbim i materialeve dhe përvojave profesionale në nivel aktivi - diseminime	- shkëmbim i përgatitjeve, detyrave dhe materialeve - trajnime të brendshme nga fusha të ndryshme	- Të gjithë mësimdhënësit në aktivet e tyre	- gusht–shtator - janar (pushimi dimëror)
2. Aktivitete të përbashkëta me nxënësit	- vizita në objekte fetare, muze dhe teatro - vizita në shkolla të tjera	- shoqërim i nxënësve përmes vizitave në objekte	- Mësimdhënës dhe nxënës nga të gjitha vitet	- tetor - nëntor - në vazhdimësi - prill

	- punëtori - manifestim	- bashkëpunim me nxënës nga shkolla të tjera - punëtori interaktive ku nxënësit do të mësojnë, zhvillohen dhe komunikojnë - promovim i veprave artistike, muzikës, filmit, ushqimit...	- Mësimdhënës me nxënës nga viti II dhe IV - Mësimdhënës dhe nxënës nga të gjitha vitet	
3. Projekte me bashkësinë lokale	- punëtori në bashkëpunim me bashkësinë lokale (MPB) - përmes projektit „Ndërtojmë ura të reja“ në bashkëpunim me OSBE-në, do të themelohet radio shkollore	- punëtori për parandalim në tema të ndryshme - orë të përbashkëta - punëtori interaktive për përgatitjen e materialeve që do të prezantohen përmes radios së shkollës.	- Përfaqësues nga MPB-ja dhe bashkësia lokale me nxënësit	- Në vazhdimësi
4. Përfaqësimi i ikonografisë multikulturore	- vitrina, pano, postera	- rregullimi dhe përditësimi i vitrinave nga Aktivi shoqëror-humanitar - hartimi i panove dhe posterave me nxënës të përkatësive të ndryshme etnike	- Mësimdhënësit dhe nxënësite të gjitha viteve	- Në vazhdimësi
5. Bashkëpunimi me prindërit	- aktivitete si pjesë e Këshillit të prindërve - punëtori - pjesëmarrës aktivë në manifestim	- informata dhe prezantim i aktiviteteve - nxitje për të menduar mbi tema të ndryshme	- Prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit	- Në vazhdimësi - Prill
6. Orë të përbashkëta të integruara në të gjitha nivelet arsimore dhe në lëndë të ndryshme, në kuadër të mësimit të rregullt	- Aktivitete për përgatitjen e orëve dhe realizimin e tyre	- Përgatitja e përbashkët e planeve ditore, përgatitja e aktiviteteve për realizimin e orëve	- Mësimdhënësit në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe	- Në vazhdimësi
7. Iniciativë për avancimin e kompetencave ndërkulturore te nxënësit me mbështetje nga Qyteti i Shkupit	- Krijimi i idesë dhe realizimi i aktiviteteve - planifikimi dhe realizimi i orëve të përbashkëta mësimore në mësimin e rregullt. - organizimi i një debati të hapur rinor në nivel të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit	- Ekipi për integrim ndëretnik dhe arsim multikulturor do të iniciojë avancimin e kompetencave ndërkulturore	- Mësimdhënësit në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe	- Në vazhdimësi

	- prezantimi i praktikave më të mira për integrimin ndëretnik në arsim - ditë të ndërkulturës (koloni artistike, ekspozita fotografike, ngjarje muzikore, lexime poetike, aksione humanitare, turne sportive, punëtori krijuese) - nisja e iniciativave rinore nga Bashkësia e Shkollës, - punëtori multikulturore dhe ndërkulturore, punëtori për pjesëmarrje demokratike, të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijës dhe edukim për paqe.			
8. Trajnime/kurse gjuhësore për mësimdhënësit në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe	- Përgatitja e planit për kursin fillestar	- Planifikimi i orëve, përgatitja dhe realizimi	- Mësimdhënësit në gjuhën mësimore shqipe	- Pushimi dimëror dhe veror
9. Ndjekja dhe vetëvlerësimi i shkollës (sigurimi i cilësisë dhe udhëheqja e dokumentacionit përkatës)	- Anketa dhe fletëvlerësime	- Anketimi i mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve	- TË GJITHË	- Në vazhdimësi
10. Promovimi i aktiviteteve të realizuara	- Artikuj në revista - Faqja e internetit - Prezantim përfundimtar	- Prezantimi i aktiviteteve të realizuara	- Mësimdhënësit dhe nxënësit	- Në vazhdimësi - Prill
11. Planifikimi i të gjitha aktiviteteve jashtëmësimore në kontekst të projektit për integrim ndëretnik dhe arsim multikulturor	- Planifikimi i aktiviteteve	- Realizimi i aktiviteteve	- Të gjithë mësimdhënësit	- Në vazhdimësi

Shtojcë: Programi vjetor i punës së Ekipit për integrim shkollor

14. PROJEKTET QË REALIZOHEN NË SHKOLLËN E MESME

14.1. Projektet kombëtare

14.1.1. Projekti „Siguria ime varet nga unë“

Në organizim të Qytetit të Shkupit, MPB-së dhe MASH-it: prezantime, punëtori dhe diskutime për përcaktimin e dhunës psikike dhe fizike (përjashtim, injorim, kërcënim, frikësim, përgojim, mbajtje armësh të ftohta dhe të zjarrit; prezantim i videove me sjellje të dhunshme të grupeve të tifozëve; dhunë seksuale, dhunë në internet dhe mënyrat e përballimit).

14.1.2. „Integrimi Ndëretnik i të Rinjve në Arsim“

Qyteti i Shkupit, USAID-i, OSBE-ja, MASH-i dhe Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar - QMEQ, si bartëse e projektit, gjatë vitit 2026/2027 do të realizojnë aktivitete që dalin nga Strategjia për integrim ndëretnik dhe përfshirje qytetare. Aktivitetet do të realizohen sipas planit të parashikuar të veprimit të propozuar nga Qyteti i Shkupit.

Gjatë këtij viti shkollor do të intensifikohet arsimi i integruar, me orë të përbashkëta në lëndë të caktuara në të gjitha vitet e shkollimit.

14.1.3. Projekte në kuadër të „Arsimit për Punësim në Maqedoninë e Veriut“

Projekt i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, me qëllim modernizimin e procesit arsimor.

14.1.4. Projekti „Lojërat e Shkollave të Mesme 2025“

Projekt në organizim të Qytetit të Shkupit dhe SFERA Shkup, me qëllim edukimin dhe promovimin e ndërtimit të stileve të shëndetshme të jetesës te të rinjtë - realizues: mësimdhënësit e sportit dhe aktiviteteve sportive.

14.1.5. Projekte të mbështetura nga Qyteti i Shkupit

Qyteti i Shkupit tradicionalisht mbështet projekte, aktivitetet e të cilave do të realizohen gjatë vitit 2026/2027. Këto projekte janë të orientuara drejt realizimit të këtyre qëllimeve programore të Qytetit të Shkupit në fushën e arsimit:

- QIEMI për TË GJITHË: Program për zhvillim në karrierë, barazi gjinore dhe promovim të profesioneve të aviacionit, në bashkëpunim me „Shoqatën për Aviacion më të Mirë AVIKON“ - Shkup.
- Të rinj aktivë dhe të shëndetshëm - zhvillim krijues dhe shkathtësi jetësore, në bashkëpunim me shoqatën „Për të rinjtë në OKV“.
- Kush është kllouni këtu - shfaqje teatrore kundër bullizmit, në bashkëpunim me „Shoqatën për Kulturë TEATRI ALTERNATIV TË PËRJASHTUARIT“ - SHKUP.
- Mbështetje psikologjike falas për nxënësit, parandalim i dhunës dhe sëmundjeve të varësisë, në bashkëpunim me „Shoqatën për persona me pengesa të kombinuara në zhvillim - Asociacioni Gaspar“.
- Me biçikletë dhe trotinet kudo nëpër Shkup, në bashkëpunim me „Shoqatën për motivim kulturor KULTIVATOR“ - Shkup.

Ndihmë psikosociale për anëtarët e këshillit të shkollës për përballimin e formave të ndryshme të dhunës, në radhë të parë dhunës kibernetike, e cila u bë aktuale gjatë mësimit në distancë.

Edukimi dhe promovimi i ndërtimit të stileve të shëndetshme të jetesës te të rinjtë përmes forcimit të vetëdijes së nxënësve të shkollave të mesme dhe publikut më të gjerë për përgjegjësinë personale në mbrojtjen e shëndetit të tyre fizik, psikik, seksual dhe riprodhues.

Hulumtimi dhe promovimi i barazisë gjinore, të drejtave dhe lirive të nxënësve dhe zhvillimit të kreativitetit te nxënësit.

Avancimi i mjedisit jetësor përmes ngritjes së vetëdijes së nxënësve të shkollave të mesme për përgjegjësinë personale në ruajtjen e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm.

Organizimi i manifestimeve ku do të prezantohen arritjet e shkollës, do të promovohen nxënësit më të mirë dhe do t'i prezantohen publikut më të gjerë rezultatet e veprimtarisë edukativo-arsimore.

14.2. Erasmus+ dhe projekte të tjera ndërkombëtare

Një nga aktivitetet e veçanta zhvillimore-inovative të drejtorit për këtë vit shkollor, ndër të tjera, është ndjekja e qendrave profesionale moderne evropiane me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Një nga karakteristikat tipike të QSHA „Boro Petrushevski“ është zhvillimi i politikave të orientuara drejt bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar. Në këtë drejtim, edhe këtë vit shkolla do të zhvillojë dhe mirëmbajë marrëdhënie me shumë shtete evropiane, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale në shkollë. Ato janë:

- Është dorëzuar aplikim për projekt nga programi K1 i Erasmus+ në kuadër të akreditimit që shkolla e ka fituar për periudhën 2021-2027. Projekti ka të bëjë me mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe aftësimin praktik të mësimdhënësve (job shadowing) (koordinatorë: Snezhana Bozhinovska-Risteska dhe Jovan Jonovski).
- **Titulli i projektit: Project 101240715 BELONGtoEU, ERASMUS-JMO-2025-NETWORKS-SCHOOLS. Koordinator i këtij projekti është APRO FORMAZIONE SOCIETA CONSORTILE A RESPONSABILITA LIMITATA** nga Alba, Itali. Në këtë projekt QSHA „Boro Petrushevski“ e Qytetit të Shkupit është partner së bashku me katër shkolla të tjera partnere nga Italia, Anglia, Spanja dhe Estonia. Projekti do të zgjasë tre vjet dhe do të kontribuojë në rritjen e vetëdijes së të rinjve për përkatësinë ndaj Bashkimit Evropian. Për këtë vit është parashikuar trajnim i mësimdhënësve në Bruksel (koordinatorë: Snezhana Bozhinovska-Risteska dhe Jovan Jonovski).
- **Projekti i akreditуar 2026-1-MK01-KA121-VET-000435672 Accredited projects for mobility of learners and staff in vocational education and training (KA121-VET).** Ky projekt është vazhdim i akreditimit për projektet ERASMUS+, i cili zgjat deri në vitin 2027, për mobilitet të nxënësve dhe trajnim të mësimdhënësve (koordinatorë: Snezhana Bozhinovska-Risteska dhe Jovan Jonovski).
- **ALPE ADRIA SkillME Challenge:** ME-TRONICS HUBS, projekt i ri në të cilin jemi partner asociativ me QAP-in dhe që ka të bëjë me shkëmbimin e përvojave praktike për nxënës dhe mësimdhënës nga mekatronika dhe industria automobilistike, me kohëzgjatje prej 4 vjetësh.
- Presim edhe së paku 2 projekte me Turqinë, të cilat do të realizoheshin në gjysmën e dytë të vitit shkollor 2026/27.

14.3. Projekte të përgjegjësisë shoqërore dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Projektet për këtë vit shkollor në fakt janë vazhdim i projekteve të brendshme të vitit të kaluar:

Emri i projektit	Thelbi dhe qëllimet e projektit
„Zhvillimi profesional i mësimdhënësve“	Hartimi i planit shkollor për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në bazë të planeve individuale për zhvillim profesional. Mbajtja e portofolit të mësimdhënësve dhe ndjekja e zhvillimit të tyre profesional, pjesëmarrja në trajnime, seminare, konferenca e të ngjashme. Organizimi i trajnimeve të brendshme që tradicionalisht realizohen gjatë pushimit dimëror.
„Mentorimi i nxënësve“	Ndihmë dhe mbështetje për nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe me nevoja të veçanta, duke i dhënë kështu një dimension të ri mësimit plotësues me grupe të veçanta nxënësish. Arritjet e nxënësve do të jenë bazë për motivimin dhe nxitjen e mësimdhënësve, përkatësisht mentorimi i nxënësve do të bëhet pjesë e mentorimit të mësimdhënësve, veçanërisht në pjesën e shpërblimit.
„Mentorimi i mësimdhënësve“	Projekt që vazhdon me të njëjtin intensitet si vitet e kaluara. Përmes projektit bëhet shkëmbimi i ideve dhe përvojave ndërmjet mësimdhënësve të aktiveve profesionale. Klima organizative e bashkëpunimit ndërmjet mentorëve dhe mësimdhënësve është në nivel të lartë. Mësimdhënësit e rinj e pranojnë lehtë projektin, ndërsa efektet janë të dukshme.
„Shënimi i datave dhe personaliteteve të rëndësishme“	Afrimi i nxënësve, bashkëpunimi dhe komunikimi i ndërsjellë, zhvillimi i shkathtësive hulumtuese.
„Shkolla krijuese – këndi hulumtues“	Nxitja e frymës krijuese te nxënësit përmes ushtrimeve praktike dhe lidhjes së teorisë me praktikën – grup mësimdhënësish nga drejtimi elektromekanik.

„Riciklimi dhe selektimi i mbeturinave“	Hartimi i strategjisë dhe përgatitja e aktiviteteve për mundësinë e riciklimit dhe selektimit të mbeturinave në QSHA „Boro Petrushevski“ – Shkup dhe përfitimet nga zbatimi real.
„23 Prilli – Dita Botërore e Librit dhe e të Drejtave të Autorit“	Aktivitete për informimin e nxënësve.

Shtojcë: Procedura për realizimin e projekteve në shkollë

Përveç projekteve shumëvjeçare, në shkollë do të realizohen edhe aktivitete të vogla të brendshme projektuese në funksion të politikës strategjike të shkollës për kreativitet, efektivitet, bashkëkohësi dhe praktikë, në formë detyrash projektuese, prezantimesh, referatesh, hulumtimesh, garash dhe vizitash në kuadër të aktiveve:

DETYRA PROJEKTUESE	Detyrë projektuese me temë: „Siguria e nxënësve në komunikacion“; hulumtim me temë „Matematika dhe natyra“; detyrë projektuese me temë „Zbatimi i gjeometrisë në jetën e përditshme“; detyrë projektuese me temë „Ndikimi i rrjeteve sociale në jetën e përditshme të të rinjve“; hulumtim me temë „Ikosaedri“; detyrë projektuese për dukuritë shoqërore të dëmshme në shtet; detyrë projektuese me temë „Familja bashkëkohore, stilet e jetesës, lidhja ndërmjet martesës dhe familjes“; detyra projektuese për revolucionarët maqedonas; detyrë projektuese për Bashkimin Evropian; detyrë projektuese me temë „Përfitimet nga anëtarësimi në BE“.
REFERATE	Shënimi i „5 Tetorit – Dita Botërore e Mësimdhënësit“, Ditës së Pavarësisë së RMV-së – 8 Shtatori, „11 Tetorit – Dita e Kryengritjes së popullit maqedonas“, „23 Tetorit – Dita e Luftës Revolucionare Maqedonase“, „24 Tetorit – Organizata e Kombeve të Bashkuara“, „13 Nëntorit – Dita e Çlirimit të Shkupit“, „21 Prillit – Patronati i shkollës“, Ditës së arsimtarëve shqiptarë, Ditës së Ekologjisë, Ditës së Librit, ditëve të poezisë dhe prozës maqedonase. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Matematikës dhe hulumtime me temë „Numri PI“; shënimi i Ditës së Falënderimeve; shënimi i festave të kulturave të tjera; „22 Nëntori – Dita e Alfabetit Shqip“; shënimi i Ditës së Arsimtarëve Maqedonas; „7 Marsi – Dita e Mësuesit Shqiptar“; shënimi i Ditës së Alfabetit Maqedonas; Dita e Nënës dhe e Babait; Migjeni – jeta dhe vepra; referat dhe prezantim për Holokaustin; shënimi i 22 Prillit – Dita e Planetit Tokë; referate dhe prezantime INFO: „Goce Dellçev“, „9 Maji – Fitorja mbi fashizmin“ dhe „Dita e BE-së“.
PREZANTIME, PANO DHE PUNËTORI	Përgatitje për realizimin e ideve inovative në kuadër të teknologjisë së automobilave. Prezantim për nxënësit e viteve përfundimtare për përdorimin e mototesterit. Hartimi i ushtrimeve auditoriale dhe laboratorike. Prezantime për nxënësit për përdorimin e osciloskopit digjital për testimin e sinjaleve elektrike në automjete (në vazhdimësi tetor–prill). Hulumtim dhe mbledhje e informatave më të reja për inxhinierinë e transportit dhe komunikacionit. Prezantim për nxënësit për matjen, montimin dhe lidhjen e elementeve 12V në automjete (bateri, starter, alternator), testimin e sensorëve dhe përdorimin e pajisjeve diagnostikuese dhe osciloskopit (në kuadër të orëve praktike nga Testimi dhe diagnostikimi). Prezantimi i ideve inovative dhe shqyrtimi i mundësive për realizim. Analiza e hulumtimeve me temë „Ekologjia“ dhe propozim-aktivitete për periudhën e ardhshme, përparësitë dhe mangësitë e realizimit të aktiviteteve ekologjike në QSHA „Boro Petrushevski“ – Shkup. Prezantim për nxënësit (Teknik i makinerisë për automjete motorike, viti IV) për testimin dhe përdorimin e pajisjeve diagnostikuese dhe osciloskopit; prezantim dhe teste trajnimi nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë për të gjithë nxënësit që shkojnë në praktikë feriale, në përputhje me drejtimin dhe programin e parashikuar nga arsimi i mesëm profesional i reformuar; hartimi i mjeteve demonstruese (pano me formula); punëtori me temë „Komunikimi jo i dhunshëm“; prezantimi i projektit „Galaktika e Sistemit Diellor“; arritje teknologjike në informatikë të paraqitura përmes prezantimit; hartimi i panove me formula më të rëndësishme; pano me temë „Ekologjia“; punëtori për përpunimin e trupave gjeometrikë nga nxënësit; prezantimi i projekteve të përpunuara nga anëtarët e Klubit të Fizikanëve të Rinj; ekspozitë vjetore e krijimeve më të suksesshme të nxënësve; përgatitja e maskave për Halloween; përgatitja e dekorimeve dhe kartolinave për Vitin e Ri dhe Krishtlindjet; Naim Frashëri – jeta dhe vepra; përgatitja e kartolinave, dekorimeve,

	gazetës së murit dhe panos për Shën Valentin; Dita e Nënës – përgatitja e kartolinave me rastin e festës së gruas; gazetë muri me rastin e Ditës së Nënës; vizatimi i pjesëve të automobilit në poster dhe emërtimi i tyre në gjuhën angleze; tribunë me temë „Zakonet gjatë shënimit të festave fetare“, përgatitja e dekorimeve të Pashkëve; përgatitja e maskave për Halloween; prezantim me rastin e Ditës Botërore të Fëmijëve – 20 Nëntori; përgatitja e produkteve për pazar dhe aksion humanitar; prezantime nga nxënësit për dallimet gjinore dhe martesat e së njëjtës gjini, multikulturalizmin dhe jetesën e integruar – debat; punëtori me temë „Pranimi i dallimeve“; punëtori me tema „Të drejtat dhe liritë e njeriut“, „Promovimi i vlerave humane“ dhe „Vlerat personale“; tribunë me nxënësit „Zakonet gjatë shënimit të festave fetare“; punëtori me temë „Maska ime“; referat për patronin tonë dhe prezantim INFO. Krijimi i një këndi për realizimin e ushtrimeve të mësimit praktik. Punëtori „Është radha jote të lexosh“. Demonstrim i hartimit të projektit. Pazar shkollor me punime artizanale. Punëtori për tërheqjen e mediumit vizual.
TRAJNIME	Trajnim i nxënësve të viteve përfundimtare për përdorimin e Mototesterit. Mentorimi i nxënësve për krijimin e detyrave projektuese për Maturën Shtetërore dhe Provimin Përfundimtar. Trajnim praktik me nxënësit e vitit të tretë – Teknik i makinerisë për automjete motorike – për saldim dhe matje. Trajnim praktik me nxënësit e vitit të tretë – Teknik i makinerisë për automjete motorike – për montimin dhe çmontimin e pajisjeve 12V (akumulator, alternator, starter). Trajnim praktik me nxënësit e vitit të katërt – Teknik i makinerisë për automjete motorike – për testimin e sensorëve me osciloskop. Trajnim praktik i nxënësve të vitit të katërt – Teknik i makinerisë për automjete motorike – për punë me pajisje diagnostikuese, elektronikë – punëtori. Trajnim nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë nxënësit që shkojnë në praktikë feriale, në përputhje me drejtimin dhe programin e parashikuar të arsimit të mesëm profesional të reformuar.
VIZITA	Ideja është që nxënësit e viteve II dhe III të njihen me ndërtimin e urave. Vizita të organizuara në punëtori dhe autoservise. Vizitë në Qendrën për Menaxhimin e Sinjalizimit të Dritave në kryqëzimet e Qytetit të Shkupit. Vizita në: depon e Dauti Komercit, pikë kufitare, kompani shpedicioni, Panairin e Punësimit, terminal doganor, Galerinë Kombëtare – Shkup, Filarmoninë e Maqedonisë, shfaqje operistike, Institutin e Fizikës, shfaqje baleti, shfaqje teatrore, Panairin e Librit, ngjarje muzikore-kulturore në një nga institucionet e rëndësishme muzikore, Muzeun e Qytetit të Shkupit, Muzeun e VMRO-së, Festivalin e Xhazit, Muzeun e Artit Bashkëkohor, Muzeun e Shkencave Natyrore, Muzeun Arkeologjik, koncerte në Salon 19, Teatrin Shqiptar, objekte kulturore në Shkup dhe Çarshinë Turke, ndërmarrje transporti, SHA Posta, SHA „Fershped“, NTP-Shkup, institucion shtetëror, QSHA Broker, objekte fetare me grup etnikisht të përzier nxënësish, Muzeun e Holokaustit, Shtëpinë Përkujtimore të Nënë Terezës, EU InfoCenter, Automakedonija dhe Tumba Maxhari. Vizitë në Qendrën për Menaxhimin dhe Kontrollin e Komunikacionit në territorin e Qytetit të Shkupit. Vizitë në zyrë projektuese për krijimin e projekteve të komunikacionit. Vizitë në festival xhazi. Vizitë te subjektet ekonomike (autoservise, organizata transporti etj.). Mbajtja e ditëve të hapura nëpër komuna (ku do të ftoheshin dhe organizoheshin nxënësit me prindërit dhe mësimdhënësit nga ato komuna, ndërsa ne do të prezantoheshim me disa nga gjërat tona karakteristike, si p.sh.: automjete të dhuruara, punime, mototester, simulator etj.). Vizita në autoservise dhe ndërmarrje nga industria automobilistike dhe mbledhja e sponsorëve për manifestimin e ardhshëm me automjete. Vizitë në kompani të specializuar për vendosjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal.
HULUMTIME	Hulumtim krahasues për lëvizjen e suksesit mesatar nga shkolla fillore në vitin e parë; analizë e klimës psikosociale në klasë – procedurë sociometrike. Hulumtime me tema: „Përdorimi i automjeteve elektrike“ dhe „Ekologjia“. Përparësitë dhe mangësitë e realizimit të aktiviteteve ekologjike në QSHA „Boro Petrushevski“ –

	Shkup. Analiza e efekteve të mentorimit të mësimdhënësve (përparësi dhe mangësi), analiza e suksesit dhe vijueshmërisë së nxënësve në çdo tremujor, analiza e përparimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, hulumtimi i qëndrimeve të nxënësve ndaj pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike. Hulumtim dhe mbledhje e informatave më të reja për inxhinierinë e transportit dhe komunikacionit. Hulumtim në revista online për automjete hibride, automjete me hidrogjen dhe automjete elektrike; mundësi për hulumtim dhe mbledhje të informatave më të reja nga fusha e makinerisë. Analiza e konsumit të letrës së vjetër në shkollë dhe bashkëpunim me „PAKOMAK“ për vendosjen e koshave për mbledhjen e letrës së vjetër në shkollë. Hulumtime me temë mundësia e riciklimit dhe selektimit të mbeturinave në QSHA „Boro Petrushevski“ – Shkup dhe përfitimet nga zbatimi real.
GARA	Gara shtetërore në komunikacion dhe makineri; gara ndërkombëtare „AUTOMEKANIKU I RI EVROPIAN 2027“, Shkup; gara përfundimtare në futboll të vogël; sport shkollor (gara në futboll të vogël, basketboll, volejboll); kros republikan; pjesëmarrje në „Kangur“ – garë në matematikë, garë ndërshkollore në matematikë, garë për ndihmën e parë dhe mbrojtjen nga zjarri. Organizimi i konkursit për ide inovative nga industria e automobilave. Realizimi i kuizit të komunikacionit dhe makinerisë me nxënësit e vitit të tretë. Mbajtja e mini-garave në punëtorinë tonë për lidhjen e suksesshme të teorisë me mësimin praktik; pjesëmarrje në garat MOS (MS Word, MS Excel, MS PowerPoint) dhe ACA (Adobe InDesign, Adobe Illustrator, Adobe Photoshop); pjesëmarrje në garën „Sfilatat e Qytetit“, pjesëmarrje në garën MASSUM. Organizimi i konkursit për ide inovative nga industria e automobilave dhe fusha të tjera të jetës së përditshme, për mundësinë e pjesëmarrjes në garën kombëtare për nxënësit e shkollave të mesme „Koncepti më i mirë i biznesit për inovacione të gjelbra 2027“. Kuiz-garë i Vitit të Ri me nxënësit e vitit të tretë të profilit Teknik i makinerisë për automjete motorike. Mbajtja e mini-garave në punëtorinë tonë për lidhjen e suksesshme të teorisë me mësimin praktik. Kuiz-garë ndërmjet nxënësve të vitit të parë për mënyrën e sjelljes në komunikacion me biçikletë.
KONFERENCA, SEMINARE	Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare të Fizikanëve; pjesëmarrje në seminarin e organizuar nga Shoqata Astronomike e Maqedonisë – Shkup; pjesëmarrje në seminarin e organizuar nga Shoqata Astrologjike – Shkup; pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare për arsimin në matematikë, fizikë dhe shkenca të ngjashme.

14.3.1. Manifestime dhe ngjarje të rëndësishme

Gjatë këtij viti shkollor, shkolla do të organizojë dhe do të marrë pjesë në manifestimet në vijim:

Manifestimi dhe organizatori	**Koha**	**Qëllimi**
Më i miri ndër më të mirët – Qyteti i Shkupit	Maj	Shpërblim për maturantët e shkollave të mesme
Mbrëmja e maturës – shkolla	Maj	Festim pas përfundimit të arsimit të mesëm
Patronati – shkolla	Prill	Promovimi dhe afirmimi i shkollës, shënimi i Patronit të shkollës

Dita e Hapur në shkollë – Panairi i Punësimit	Prill	Afirmimi i drejtimeve, nxitja e interesit të nxënësve të klasës së nëntë. Krijimi i komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet partnerëve socialë dhe nxënësve të viteve përfundimtare, me qëllim lehtësimin e procesit të punësimit të tyre.
Dita e Ekologjisë – MASH	Mars	Nxitja e kulturës ekologjike
Parada e maturantëve – Qyteti i Shkupit	Maj	Vallëzimi i maturantëve për respektimin e vlerave dhe Ditën e Rinisë
Mbrëmje oratorie	Dhjetor	Manifestimi përfundimtar në kuadër të projektit „Të folurit publik“
Netët e Bardha – Qyteti i Shkupit	Maj	Ngjarje kulturore dhe sportive në qytet

14.3.2. Projekte strategjike-zhvillimore me rëndësi më të madhe për Qendrën

14.3.2.1. Qendra për Trajnim dhe Karrierë

Shkolla është e gatshme të fillojë përgatitjet për Qendrën për Trajnim dhe Karrierë nga aspekti organizativ-teknik dhe programor. Trajnimet për të rritur, natyrisht, ekzistojnë në shkollë që nga themelimi i saj, por vlerësojmë se në nivel ndërsektorial duhet të kenë koncept dhe organizim tjetër. Për këtë qëllim do të përgatiten elaborat, plan dhe program për të gjitha trajnimet që jemi kompetentë t'i organizojmë dhe do të fillojë procedura për marrjen e pëlqimeve dhe vendimeve nga institucionet resore.

15. MBËSHTETJA E NXËNËSVE

15.1. Ndjekja dhe analiza e suksesit të nxënësve

Në kuadër të kësaj fushe programore planifikohet që shkolla të organizojë ndjekje sistematike të programuar, avancim dhe vlerësim të veprimtarisë që realizon. Qëllimi i ndjekjes, avancimit dhe vlerësimit të veprimtarisë edukativo-arsimore në shkollë është që kuadri mësimor-edukativ dhe bashkëpunëtorët profesionalë të kenë qasje profesionale në analizën dhe vlerësimin e cilësisë së punës, rezultateve të arritura dhe aktiviteteve të orientuara drejt cilësisë, modernizimit dhe përmirësimit të punës edukativo-arsimore.

Gjatë vitit 2026/2027 Shkolla do të synojë:

- ta zhvillojë sistemin e vendosur të ndjekjes së vazhdueshme dhe mbledhjes së të dhënave për tërë punën edukativo-arsimore;
- vlerësimin përmes zbatimit të standardeve dhe kritereve, si dhe vlerësimin e aktivitetit të përgjithshëm të nxënësit;
- të kontribuojë në përsosjen e kuadrit mësimor për vlerësimin kritik të arritjeve dhe mangësive gjatë punës;
- të nxisë interesim të vazhdueshëm te kuadri drejtues dhe mësimor për inovimin dhe avancimin e praktikës edukativo-arsimore;
- të mundësojë transparencë dhe hapje të punës së shkollës për të gjitha subjektet, si dhe nxitjen e interesit për rezultatet e arritura;
- të kontribuojë në vlerësimin objektiv të rezultateve që arrihen në mësimdhënie sipas lëndëve të veçanta mësimore dhe fushave edukativo-arsimore;

- të thellohet dhe forcohet motivimi i shkollës për arritjen e rezultateve më të larta, si dhe kujdesi për afirmimin e saj në mjedisin më të ngushtë dhe më të gjerë shoqëror;

Në bazë të ndjekjes së rezultateve në mësimdhënie dhe aktivitetet e tjera, të gjitha subjektet përgjegjëse dhe të përfshira do të hartojnë raporte, analiza, informacione dhe materiale të tjera profesionale për nevojat e organeve dhe trupave profesionalë në shkollë, si dhe për subjektet e tjera që janë përgjegjëse dhe të interesuara për punën e shkollës.

Në shkollë ekziston vlerësim i brendshëm i arritjeve të nxënësve, i cili zhvillohet në vazhdimësi gjatë gjithë vitit shkollor, me analiza të gjendjes në katër periudha klasifikuese. Këtë vit do t'i kushtohet theks vlerësimit formativ - vlerësimit për të nxënë si bazë e vlerësimit objektiv sumativ, i cili do të realizohet me teste objektive dhe vlerësim me gojë.

Me qëllim vlerësimin më objektiv dhe vazhdimësinë në ndjekjen e përparimit të nxënësve, mësimdhënësit do të realizojnë:

- **Testim fillestar të njohurive të nxënësve**
  Qëllimi i këtij aktiviteti është diagnostikimi i njohurive hyrëse të nxënësve, krijimi dhe përshtatja e programeve dhe orëve për mësimdhënie.
- **Barazimi dhe harmonizimi i kritereve të vlerësimit në fushën e mësimit profesional**

Arritjet e nxënësve sipas lëndëve mësimore evidentohen në fletë të veçanta evidentuese për vlerësim, të cilat mundësojnë pasqyrë të arritjeve të vazhdueshme, identifikimin e nxënësve me vështirësi dhe me nevoja të veçanta arsimore dhe ndjekjen e vazhdueshme të përparimit të tyre. Shkolla i ndjek në mënyrë të veçantë arritjet e nxënësve gjatë kalimit nga një cikël në tjetrin. Në shkollë respektohet procedura për vlerësimin e njohurive të nxënësve.

Gjatë këtij viti shkollor do të synohet një qasje edhe më e sistematizuar ndaj realizimit të projektit „Planifikimi dhe avancimi i vlerësimit, zbatimi i standardeve të vlerësimit“. Për këtë qëllim, të gjithë mësimdhënësit janë trajnuar për vlerësim formativ dhe sumativ. Do të zbatohet qasje dhe kontroll më serioz ndaj portofolëve të vlerësimit të secilit mësimdhënës.

Shtojcë: Programi për ndjekjen e arritjeve dhe vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2026/2027

15.2. Promovimi i mirëqenies së nxënësve, mbrojtja nga dhuna, keqpërdorimi dhe neglizhenca, parandalimi i diskriminimit

Në shkollën tonë zbatohet program i veçantë për përballimin e dhunës në arsim, i cili përfshin: analiza, zbatimin e programit me punëtori sipas një doracaku të dedikuar, bashkëpunim me institucione të tjera, prindër etj. Ky program plotësohet me tema për zgjidhjen e konflikteve, përballimin e stresit, sjelljen e dhunshme dhe komunikimin, nxitjen e tolerancës, ndërmjetësimin etj. Në këtë mënyrë shkolla bëhet mjedis nxitës për të nxënë dhe zhvillim, përmes lidhjes së ndërsjellë dhe bashkëpunimit të të gjithë anëtarëve të bashkësisë shkollore dhe më gjerë, pavarësisht nga mosha, përkatësia sociale, etnike ose gjinore. Qëllimi themelor i shkollës është përdorimi dhe zbatimi aktiv i protokolleve të zhvilluara për identifikimin, trajtimin dhe parandalimin e sjelljes së dhunshme në shkollë, si dhe nxitja e kujdestarëve të klasave, mësimdhënësve lëndorë dhe Shërbimit Profesional për të organizuar aktivitete specifike mësimore dhe jashtëmësimore për parandalimin dhe përballimin e dhunës në shkollë. Në shtojcë të Programit Vjetor ka politikë të veçantë dhe plan veprimi për zbatimin e saj.

Në shtojcë: Plani i aktiviteteve për përballimin e dhunës në shkollë

15.3. Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit

Nxënësit janë subjekti më i rëndësishëm në institucionet arsimore dhe për arsimimin e tyre cilësor, socializimin dhe zhvillimin e shëndetshëm psikofizik në shkollë do të bëhen përpjekje të veçanta për:

- përfshirjen e nxënësve në të gjitha format e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore, pavarësisht nga përkatësia gjinore dhe etnike, me qëllim arritjen e suksesit më të lartë dhe standardeve dalëse të cilësisë;
- nxitjen e zhvillimit intelektual dhe moral, si dhe aftësive për të menduar kritik dhe për të komunikuar te nxënësit dhe krijimin e vlerave pozitive ndaj shoqërisë;
- identifikimin e nevojave dhe vështirësive individuale të nxënësve (arsimore, emocionale, fizike dhe sociale) dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për tejkalimin e tyre;

- zhvillimin e programeve të veçanta për mbështetje në të nxënë për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë, nxënës nga grupe të margjinalizuara pa shprehi pune, të neglizhuar socialisht, pa kujdes prindëror etj.;
- kujdesin për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nxënësve me sëmundje kronike;
- kujdesin e përgjithshëm për atmosferë të sigurt dhe të këndshme për qëndrimin dhe të nxënit në shkollë dhe mbrojtjen nga sjellja e dhunshme e nxënësve me përkatësi të ndryshme gjinore dhe etnike dhe e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- njohjen në kohë me të drejtat dhe obligimet, Kodin e Sjelljes, Rregullin e Shtëpisë dhe mënyrën e shqiptimit të masave pedagogjike, si dhe punëtori parandaluese për pranimin e tyre dhe krijimin e klimës pozitive të punës;
- punë udhëzuese për formimin e shprehive të drejta të jetesës;
- zhvillimi i një shkolle ekologjikisht të pastër, në të cilën nxënësit do të kenë mundësi të mësojnë, të punojnë, të jetojnë dhe ta zhvillojnë në mënyrë spontane vetëdijen e tyre ekologjike, përmes zbatimit të fushatave dhe aksioneve të parashikuara me programin;
- ndjekja e lëvizjes së nxënësve dhe dinamikës së braktisjes së shkollimit, analiza e shkaqeve dhe ndërmarrja me kohë e masave në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale dhe prindërit;
- kujdesi për zhvillimin e multikulturalizmit, arsimit të integruar dhe kohezionit social.

15.4. Standardi i nxënësve

Standardi i nxënësve është çështje me të cilën shkolla merret prej shumë vitesh. Edhe këtë vit shkollor do t'i kushtohet kujdes përmirësimit të tij në këto fusha: sigurim falas; materiale falas për aktivitetet jashtëmësimore; vizita falas në ekspozita, panaire dhe shfaqje; participim për mbrëmjen e maturës dhe shpenzimet rreth diplomave, si dhe mobilitete falas për nxënësit përmes projekteve ndërkombëtare.Për të gjithë nxënësit sigurohen karta falas për transport me autobus, ndërsa tekstet shkollore dhe akomodimi falas në konvikt sigurohen nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe MASH-i, si pjesë e Projektit për stimulimin e arsimit. Qyteti i Shkupit tashmë ka filluar me shpërblimin financiar të nxënësve dhe mentorëve të tyre që kanë arritur sukses në gara, gjë që paraqet motivim shtesë për nxënësit që të marrin pjesë në gara nga fusha të ndryshme të arsimit.

Ky raport i shkollës ndaj nxënësve paraqet motivim të fuqishëm për përmirësimin e suksesit, sjelljes dhe vijueshmërisë. Aktivitetet humanitare për ndihmë të nxënësve të përjashtuar socialisht në shkollë janë shndërruar në traditë.

Në shkollë ekzistojnë kritere për motivim dhe shpërblim për zgjedhjen e nxënësit të gjeneratës, si dhe kritere për përmirësimin e standardit të nxënësve.

Qëllimi i këtyre instrumenteve është vlerësimi objektiv dhe nxitja e interesit dhe vullnetit për angazhim e arritje, humanizëm, dinjitet dhe vetërespekt.

15.5. Zhvillimi i shkathtësive jetësore

Në shkollë zbatohet programi „Arsim për shkathtësi jetësore", qëllimi themelor i të cilit është edukimi i të rinjve për t'u përballur me jetën, për vetëvlerësim dhe nxitjen e nevojës për ndryshim pozitiv të vetvetes, si dhe vendosjen e themeleve për një personalitet të rritur, të shëndetshëm dhe të suksesshëm. Arsimi për shkathtësi jetësore nënkupton realizimin e punëtorive sipas një programi të përcaktuar saktë nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit. Koncepti i punëtorive dhe ushtrimet e parashikuara janë krijuese dhe interesante për nxënësit, ndërsa qëllimi përfundimtar është që përmes argëtimit nxënësit dhe mësimdhënësit të fitojnë njohuri dhe informacione të reja, aktuale dhe interesante. Ky program do të realizohet në kuadër të orëve të kujdestarisë nga viti i parë deri në vitin e katërt. Në bibliotekën e shkollës është i qasshëm udhëzuesi për realizimin e punëtorive.

15.6. Realizimi i programeve të specializuara për mbështetje

15.6.1. Mbrojtja dhe shpëtimi nga fatkeqësitë natyrore

Me Programin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore realizohen interesat dhe aktivitetet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, mbrojtjes nga zjarri dhe menaxhimit të krizave, të cilat paraqesin aktivitete me interes publik. Në përputhje me dispozitat ligjore, shkolla do

t'i realizojë këto aktivitete përmes krijimit të një ekipi për mbrojtje, i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e ushtrimeve simuluese gjatë vitit shkollor.

Kriza përkufizohet si prishje e ekuilibrit ndërmjet nevojave dhe mundësive të njeriut, përkatësisht si paaftësi e individit për t'iu përshtatur ndryshimit dhe për ta pranuar atë si të mundshëm. Ekzistojnë situata të ndryshme krize që mund ta godasin shkollën dhe në të cilat është e domosdoshme ndërhyrja në krizë, qëllimi i së cilës është të sigurojë ndihmë të menjëhershme për normalizimin e gjendjes dhe minimizimin e efekteve rraskapitëse pas krizës. Ndarja e roleve dhe detyrave është hapi i parë në krijimin e strategjisë për ndërhyrje në krizë në shkollë.

Ekipi përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Koordinatori kryesor

Koordinator për kontakt me nxënësit	Koordinator për ndihmë mjekësore dhe shërbimet profesionale
Koordinator për kontakt me prindërit	Koordinator për kontakt me mediat
Koordinator për sigurimin e shkollës	Koordinator për kontakt me mësimdhënësit

Plani i aktiviteteve para krizës:

- marrja e përgjegjësisë për përcaktimin, koordinimin dhe sqarimin e detyrave dhe përgjegjësive të secilit anëtar të ekipit;
- vendosja e lidhjeve të komunikimit dhe strategjive për bashkëpunim me institucionet kompetente dhe ekipet e jashtme të krizës, të cilat mund të thirren;
- përcaktimi i informatave që do të shpërndahen në kushte krize;
- thirrja e takimeve me ekipin e krizës, në të cilat do të kontrollohen dhe harmonizohen aktivitetet e mundshme në rast krize;
- caktimi i zëvendësit në rast mungese.

Aktivitetet gjatë krizës:

- njoftimi i anëtarëve të ekipit të krizës për krizën e paraqitur;
- marrjen e vendimeve për ndryshimin e orarit shkollor, sigurimin e ndërtesës, dhënien e direktivave dhe zgjidhjeve;
- komunikimin me administratën e shkollës, institucionet dhe ekipet e krizës nga jashtë;
- koordinimin e anëtarëve të ekipit të krizës;
- marrjen e vendimeve sipas zhvillimit të ngjarjeve;
- mundësimin e takimeve të ekipit në intervale të përshtatshme gjatë kohëzgjatjes së krizës, takime për mbështetje të ndërsjellë dhe shkëmbim informacioni;
- mbajtjen e sa më shumë shënimeve për atë që është bërë dhe për informacionet relevante të disponueshme lidhur me ngjarjen.

Aktivitetet pas krizës:

- sigurimin e mbështetjes dhe ndihmës së vazhdueshme për personelin e shkollës.

Shtojcë: Udhëzime për veprim në shkollë në rast të situatës së krizës

15.6.2. Puna shoqërisht e dobishme dhe kulturore

Aktivitetet nga fusha e punës shoqërisht të dobishme do të përfshihen në programet e seksioneve të shkollës dhe në Programin e Organizatës rinore, ndërsa sipas nevojës do të formohen grupe që do të kujdesen për mirëmbajtjen dhe rregullimin estetik të oborrit të shkollës, autodromit, komunës dhe qytetit. Këtë vit në shkollë do të realizohen disa projekte të orientuara drejt avancimit dhe zbukurimit të shkollës dhe mjedisit shkollor. Këto projekte dëshmojnë entuziazmin e mësimdhënësve dhe nxënësve, si dhe nevojën e tyre për të dhënë kontribut në zhvillimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të rregulluar. Gjatë vitit shkollor planifikohet përfshirja e nxënësve në punë shoqërisht të dobishme, me qëllim zhvillimin e qëndrimit pozitiv ndaj punës, kultivimin e respektit për punën dhe mjetet e prodhimit, si dhe për rezultatet e punës në përgjithësi.

Me realizimin e aktiviteteve dhe përmbajtjeve nga kjo fushë strukturore do të synohet që te nxënësit:

- të zhvillohet qëndrim pozitiv ndaj punës dhe ndjenjë përgjegjësie;
- të kontribuohet në zhvillimin e këmbënguljes në punë, kryerjen e rregullt dhe në kohë të detyrave;

- të zhvillohen shprehitë dhe shkathtësitë themelore të punës gjatë përdorimit të veglave dhe pajisjeve me të cilat kryhen detyrat e punës;
- të fitohen njohuri për organizimin e punës, respektimin e punës së tjetrit dhe të vetes dhe bashkëpunimin në procesin e punës;
- të zhvillohet dashuria ndaj natyrës dhe bukurive natyrore;
- të krijohen shprehi për mirëmbajtjen e higjienës në shkollë dhe mjedisin përreth.

Shkolla do t'i mbështesë dhe do të përfshihet në të gjitha aktivitetet e kësaj fushe që do të organizohen nga: Qyteti i Shkupit, Komuna e Gazi Babës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, MASH-i, QAP-i dhe BZHA-ja.

Ngritja e nivelit kulturor të nxënësve do të realizohet përmes vizitave të planifikuara në institucione kulturore-shkencore, prezantime, promovime dhe manifestime me raste të ndryshme gjatë gjithë vitit shkollor.

Gjatë këtij viti shkollor do të krijohet program i veçantë edukativo-kulturor që do të përfshijë aktivitete për: sjelljen, mirësjelljen, formimin e stilit dhe imazhit të veçantë, kulturën muzikore, filmin, teatrin, kulturën e të shprehurit etj. Ky program, përveç kujdestarit të klasës, do të përfshijë edhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës. Gjithashtu, në funksion të këtij qëllimi, shkolla do të ndërmarrë iniciativë më të madhe për t'iu bashkuar manifestimeve kulturore dhe aksioneve që realizon Qyteti i Shkupit.

Të gjitha datat më të rëndësishme, sipas kalendarit, do të shënohen me referate, prezantime, pano, vizita etj., në varësi të aktualitetit në nivel republikan dhe karakterit jubilar. Dita e patronatit të shkollës do të kremtohet thjesht, por solemnisht, sipas një programi të veçantë.

Në shtojcë: Programi për punë shoqërisht të dobishme dhe kulturore

15.6.3. Vetëmbrojtja në institucionet arsimore

Në përputhje me Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e realizimit të trajnimit për vetëmbrojtje në institucionet arsimore („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr. 139, datë 10.7.2025), në shkollë realizohen aktivitete për vetëmbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet e tjera; përkatësisht, në procesin mësimor trajtohen tema mësimore për aftësimin për vetëmbrojtje në kushte të: tërmeteve, zjarreve dhe shpërthimeve, materieve të rrezikshme, epidemive dhe sëmundjeve ngjitëse te kafshët dhe bimët, reshjeve të dendura të borës, stuhive, përmbytjeve, shirave të rrëmbyeshëm, fatkeqësive atmosferike, aksidenteve të komunikacionit etj.

Shtojcë: Programi për aftësimin për vetëmbrojtje

16. VLERËSIMI

16.1. Llojet e vlerësimit

Në shkollë ekziston vlerësim i brendshëm i arritjeve të nxënësve, i cili zhvillohet në vazhdimësi gjatë gjithë vitit shkollor, me analiza të gjendjes në katër periudha klasifikuese. Këtë vit do t'i kushtohet theks vlerësimit formativ - vlerësimit për të nxënë si bazë e vlerësimit objektiv sumativ, i cili do të realizohet me teste objektive dhe vlerësim me gojë.

Me qëllim vlerësimin më objektiv dhe vazhdimësinë në ndjekjen e përparimit të nxënësve, mësimdhënësit do të realizojnë:

- **Testim fillestar të njohurive të nxënësve**
  Qëllimi i këtij aktiviteti është diagnostikimi i njohurive hyrëse të nxënësve, krijimi dhe përshtatja e programeve dhe orëve për mësimdhënie.
- **Barazimi dhe harmonizimi i kritereve të vlerësimit në fushën e mësimit profesional**

Arritjet e nxënësve sipas lëndëve mësimore evidentohen në fletë të veçanta evidentuese për vlerësim, të cilat mundësojnë pasqyrë të arritjeve të vazhdueshme, identifikimin e nxënësve me vështirësi dhe me nevoja të veçanta arsimore dhe ndjekjen e vazhdueshme të përparimit të tyre. Shkolla i ndjek në mënyrë të veçantë arritjet e nxënësve gjatë kalimit nga një cikël në tjetrin. Në shkollë respektohet procedura për vlerësimin e njohurive të nxënësve.

Gjatë këtij viti shkollor do të synohet një qasje edhe më e sistematizuar ndaj realizimit të projektit „Planifikimi dhe avancimi i vlerësimit, zbatimi i standardeve të vlerësimit“. Për këtë qëllim, të gjithë mësimdhënësit janë trajnuar për vlerësim formativ dhe sumativ. Do të zbatohet qasje dhe kontroll më serioz ndaj portofolëve të vlerësimit të secilit mësimdhënës, sipas planit të parashikuar.

Përshkrimi/lloji i vlerësimit	Përshkrimi i aktiviteteve	Personi përgjegjës	Afatet	Shënime
Vlerësimi numerik	Vlerësim i vazhdueshëm nga viti I deri IV me nota nga 1 deri 5; nxjerrja e notave sipas moduleve në bazë të rezultateve të fituara të të nxënit; përcaktimi i suksesit tremujor, gjysmëvjetor dhe vjetor.	Mësimdhënësit lëndorë, Aktivet profesionale	Gjatë gjithë vitit shkollor (nëntor, janar, prill, qershor)	Notat duhet të jenë publike dhe të arsyetuara para nxënësit.
Vlerësimi formativ	Ndjekja e procesit të të nxënit përmes ushtrimeve praktike në punëtori, listave të kontrollit për shkathtësi, portofolit dhe ditarëve të praktikës; regjistrimi i së paku dy vëzhgimeve formative për periudhë.	Mësimdhënësit lëndorë, mentorët nga kompanitë	Në vazhdimësi, në çdo tremujor	Përdoret për korrigjimin në kohë të përparimit dhe orientimin e nxënësit.
Vlerësimi sumativ	Matja e njohurive dhe kompetencave përfundimtare në fund të temës/modulit; hartimi i testeve të standardizuara, mbrojtja e detyrave projektuese dhe kontrollimi përfundimtar praktik.	Mësimdhënësit e lëndëve	Në fund të çdo teme/moduli dhe në fund të gjysmëvjetorit/vitit	Pjesa praktike përmbledhëse mund të realizohet në kompani ose në punëtorinë shkollore.
Kalendari i vlerësimit me shkrim	Planifikimi dhe publikimi i orarit të testeve; realizimi i maksimum 1 testi në ditë dhe 2 në javë për paralele; njoftimi i detyrueshëm në e-ditar së paku 3 ditë pune më herët.	Mësimdhënësit lëndorë, kujdestarët e klasave	Në fillim të çdo gjysmëvjetori (shtator/janar)	Kalendari publikohet për nxënësit dhe prindërit në tabelën e shpalljeve/web.
Nxënësit me PIA	Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara sipas qëllimeve të përshtatura në PIA-n e tyre personale; fleksibilitet me teste vizuale, kohë të zgjatur dhe detyra praktike të sigurta.	Mësimdhënësit lëndorë, Ekipi gjithëpërfshirës (defektolog/psikolog)	Në vazhdimësi gjatë vitit	Nota pasqyron përparimin individual dhe jo krahasimin me grupin.
Informimi i prindërve	Regjistrim i rregullt i notave/mungesave në e-ditar; realizimi i katër takimeve të përgjithshme me prindër dhe ditëve të hapura mujore;	Kujdestarët e klasave, mësimdhënësit lëndorë	Vazhdimisht (e-ditari); çdo muaj (ditët e hapura); në fund të gjysmëvjetorëve	Theks i veçantë vihet në informimin për vijueshmërinë e mësimit

	njoftim me shkrim në rast rreziku për sukses të dobët.			praktik në kompani.
Rikontrollimi i njohurive	Formimi i një komisioni treanëtarësh pas parashtrimit të kundërshtimit me shkrim nga prindi/nxënësi i pakënaqur me notën përfundimtare vjetore/gjysmëvjetore; organizimi dhe realizimi i provimit.	Drejtori, Këshilli arsimor, Komisioni për kontroll	Brenda 48 orëve nga parashtrimi i kundërshtimit	Nota e komisionit është përfundimtare dhe e zëvendëson notën paraprake.
Komisionet e provimeve (provim klase, përmirësues, të jashtëzakonshëm...)	Formimi i komisioneve lëndore treanëtarëshe (kryetar, ekzaminues, anëtar); përgatitja e materialeve (teorike dhe praktike); realizimi i provimeve dhe mbyllja e dokumentacionit.	Drejtori, Këshilli arsimor, Komisionet e provimeve	Sipas Kalendarit shkollor (afatet e provimeve: qershor, gusht, janar/tetor)	Provimet për lëndët profesionale përmbajnë komponentin përkatës praktik.

16.2. Ekipi për ndjekje, analizë dhe mbështetje

Në shkollën tonë është formuar Ekipi për ndjekje, analizë dhe mbështetje të vlerësimit. Anëtarë të ekipit janë: drejtori, ndihmësdrejtori për mësim, koordinatori për mësim praktik, përgjegjësit e aktiveve dhe Shërbimi profesional (pedagog, psikolog, defektolog dhe sociolog).

Plani i veprimit për punën e ekipit për ndjekje, analizë dhe mbështetje në vlerësim është dhënë në tabelën në vijim.

Aktiviteti/Fusha	Përshkrimi/Udhëzimi	Korniza kohore	Personat përgjegjës	Mënyra e evidencës/raportit
Ndjekja e vlerësimit sipas lëndëve	Ndjekje e rregullt e shpërndarjes së notave sipas lëndëve dhe paraleleve të caktuara.	Një herë në muaj	Shërbimi profesional, drejtori, ndihmësdrejtori, pedagogu	Raport nga Shërbimi profesional, analizë në Këshillin Pedagogjik
Analiza e devijimeve në vlerësim	Krahasimi i notave me rezultatet e testimeve të jashtme dhe me vitet paraprake, si dhe përcaktimi i mbivlerësimit ose vlerësimit tepër të rreptë.	Pas çdo periudhe klasifikimi	ndihmësdrejtori për mësim, udhëheqësit e aktiveve profesionale	Grafikë statistikorë, analizë me shkrim për Këshillin arsimor
Mbështetje për mësimdhënësit që kanë vështirësi me vlerësimin	Realizimi i takimeve këshilluese, ndihmë gjatë hartimit të kritereve për vlerësim dhe	Menjëherë pas identifikimit të nevojës/në vazhdimësi	Pedagogu, psikologu, mentorët e mësimdhënësve	Procesverbale nga bisedat këshilluese, plan veprimi për zhvillim individual

	tejkalimin e subjektivitetit.			
Mbështetje për mësimdhënësit inovatorë	Identifikimi, stimulimi dhe lavdërimi publik i mësimdhënësve që përdorin mjete digjitale, vlerësim formativ dhe forma inovative.	Në fund të çdo gjysmëvjetori	Drejtori, ndihmësdrejtori për mësim	Propozime për shpërblime, publikime në faqen e internetit, evidencë në portofol
Ankesa dhe kundërshtime për vlerësimin	Formimi i komisioneve pas kundërshtimeve të parashtruara nga prindërit/nxënësit, rishikimi i testeve dhe organizimi i provimeve para komisionit.	Brenda afatit ligjor pas parashtrimit të ankesës	Drejtori, komisioni lëndor, prindi/nxënësi	Vendime për komisionet, procesverbale nga provimi para komisionit
Shkëmbimi i praktikave të mira	Organizimi i trajnimeve të brendshme, orëve të hapura dhe mini-prezantimeve për metoda të suksesshme të vlerësimit objektiv.	Dy herë në vit (gjatë pushimeve/këshillave)	Mësimdhënësit inovatorë, udhëheqësit e aktiveve	Agjenda, fletëvlerësime nga trajnimi, prezantime
Mësimdhënia dhe vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara	Kontrolli dhe rishikimi i përshtatjes së testeve dhe kritereve në përputhje me PIA-n (Planin Individual Arsimor).	Në vazhdimësi (me çdo test)	Ekipi gjithëpërfshirës, Defektolog dhe rehabilitues, mësimdhënësit lëndorë	Portofoli i nxënësit, teste të përshtatura, raport gjysmëvjetor
Mentorët te punëdhënësi	Koordinimi dhe ndjekja e vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit praktik në kompani, në përputhje me standardet.	Në fund të çdo cikli të praktikës	Mentori nga kompania, mësimdhënësi i mësimit praktik	Ditari i mësimit praktik, vërtetime dhe fletëvlerësime nga punëdhënësi
Koordinatorët për arsimin praktik	Monitorimi i përputhshmërisë së të nxënit real përmes punës me programin mësimor dhe verifikimi i notave përfundimtare nga praktika.	Çdo muaj/Në fund të vitit	Koordinatori për arsimin praktik, drejtori	Raporte mujore nga koordinatori, marrëveshje afariste dhe tabela me nota
Raport për gjendjen e vlerësimit	Vlerësimi përfundimtar i arritjeve, efikasitetit të procesit të vlerësimit dhe rekomandime për vitin e ardhshëm shkollor.	Qershor (fundi i vitit mësimor)	I gjithë ekipi për ndjekje dhe analizë	Raport vjetor i miratuar nga Këshilli arsimor dhe Bordi i Shkollës

16.3. Vizita profesionale për ndjekjen dhe vlerësimin e cilësisë së punës së kuadrit edukativo-arsimor

Ndjekja dhe vlerësimi i punës së secilit të punësuar është obligim ligjor i ekipit drejtues gjatë gjithë vitit shkollor. Ekziston program i veçantë për ndjekje dhe vlerësim, i cili përbëhet nga:

- ❑ Procedura për krijimin dhe kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e planit global dhe tematik;
- ❑ Procedura për kontrollimin e përgatitjeve ditore dhe vizitën e orëve;
- ❑ Përcaktimi i saktë i asaj që do të ndiqet - kriteret për suksesin e orës dhe përgatitjen e suksesshme;
- ❑ Përgatitja e instrumenteve për ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësit;
- ❑ Raporte periodike nga vizitat e realizuara dhe udhëzime për korrigjime.

Shkurtimisht, këtë do ta shpjegojmë në mënyrën në vijim:

Ndjekja e punës së mësimdhënësit do të bëhet nga drejtori, ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional dhe ekipi mentorues, përmes: vizitave në orë, shqyrtimit të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik, raporteve për aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore, portofolëve të përgatitur, si dhe analizave të një numri të madh pyetësorësh dhe anketash të realizuara me nxënësit.

Sistemi i ndjekjes dhe vlerësimit të punës së mësimdhënësit detyrimisht do të përfshijë informacion kthyes nga vëzhgimi, sugjerime, mentorim dhe mbështetje, sepse qëllimi parësor është eliminimi i dobësive gjatë realizimit të mësimit dhe përmirësimi i cilësisë së tij. Vlerësimi i punës mësimore është strategji e veçantë që përfshin një sërë formularësh për mbajtjen e portofolit, raporte nga mësimdhënësit, kartelë pedagogjike etj. Me instrumentin për vlerësimin e punës së mësimdhënësit do të vlerësohen qëndrimi profesional, kreativiteti dhe cilësia në punën mësimore. Gjithashtu do të zhvillohet instrument për cilësinë e punës së të gjithë të punësuarve të tjerë në shkollë. Të gjitha këto aktivitete shkollore paraqesin përgatitje serioze të shkollës për ta pranuar dhe zbatuar modelin e paralajmëruar nga MASH-i për vlerësimin e cilësisë së punës së mësimdhënësit.-

Me qëllim mbështetjen dhe avancimin e procesit edukativo-arsimor, shkolla ka përpunuar planin e drejtorit për realizimin e vizitave profesionale në orët mësimore, mësimin praktik dhe aktivitetet jashtëmësimore, si dhe në punën e të punësuarve të Shërbimit Profesional të shkollës.

Fusha e vëzhgimit	Lloji i aktivitetit	Personi përgjegjës	Korniza kohore	Instrumenti/metoda e vlerësimit	Shënim/fokusi i komentit
Mësimi i arsimit të përgjithshëm	Orët mësimore teorike	Drejtori/Ndihmësdrejtori	Shtator–Qershor (1–2 herë për mësimdhënës)	Lista për vëzhgimin e orës, Fleta e vetëvlerësimit, Raporti	Realizimi i qëllimeve, TIK-u, vlerësimi formativ, disiplina.
Mësimi profesional-teorik	Lëndë profesionale në profile/drejtime të ndryshme	Drejtori/Bashkëpunëtori profesional	Tetor–Prill (së paku 1 vizitë)	Fleta e vëzhgimit për mësimin profesional, Raporti	Zbatueshmëria e njohurive, metodat e mësimdhënies, aktiviteti i nxënësve.
Arsimi praktik	Mësimi praktik, ushtrimet dhe praktika feriale	Drejtori/Përgjegjësi i mësimit praktik	Nëntor–Maj (kontrolle të rregullta)	Protokolli për ndjekjen e mësimit praktik, Shënime nga terreni	Siguria në punë, mentorimi, lidhja e teorisë me praktikën.
Aktivitete jashtëmësimore	Seksione, projekte shkollore, klube sportive	Ndihmësdrejtori/Psikologu	Tetor–Maj (vizita periodike)	Fletëvlerësimi për aktivitetet jashtëmësimore, Intervistë	Përfshirja e nxënësve, socializimi, puna ekipore.

Puna e Shërbimit Profesional	Orë këshilluese, punë me nxënës/prindër, mbështetje për mësimdhënësit	Drejtori	Shtator–Qershor (shqyrtim tremujor)	Analiza e Programit Vjetor, shqyrtim i dosjeve, raport gjysmëvjetor	Veprimtari profesionale-diagnostikuese, gjithëpërfshirje, zhvillim profesional.
Vizita kontrolluese dhe mbështetëse	Orë përcjellëse pas dobësive të konstatuara paraprakisht	Drejtori/Shërbimi profesional	2–4 javë pas vizitës së parë	Fletë për ndjekjen e përparimit, bisedë reflektuese	Zbatimi i rekomandimeve të miratuara dhe planit të veprimit.

16.4. Vetëvlerësimi i shkollës

Vetëvlerësimi paraqet proces të kontrollit të brendshëm të cilësisë së punës së shkollës. Ai realizohet me qëllim përcaktimin e anëve të forta dhe të dobëta në funksionim, përmirësimin e proceseve mësimore dhe ngritjen e cilësisë së përgjithshme të organizatës. Procesi realizohet në bazë të fushave, standardeve dhe treguesve të përcaktuar paraprakisht, të cilët janë prioritet për këtë vit shkollor, në përputhje me rregulloren për vetëvlerësimin e shkollave.

Procesin e vetëvlerësimit e udhëheq dhe koordinon Komisioni i Shkollës për Vetëvlerësim, i përbërë nga përfaqësues të të gjitha strukturave në shkollë: drejtori i shkollës, përfaqësues nga Shërbimi profesional (pedagog/psikolog), mësimdhënës (koordinator i komisionit), mësimdhënës (anëtar), përfaqësues nga kuadri administrativ, përfaqësues nga Këshilli i prindërve dhe përfaqësues nga Këshilli i nxënësve.

Ndjekja (monitorimi) e Programit vjetor të punës në shkollën e mesme profesionale zbatohet me qëllim sigurimin e cilësisë së lartë të mësimit teorik dhe praktik, përputhshmërisë me standardet e profesioneve dhe bashkëpunimit efikas me sektorin e biznesit. Procesin e koordinon Drejtori në bashkëpunim me Ekipin për Programin vjetor të punës së shkollës, përgjegjësin e mësimit praktik dhe Shërbimin Profesional. Rezultatet shfrytëzohen për avancimin e shkathtësive të nxënësve dhe përgatitjen e tyre më të mirë për tregun e punës ose arsimin e mëtejshëm.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet mënyra e monitorimit dhe vlerësimit të Programit vjetor të punës së shkollës.

Fushat prioritare për ndjekje	Metoda e ndjekjes	Ekipi përgjegjës	Periodiciteti	Mjetet për ndjekje	Rezultatet e pritshme	Kush informohet
1. Mësimi praktik dhe mësimi	- Vizita në kompanitë ku	- Përgjegjësi i mësimit praktik	- Çdo muaj - Pas përfundimit të	- Lista kontrolli për vizita në	- Kompetenca profesionale të	- Drejtori

përmes punës (në shkollë dhe te punëdhënësi)	realizohet praktika - Shqyrtim i ditarëve të praktikës - Intervistë me mentorët e kompanive	- Koordinatori për mësimin përmes punës	praktikës feriale	kompani - Ditari i mësimit praktik - Fletë vlerësimi nga mentori	fituara sipas programit - Realizim i rregullt i praktikës	- Këshilli arsimor - Dhoma ekonomike
2. Realizimi i mësimit teorik profesional dhe të përgjithshëm	- Vëzhgim i orëve mësimore - Analizë e e-ditarit (realizimi i planeve mësimore)	- Drejtori - Ndihmësdrejtori - Shërbimi profesional	- Çdo muaj - Në fund të tremujorit	- Formular për vëzhgimin e orës - Raporte statistikore nga e-ditari	- Realizim në kohë i fondit të orëve mësimore - Sukses i kënaqshëm i nxënësve	- Këshilli arsimor - Bordi i Shkollës
3. Bashkëpunimi me sektorin e biznesit dhe partnerët socialë	- Takime me kompani lokale - Anketim i menaxherëve për kënaqësinë nga nxënësit	- Ndihmësdrejtori për trajnim, hulumtim dhe zhvillim - Koordinatori për mësimin përmes punës - Qendra e Karrierës	- Një herë në gjysmëvjetor	- Pyetësor për kënaqësinë e punëdhënësve - Procesverbale nga takimet	- Numër i rritur i marrëveshjeve të lidhura për praktikë - Programe të përditësuara sipas nevojave të tregut	- Bordi i Shkollës - Vetëqeverisja lokale
4. Këshillimi për karrierë, orientimi dhe aktivitetet jashtëmësimore	- Ndjekja e aktiviteteve të Qendrës së karrierës - Anketime për interesat profesionale dhe orientimin e nxënësve	- Këshilltari i karrierës - Shërbimi profesional (pedagog/psikolog)	- Çdo tremujor	- Evidencë për këshillimin për karrierë - Anketime për maturantët - Raporte nga seksionet profesionale	- Nxënësit orientohen me sukses drejt punësimit ose fakultetit - Klube profesionale aktive	- Këshilli arsimor - Këshilli i prindërve
5. Gjithëpërfshirja dhe përshtatja e arsimit profesional	- Analiza e PIA-s - Ndjekja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore gjatë mësimit praktik	- Ekipi gjithëpërfshirës - Shërbimi profesional	- Çdo dy muaj	- Fletë monitorimi për PIA-n - Pyetësorë për mësimdhënësit dhe mentorët	- Detyra pune të përshtatura gjatë praktikës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore - Mbështetje e përshtatshme e siguruar	- Këshilli arsimor - Prindërit e nxënësve
6. Siguria dhe shëndeti në punë (SSHP) dhe klima shkollore	- Kontrolli i pajisjeve mbrojtëse në punëtoritë e shkollës - Edukimi i nxënësve për SSHP - Anketime për sigurinë	- Përgjegjësi për SSHP në shkollë - Ekipi për mjedis të sigurt	- Para fillimit të çdo cikli praktik	- Protokolle për SSHP në punëtori - Pyetësorë për sigurinë	- Zero lëndime në punë në punëtori dhe kompani - Respektimi i masave mbrojtëse	- Drejtori - Inspektorati Shtetëror i Punës (sipas nevojës)

24. Vlerësimi i Programit vjetor të punës së shkollës

Vlerësimi duhet të fokusohet fuqishëm në mësimin praktik, bashkëpunimin me sektorin e biznesit, këshillimin në karrierë dhe fitimin e kompetencave kryesore profesionale për tregun e punës. Në fund të vitit shkollor do të përgatitet raport për realizimin e Programit Vjetor, i cili do t'u prezantohet organeve dhe trupave profesionalë e drejtues të shkollës dhe do t'u dorëzohet institucioneve përkatëse kompetente në Republikë. Rezultatet e këtij vlerësimi shfrytëzohen drejtpërdrejt për përgatitjen e Raportit të Vetëvlerësimit të shkollës.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten plani dhe fushat prioritare specifike për vlerësimin e Programit Vjetor të shkollës:

Fushat prioritare për vlerësim	Metoda e vlerësimit	Ekipi përgjegjës	Periodiciteti	Mjetet për vlerësim	Rezultatet e pritshme	Kush duhet të informohet
1. Cilësia e mësimit praktik (në punëtoritë e shkollës dhe te punëdhënësit/arsimi dual)	• Vëzhgimi i punës praktike • Takime mentoruese • Shqyrtim i ditarëve të praktikës	• Përgjegjësi i mësimit praktik • Ekipi për arsimin dual	• Çdo muaj dhe në fund të çdo cikli të praktikës	• Protokolle për vizita në kompani • Lista kontrolli për shkathtësitë praktike • Ditarët e nxënësve	• Përputhshmëria me proceset teknologjike në sektorin real	• Këshilli arsimor • Kompanitë partnere • Dhoma ekonomike
2. Bashkëpunimi me sektorin e biznesit dhe partnerët socialë (marrëveshje, burime, ligjërues profesionalë)	• Intervista me mentorët e kompanive • Analiza e memorandumeve për bashkëpunim	• Ekipi për karrierë dhe bashkëpunim me sektorin e biznesit • Drejtori	• Në fund të çdo viti shkollor	• Pyetësorë për kënaqësinë e punëdhënësve • Fletë vlerësimi për bashkëpunimin	• Numër i rritur i kompanive partnere • Pajisje të modernizuara në shkollë	• Bordi i Shkollës • Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) • Qendra për Arsim dhe Aftësim Profesional
3. Këshillimi për karrierë, orientimi dhe punësueshmëria (orientimi profesional, ndjekja e nxënësve të diplomuar)	• Anketimi i nxënësve të viteve përfundimtare • Ndjekja e ish-nxënësve	• Këshilltari i karrierës • Shërbimi profesional (psikolog/pedagog)	• Dy herë në vit (gjatë regjistrimeve dhe para diplomimit)	• Anketë për planet e karrierës • Bazë të dhënash për punësimin/regjistrimin në fakultet	• Nxënës të përgatitur për tregun e punës • Pasqyrë e qartë e efikasitetit të drejtimeve profesionale	• Këshilli arsimor • Qendra e Punësimit • Bashkësia lokale
4. Provimi profesional dhe detyra projektuese (cilësia e provimit përfundimtar, zbatueshmëria e punimeve)	• Analiza e raporteve të komisioneve të provimit • Mbrojtja e detyrave projektuese	• Komisioni i Provimeve i Shkollës • Mësimdhënësit lëndorë	• Në fund të vitit shkollor (afati i qershorit/gushtit)	• Fletë vlerësimi për provimin profesional • Raporte nga kryetarët e komisioneve	• Përqindje e lartë e provimeve të kaluara me zgjidhje të zbatueshme	• Këshilli arsimor • Qendra Shtetërore e Provimeve

25. Përfundim

Programi vjetor i punës paraqet dokument strategjik themelor që përcakton vizionin, misionin dhe drejtimin praktik të shkollës së mesme profesionale për vitin e ardhshëm shkollor. Qëllimi i tij parësor është të sigurojë zhvillim sistematik, të organizuar dhe cilësor të procesit edukativo-arsimor. Rëndësia e këtij programi qëndron në harmonizimin e rregullativës ligjore me nevojat reale të nxënësve, kuadrit mësimor dhe tregut lokal të punës. Përmes tij vendoset një kornizë e qartë për fitimin e shkathtësive dhe kompetencave profesionale të zbatueshme, ku njohuritë teorike lidhen drejtpërdrejt me zbatimin praktik.

Si shkollë e mesme profesionale, programi është përshtatur posaçërisht për t'iu përgjigjur trendeve bashkëkohore ekonomike dhe teknologjike. Theksi vihet në zhvillimin e shkathtësive praktike përmes orëve të përforcuara të mësimit praktik dhe të nxënit përmes punës në kompani reale. Programi promovon qasje individuale ndaj nxënësve, duke mbështetur prirjet e tyre specifike teknike dhe inovacionin. Njëkohësisht, parashikohet mbështetje intensive për pjesëmarrjen në ngjarje publike, gara profesionale shtetërore dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete u mundësojnë nxënësve ta tregojnë përparimin e tyre, të ndërtojnë vetëbesim dhe të krijojnë kontakt të drejtpërdrejtë me punëdhënës potencialë që gjatë arsimimit.

Prioritetet strategjike për këtë vit janë të orientuara drejt modernizimit të hapësirës shkollore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve për punë dhe të nxënë. Kjo përfshin pajisjen e kabineteve dhe punëtorive shkollore me teknologji dhe vegla bashkëkohore. Rezultatet e pritshme nga këto investime janë rritja e cilësisë së mësimdhënies, sukses më i lartë i nxënësve, ulja e braktisjes së parakohshme të arsimit dhe rritja e punësueshmërisë së maturantëve menjëherë pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.

Realizimi i suksesshëm i planit nënkupton monitorim dhe vlerësim të rregullt të të gjitha fazave të Programit Vjetor. Ndjekja e aktiviteteve do të bëhet përmes treguesve të përcaktuar qartë të suksesit, takimeve të rregullta të aktiveve profesionale dhe udhëheqësve, si dhe raporteve për mësimin e realizuar. Element kyç në këtë proces është vetëvlerësimi i vazhdueshëm i shkollës. Ai

mundëson identifikimin në kohë të sfidave, vlerësimin real të anëve të forta dhe të dobëta, si dhe përshtatjen dhe korrigjimin e shpejtë të strategjive mësimore në përputhje me nevojat e nxënësve dhe mësimdhënësve.

Në fund, mund të konstatohet se shkolla ka gatishmëri të plotë dhe kapacitet kadrovik e hapësinor për zbatimin e këtij Programi Vjetor. Fokusi i shkollës mbetet i orientuar drejt krijimit të kuadrit profesional, konkurrues dhe të përgjegjshëm, të përgatitur për sfidat e shoqërisë moderne. Me hapjen e saj ndaj bashkëpunimit me sektorin e biznesit, vetëqeverisjen lokale dhe bashkësinë më të gjerë, shkolla afirmohet si nxitës kyç i zhvillimit ekonomik lokal dhe partner i të rinjve në ndërtimin e së ardhmes së tyre profesionale.

26. Komisioni për krijimin e Programit vjetor të punës së shkollës së mesme

1. Aleksandar Strezov – drejtor
2. Zekirija Zekiri – ndihmësdrejtor për mësim
3. Kristijan Petreski – ndihmësdrejtor për trajnim, hulumtim dhe zhvillim
4. Kastriot Kasapi – përgjegjës i ndërrimit
5. Koce Tapshanovski – përgjegjës i ndërrimit
6. Iman Izeri – defektolog
7. Haki Fejzullai – kryetar i Bordit të Shkollës
8. Agim Jusufi – koordinator për arsimin praktik
9. Zoki Stojmirov – mësimdhënës përgjegjës për aktivin profesional
10. Violeta Kralevska – mësimdhënëse përgjegjëse për aktivin shoqëror-humanitar
11. Vevait Alimi – mësimdhënës përgjegjës për aktivin natyror-matematikor
12. Silvija Mitrevska-Filipova – mësimdhënëse përgjegjëse për aktivin kulturor-gjuhësor
13. Elena Petrovska – psikologe
14. Sunchica Belinska-Andov – sociologe
15. Teuta Daci – pedagoge
16. Eleonora Beqiri – këshilltare për karrierë
17. Aleksandar Jovanov – përgjegjës i Stacionit për Kontroll Teknik
18. Nikolche Spasovski – udhëheqës profesional i Autoshkollës
19. Jana Ivanovski – sekretare

27. LITERATURA E PËRDORUR DHE BURIMET E TË DHËNAVE

Gjatë hartimit të Programit vjetor të punës së shkollës për vitin shkollor 2026/2027 u përdorën këto akte ligjore dhe nënligjore, dokumente strategjike, projekte, trajnime dhe analiza:

- **Ligji për arsimin e mesëm**
- **Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional**
- **Ligji për arsimin e të rriturve**
- **Strategjia për Arsim e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).**
- **Koncepti për arsimin e mesëm profesional dhe udhëzimet e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) dhe Qendrës për Arsim dhe Aftësim Profesional.**
- **Projekti për avancimin e arsimit të mesëm profesional (i mbështetur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës).**
- **Projektet Erasmus+**
- **Projekti „Mëso me zgjuarsi, puno profesionalisht“ (aktivitete për bashkëpunim me sektorin e biznesit dhe arsimin dual).**
- **Projektet e Qendrës maqedonase për edukim qytetar – të orientuara drejt integrimit ndëretnik dhe edukimit qytetar.**
- **Trajnime dhe seminare të realizuara**
- **Konferenca kombëtare për arsimin profesional dhe shqyrtimin e tregut të punës.**

- **Takime rajonale dhe tubime të drejtorëve dhe përfaqësuesve të shkollave të mesme profesionale.**
- **Forume biznesi dhe tryeza të rrumbullakëta me kompanitë lokale për harmonizimin e programeve mësimore me nevojat e ekonomisë.**
- **Raporti vjetor për punën e shkollës për vitin e kaluar shkollor.**
- **Raporti i vetëvlerësimit të shkollës**
- **Vlerësimi integral**
- **Programi zhvillimor i Shkollës 2026-2030**
- **Planet mësimore dhe programet mësimore modulare për drejtimet dhe profilet e përfaqësuara në shkollë.**

SHTOJCAT	
SHTOJCA 1	**Programi i drejtorit**
SHTOJCA 2	**Programi i ndihmësdrejtorit për mësim**
SHTOJCA 3	**Programet e ndihmësdrejtorit për hulumtim, trajnim dhe zhvillim**
SHTOJCA 4	**Programi i Këshillit arsimor**
SHTOJCA 5	**Programi i punës së Bordit të Shkollës**
SHTOJCA 6	**Programi i punës së Këshillit të prindërve**
SHTOJCA 7	**Programi për organizimin e mësimit**
SHTOJCA 8	**Programi i përgjegjësit të mësimit praktik**
SHTOJCA 9	**Programet e punës së:**
	a) Fushës mësimore profesionale-teorike

	b) Fushës mësimore natyrore-matematikore
	c) Fushës mësimore kulturore-gjuhësore
	ç) Fushës mësimore shoqërore-humanitare
SHTOJCA 10	**Programi i punës së Stacionit për Kontroll Teknik**
SHTOJCA 11	**Programet e Shërbimit Profesional**
	a) Programi i punës së pedagogut
	b) Programi i punës së psikologut
	c) Programi i punës së sociologut
	ç) Programi i punës së defektologut
SHTOJCA 12	**Programi i punës së Ekipit për orientim profesional dhe këshillim për karrierë**
SHTOJCA 13	**Programi i punës së Autoshkollës**
SHTOJCA 14	**Programi për mësim shtesë dhe plotësues**
SHTOJCA 15	**Kodi i sjelljes**
	a) Kodi i sjelljes së mësimdhënësve
	b) Kodi i sjelljes së nxënësve
	c) Kodi i sjelljes së nëpunësve administrativë dhe personelit ndihmës-teknik
	ç) Plani i masave, aktiviteteve dhe përgjegjësive me të cilat sigurohet mjedis i sigurt, profesional dhe i disiplinuar
SHTOJCA 16	**Programi dhe plani i veprimit për vlerësim**
SHTOJCA 17	**Programi për garat e nxënësve**
SHTOJCA 18	**Programi për vetëvlerësimin e shkollës**
SHTOJCA 19	**Programi për realizimin e projekteve**
SHTOJCA 20	**Programi për parandalimin e dhunës**
	a) Politika b) Protokolli c) Plani i veprimit
SHTOJCA 21	**Plani i aktiviteteve të Ekipit Gjithëpërfshirës të Shkollës**
SHTOJCA 22	**Plani vjetor i aktiviteteve të koordinatorit për arsimin praktik**
SHTOJCA 23	**Programi për avancimin e shëndetit të nxënësve**
SHTOJCA 24	**Programi shkollor për zhvillimin profesional të mësimdhënësve**
SHTOJCA 25	**Programi për punë me dobi shoqërore dhe kulturore**
SHTOJCA 26	**Udhëzime për veprim në rast të situatave të krizës**
SHTOJCA 27	**Programi për bashkëpunim me mjedisin dhe bashkësinë lokale**
SHTOJCA 28	**Programi për mbështetjen e procesit arsimor me TIK**
SHTOJCA 29	**Plani për realizimin e mësimit në distancë/të nxënit nga shtëpia**
SHTOJCA 30	**Tabela e strukturës organizative**
SHTOJCA 31	**Programi i punës së këshilltarit të karrierës**
SHTOJCA 32	**Programi i trajnimit për vetëmbrojtje**
SHTOJCA 33	**Programi për edukimin antikorrupsion të nxënësve**
SHTOJCA 34	**Plani dhe Programi vjetor i punës së Këshillit të nxënësve**
SHTOJCA 35	**Plani vjetor i punës së Avokatit të nxënësve**
SHTOJCA 36	**Plani vjetor i punës së ekipit për integrim shkollor**
SHTOJCA 37	**Plani vjetor i punës së komisionit për përgatitjen dhe realizimin e maturës**

Shtojca 1: Programi i punës së drejtorit të Shkollës për vitin 2026/2027

Roli i drejtorit në zhvillimin e shkollës bashkëkohore si sistem organizativ është me rëndësi thelbësore. Koha e ndryshimeve dinamike kërkon nga menaxherët aftësi për të marrë shpejt vendime

të drejta. Drejtor proaktiv është ai që mendon në mënyrë aktive për të ardhmen, planifikon, krijon skenarë për nevojat e ardhshme dhe merr me kohë vendime të mençura.

Në procesin e menaxhimit të një sistemi kompleks siç është QSHA, në fokus të punës së drejtorit është gjithmonë krijimi i një atmosfere besimi dhe sigurie, ku nxënësit dhe të punësuarit do të inkurajohen dhe motivohen të zhvillohen në fushën e tyre dhe të jenë gjithmonë të përgatitur për sfida të reja. Tiparet me të cilat dallohet drejtori janë transparenca në punë dhe planifikimi strategjik me koncept vizionar. Planifikimi strategjik mundëson identifikimin e faktorëve të ndryshëm që përcaktojnë suksesin e organizatës. Përmes analizës së gjendjes në Shkollë, drejtori e lehtëson procesin e vendimmarrjes për fushat prioritare të ndryshimeve. Identifikimi i anëve të dobëta dhe të forta në punë synon tejkalimin e dobësive dhe kultivimin e avancimin e anëve të mira të punës së Shkollës.

Drejtori punon me përkushtim në zhvillimin e planeve për avancimin e zhvillimit të nxënësve përmes strategjive dhe programeve për mbështetjen e tyre. Ai promovon edukimin dhe arsimin gjithëpërfshirës si parim reformues që respekton dhe kultivon diversitetin te të gjithë nxënësit, me theks të veçantë te ata që përballen me rrezik më të madh të margjinalizimit dhe përjashtimit. Bashkëpunimin ndërmjet prindërve dhe mësimdhënësve e njeh qartë si hallkë të rëndësishme në procesin e avancimit të procesit edukativo-arsimor. Forcimi i bashkëpunimit me bashkësinë lokale, të gjithë faktorët dhe aktorët relevantë të proceseve arsimore, partnerët socialë, partnerët ndërkombëtarë dhe kombëtarë është në fokus të punës së drejtorit.

Analiza e hollësishme e gjendjes në aspektin e zhvillimit të veprimtarive plotësuese në Shkollë do të prodhojë plane konkrete për zhvillimin dhe avancimin e veprimtarive përmes strategjive të marketingut dhe promovimit, si dhe zbatimit të një qasjeje inovative në punë. Drejtori është plotësisht i përkushtuar të sigurojë një shkollë ku kuadri shkollor, nxënësit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit punojnë së bashku për ta ndihmuar çdo fëmijë të zhvillojë potencialin e tij të plotë, në një mjedis ku të gjithë ndihen të mirëpritur, të respektuar dhe të vlerësuar dhe zhvillojnë kompetencat e tyre që kontribuojnë në kohezionin social dhe zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Aktivitete zhvillimore

- Hartimi i planit strategjik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;
- qasje inovative në punë përmes vendosjes së profileve të reja që janë tërheqëse dhe konkurruese në tregun e punës;
- mbështetje dhe iniciativë për forcimin e zhvillimit profesional të të punësuarve, me fokus të veçantë në zhvillimin e aftësive digjitale të të punësuarve;
- sigurimi i kushteve për avancimin e arsimit gjithëpërfshirës në Shkollë;
- avancimi i Shkollës si vend i sigurt dhe i mbrojtur për qëndrimin e nxënësve dhe të punësuarve, shkollë që do të mbështetet në parime demokratike dhe në respektimin e vlerave multikulturore;
- drejtori me ekipet e tij do të përcaktojë planin dhe dinamikën për furnizimin me pajisje të reja dhe mjete mësimore për të gjithë sektorët, si dhe disa zgjidhje infrastrukturore që dalin nga Plani Zhvillimor i Shkollës;
- fokus i veçantë do t'i kushtohet zhvillimit dhe digjitalizimit të Shkollës përmes sigurimit të burimeve dhe mbështetjes për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe nxënësve në këtë drejtim;
- do të vazhdojnë aktivitetet për avancimin e veprimtarive plotësuese, duke ndjekur analizat nga terreni;
- theks të veçantë në punën e tij drejtori do t'i kushtojë zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, i cili paraqet forcë shtytëse të procesit edukativo-arsimor dhe të Shkollës në tërësi, të orientuar drejt së ardhmes;
- drejtori i Shkollës është pragmatik dhe efikas në gjetjen e zgjidhjeve krijuese gjatë sfidave të reja dhe të papritura gjatë vitit shkollor.

Në përgjithësi, puna e drejtorit të Shkollës ndahet në dy fusha:

Administrative-organizative:

- delegim i kujdesshëm i detyrave të punës te subjektet përgjegjëse në Shkollë, përcaktim i ekipeve dhe bartësve përgjegjës sipas fushave;

- shpërndarja e lëndëve mësimore dhe obligimeve në kuadër të aktiviteteve të lira shkollore, me fokus të veçantë në nevojat dhe interesat e nxënësve, fushat strukturore të organizimit të brendshëm të Shkollës, fushat mësimore, ekipet e punës dhe komisionet;
- shpërndarja e përgjegjësive lidhur me përgatitjet teknike dhe përgatitjet e tjera për fillimin e vitit shkollor;
- kujdesi për informimin në kohë të nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe të gjithë aktorëve të tjerë në Shkollë për rëndësinë e zbatimit të Rregullit të Shtëpisë në Shkollë dhe të Kodit të nxënësve dhe mësimdhënësve në Shkollë;
- kujdesi për zbatimin e Kodit të sjelljes së nëpunësve administrativë dhe personelit ndihmës-teknik, duke zbatuar njëkohësisht Planin e masave, aktiviteteve dhe përgjegjësive me të cilat sigurohet mjedis i sigurt, profesional dhe i disiplinuar;
- thirrja e rregullt e mbledhjeve të Këshillit arsimor sipas nevojave për funksionimin e pandërprerë të aktiviteteve shkollore dhe udhëheqjen profesionale të Këshillit arsimor;
- ndjekja e udhëzimeve që burojnë nga institucionet relevante arsimore;
- paraqitja e raportit për punën materiale në të gjitha nivelet në Shkollë;
- organizimi i përshtatjes dhe rikonstruktimit të objekteve shkollore dhe hartimi i planit për furnizimin me mjete themelore;
- marrja strategjike e vendimeve dhe masave për inovacion në punën e përgjithshme të Shkollës.

Fusha pedagogjike-instruktive përmban detyra pune që mund të ndahen në disa segmente:

- konceptuale-programore;
- organizimi dhe ndjekja e planifikimeve për mësimdhënie me përfshirje të TIK-ut;
- ndjekja e organizimit dhe realizimit të punës edukativo-arsimore dhe punës tjetër profesionale-pedagogjike;
- zhvillimi dhe zbatimi i mësimit modular në përputhje me programet e reja mësimore;
- formimi i ekipit për realizimin e të mësuarit përmes punës dhe praktikës feriale te punëdhënësit;
- strategji për zhvillimin profesional të të punësuarve përmes përsosjes së vazhdueshme profesionale, pedagogjike dhe personale;
- sigurimi i kushteve për punë me mësimdhënës fillestarë përmes mbështetjes mentoruese;
- punë me organet dhe trupat profesionalë;
- punë analitike-studimore;
- bashkëpunim me nxënësit dhe organizatat e klubet e nxënësve në të gjitha nivelet;
- ndjekja e braktisjes së shkollimit nga nxënësit dhe e rregullsisë në mësim, si dhe ndërmarrja e hapave për tejkalimin e gjendjeve;
- transparencë në punë përmes informimit të vazhdueshëm për mënyrën e punës së të gjithë aktorëve në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet shkollore;
- mbështetje dhe iniciativa për zbatimin e programeve për kujdesin dhe mbrojtjen e nxënësve (Programi për orientim profesional, Programi për avancimin e shëndetit, Programi për punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësi në të nxënë, Programi për përballimin dhe parandalimin e dhunës, Programi për eko-përmbajtje, Programi për mbështetjen e arsimit të integruar ndëretnik, puna e Qendrës së karrierës etj.);
- krijimi i kushteve për një klimë shkollore të këndshme dhe të sigurt;
- promovimi dhe mbështetja e arritjeve të mësimdhënësve, nxënësve dhe të gjithë të punësuarve në Shkollë;
- pjesëmarrje konstruktive në punën e Bordit të Shkollës;
- udhëheqja e ekipit përgjegjës për krijimin e Planit Zhvillimor të Shkollës, në bazë të Vetëvlerësimit të Shkollës të realizuar paraprakisht në mënyrë profesionale;
- elaborate zhvillimore për projekte të reja dhe veprimtari të reja;
- bashkëpunim me mjedisin lokal, prindërit, institucionet, partnerët socialë, partneritetet kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

Zhvillimi profesional i drejtorit

- Drejtori do të zhvillojë vazhdimisht aftësitë e menaxhimit dhe udhëheqjes, duke u udhëhequr nga një koncept vizionar i orientuar drejt së ardhmes, do të studiojë literaturë për menaxhimin arsimor dhe do të ndjekë rrjedhat bashkëkohore në procesin edukativo-arsimor;
- do të marrë pjesë në seminare, trajnime dhe konferenca të organizuara nga ofrues të jashtëm;
- do të marrë pjesë në diseminimet e mësimdhënësve të cilët, mbi baza të ndryshme, kanë ndjekur seminare, konferenca dhe përgatitje të tjera profesionale;
- organizimi i garës ndërkombëtare „Automekaniku i ri evropian 2027“, e cila do të mbahet në Shkup;
- pjesëmarrje në garën ndërkombëtare për automekanikë nga vendet e Evropës Juglindore në Sarajevë, Bosnjë;
- pjesëmarrje në simpoziumin „Ndërdisiplinariteti i logjistikës dhe komunikacionit“, në Podgoricë, Mal të Zi
- pjesëmarrje në seminare për arsim të integruar multikulturor;
- pjesëmarrje në konferenca dhe manifestime për promovimin dhe avancimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Plan operativ

Gusht

- Kontrolli i të gjitha hapësirave të Shkollës për përcaktimin e gjendjes higjienike para fillimit të vitit shkollor dhe dezinfektimi i plotë i Shkollës;
- mbajtja e mbledhjes së Këshillit arsimor, e para pas pushimit veror, lidhur me mbajtjen e provimeve plotësuese dhe shpërndarjen e lëndëve mësimore;
- organizimi dhe realizimi i maturës profesionale shkollore dhe provimit përfundimtar;
- dhënia e udhëzimeve për përgatitjen e planifikimeve vjetore;
- teza për përgatitjen e programeve/shtojcave vjetore;
- takime me ekipet dhe dhënia e udhëzimeve për punë, drejtime për format e raportimit në nivel javor dhe mujor;
- përgatitja e Raportit vjetor dhe Programit vjetor;
- shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për punën edukativo-arsimore të Shkollës në vitin shkollor 2025/2026, në Këshillin arsimor dhe Bordin e Shkollës;
- shqyrtimi dhe miratimi i Programit vjetor të punës së Shkollës për vitin e ri shkollor 2026/2027 nga Bordi i Shkollës, pas mendimit paraprak pozitiv të Këshillit të prindërve dhe Këshillit arsimor;
- përgatitjet përfundimtare për pritjen e nxënësve në ditën e parë të shkollës;
- pasqyrë e plotë e aktiviteteve të projekteve me karakter ndërkombëtar;
- hartimi i elaborateve për veprimtaritë zhvillimore;
- kontrolli i të gjitha procedurave të përcaktuara për punën arsimore dhe administrative, si dhe shqyrtimi i nevojës për procedura të reja;
- përgatitja e kushteve materiale-teknike për realizimin e mësimit modular;
- përgatitja e një rregulloreje të re për shpërblimin e të punësuarve;
- përgatitja e Shkollës për fillimin e suksesshëm të vitit shkollor.

Shtator

- Pritja e nxënësve në vitin e ri shkollor;
- mbajtja e takimit me të punësuarit që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në punën edukativo-arsimore;
- organizimi i funksionimit të plotë të internetit në Shkollë;
- vendosja e aktiviteteve për partneritete me shkolla të tjera profesionale në Evropë;
- organizimi i aktiviteteve me rastin e 8 Shtatorit;
- organizimi i anketës për mësimin fakultativ të lëndëve mësimore ose përmbajtjeve përkatëse në kuadër të aktiviteteve të lira;
- mbajtja e takimeve me prindër dhe njohja e tyre me risitë në mësim, Programin vjetor të punës së Shkollës, theksimi i rëndësisë së vijueshmërisë, të nxënit dhe ruajtjes së pronës së Shkollës dhe Kodit të sjelljes ndërmjet nxënësve, si dhe pranimi i sugjerimeve për realizimin e planeve mësimore;
- aktivitete për përgatitjen e strategjisë për futjen e sistemit të mentorimit dhe strategjive të reja për cilësi;
- vendosja e modelit bazë për burimet njerëzore,

- organizimi i ekskursioneve me nxënësit në rrethinën e Shkupit dhe, sipas mundësisë, ekskursion me nxënësit e viteve përfundimtare jashtë shtetit;
- ndjekja e punës së sekretarit të Shkollës lidhur me ndryshimet në dispozitat ligjore, informimi i mësimdhënësve, përmirësimi i veçantë i sistematizimit dhe Marrëveshjes Kolektive; shqyrtimi i funksionimit të procedurave të reja të punës;
- zbatimi i vetëvlerësimit dhe raportimit për punën vetjake nga të gjitha subjektet që marrin pjesë në drejtim dhe në ekipin menaxhues;
- njohja me Kodin e sjelljes së nxënësve dhe mësimdhënësve në Shkollë dhe vendosja e informatave në vende të dukshme në hapësirat shkollore;
- përgatitja e kritereve për vlerësimin e të punësuarve;
- afishimi i orarit për mësim shtesë dhe plotësues, si dhe ditës së pranimit dhe ditës së hapur për prindër;
- përcaktimi i bazave përmbajtësore të udhëheqjes së klasës dhe dosjes për çdo nxënës;
- shqyrtimi i përgatitjeve globale, tematike dhe ditore të mësimdhënësve;
- nga aspekti i inovacionit të projektit për burimet njerëzore – shqyrtimi i përshkrimit të vendeve të punës dhe udhëzimeve për punë;
- sigurimi i kushteve për realizimin e Planit për mësim në distancë, të parashikuar me Programin vjetor të Shkollës, nëse paraqitet nevoja për çfarëdo arsyeje jashtë kontrollit tonë. Përvojat e së kaluarës na kanë mësuar se duhet të jemi të përgatitur për çdo mundësi me qëllim realizimin e suksesshëm të procesit mësimor;
- realizimi i aktiviteteve me shkollën nga Bursa e Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit të përbashkët.

Tetor

- Udhëzime për formimin e bashkësive të klasave dhe të nxënësve dhe organizatave të tjera të nxënësve mbi baza demokratike, si dhe nxitja e punës së klubeve dhe seksioneve të veçanta të nxënësve;
- analiza e gjendjeve në shkollë dhe parandalimi i çdo lloj dhune dhe pakënaqësie te nxënësit, krijimi i klimës stimuluese për të punësuarit dhe nxënësit,
- ndjekja e realizimit të Programit mësimor;
- ndjekja dhe vlerësimi nga mësimdhënësit në Shkollë;
- përgatitja e strategjisë për veprim si Qendër për trajnim dhe karrierë;
- përgatitja e Planit për bashkëpunim ndërkombëtar;
- mbështetje dhe pjesëmarrje në ekipet e punës të projekteve „Erasmus+“:
    - Projekt KA1 për mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në kuadër të akreditimit Erasmus për periudhën 2021–2027.
    - Projekte të tjera
- shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor;
- krijimi i Programit për zhvillimin profesional të të punësuarve;
- aktivitete të vazhdueshme për zhvillimin e veprimtarive dhe krijimin e ideve për aspekte të reja në sektorin e biznesit;
- pjesëmarrje në simpoziumin **„Ndërdisiplinariteti i logjistikës dhe komunikacionit**“, Podgoricë, Mal të Zi

Nëntor

- Ndjekja dhe analiza e problemeve në lëndë të caktuara mësimore që janë paraqitur në fillim të vitit shkollor;
- mbajtja e takimit me udhëheqjen e këshillit të shkollës;
- vizita në orë mësimore;
- analiza e vijueshmërisë së nxënësve dhe propozimi i masave për përmirësim;
- organizimi i aktiviteteve me rastin e festës së 13 Nëntorit; bashkëpunim i vazhdueshëm me institucionet;
- mbështetje dhe pjesëmarrje në ekipet e punës të projekteve „Erasmus+“:
- projekt KA1 për mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në kuadër të akreditimit Erasmus për periudhën 2021–2027.
- Projekte të tjera.

Dhjetor
- Ndjekja e realizimit të Programit mësimor;
- vizita në orë mësimore;
- organizimi i takimeve me prindër dhe pjesëmarrja në disa prej tyre;
- përgatitja për përfundimin e suksesshëm të gjysmëvjetorit të parë;
- analiza e aktiviteteve të lira të nxënësve;
- shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor;
- vlerësimi i të punësuarve me zbatimin e kritereve;
- zbatimi i kritereve të vlerësimit;
- organizimi i projekteve shkollore;
- sigurimi i kushteve për realizimin e Planit për mësim në distancë të parashikuar me Programin vjetor të Shkollës, nëse është e nevojshme;
- mbështetje dhe pjesëmarrje në ekipet e punës të „Erasmus+“:
- projekt KA1 për mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në kuadër të akreditimit Erasmus për periudhën 2021–2027.

Janar
- Organizimi dhe realizimi i Provimit përfundimtar;
- mbledhje e Këshillit arsimor për përcaktimin e suksesit në gjysmëvjetorin e parë dhe analizën e aktiviteteve jashtëmësimore në Shkollë;
- përgatitja e Raportit për punën edukativo-arsimore të Shkollës në gjysmëvjetorin e parë;
- përgatitja e planit të përkohshëm financiar për vitin kalendarik vijues;
- organizimi i inventarizimit – mbajtja e mbledhjes së Bordit të Shkollës;
- shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor;
- aktivitete për vazhdimin e bashkëpunimit me shkollat e asociacionit „Automekaniku i ri evropian“ – këtë vit do të mbahet në Shkup;
- aktivitete me partnerët në bashkëpunimin ndërkombëtar;
- mbështetje dhe pjesëmarrje në ekipet e punës të projekteve „Erasmus+“:
- projekt KA1 për mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në kuadër të akreditimit Erasmus për periudhën 2021–2027.
- Projekte të tjera.

Shkurt
- Analiza e rezultateve të nxënësve sipas fushave mësimore;
- mbajtja e mbledhjes së Këshillit arsimor me informacion për analizën e rezultateve të nxënësve sipas fushave mësimore dhe këshillave të viteve, si dhe njoftim për procesin e mentorimit;
- organizimi i takimeve me prindër për njoftimin e suksesit dhe masave për përmirësimin e tij;
- mbledhje e Bordit të Shkollës për përcaktimin e llogarisë përfundimtare;
- organizimi i takimeve me Këshillin e Prindërve;
- mbajtja e takimit me udhëheqjet e këshillit të shkollës;
- shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor;
- formimi i komisioneve dhe strategjisë së re për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë.

Mars
- Vizita në orë mësimore, analizë e vizitave;
- aktivitete për realizimin e suksesshëm të një ekskursioni të mundshëm me nxënësit e klasave përfundimtare;
- përgatitje për adaptimin dhe sanimin e Shkollës gjatë pushimit veror;
- kontrolli i funksionimit të këshillimit dhe orientimit profesional dhe i punës së Qendrës për karrierë;
- shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor, vlerësimi i strukturave drejtuese përgjegjëse për zbatimin;
- mbështetje dhe pjesëmarrje në ekipet e punës të projekteve „Erasmus+“:
- projekt KA1 për mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në kuadër të akreditimit Erasmus për periudhën 2021–2027.
- Projekte të tjera.

Prill
- Analiza e suksesit të nxënësve sipas fushave mësimore;
- mbledhje e Këshillit arsimor për suksesin e nxënësve në tremujorin e gjysmëvjetorit të dytë;
- organizimi i takimeve me prindër dhe njohja e tyre me suksesin e fëmijëve;

- shqyrtimi i realizimit të programeve për kujdesin ndaj nxënësve; - shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor; - vizita në orë mësimore; - organizimi i ekskursionit me nxënësit në rrethinën e Shkupit; - aktivitete rreth organizimit të garave shtetërore dhe ndërkombëtare, - aktivitete për organizimin e patronatit të Shkollës dhe një ekskursioni të mundshëm të të punësuarve; - pjesëmarrje në garën ndërkombëtare për automekanikë nga vendet e Evropës Juglindore, e cila këtë vit do të mbahet në Sarajevë, Bosnjë. - mbështetje dhe pjesëmarrje në ekipet e punës të projekteve „Erasmus+“: - projekt KA1 për mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në kuadër të akreditimit Erasmus për periudhën 2021–2027. - Projekte të tjera.
Maj - Vlerësimi i të punësuarve me zbatimin e kritereve; - përgatitja për përfundimin e punës dhe mësimit me klasat përfundimtare; - kontrolli i përgatitjeve rreth ekskursionit të mundshëm, mbrëmjes së maturës dhe ndarjes së diplomave; - përgatitje për Maturën Shtetërore, Maturën Profesionale Shtetërore, Maturën Shkollore dhe Provimin Përfundimtar, - shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor, - ndjekja e zbatimit të strategjisë së regjistrimit, - bashkëpunimi me mediat, - ndjekja e aktiviteteve për Maturën Shtetërore, Maturën Profesionale Shtetërore, Maturën Shkollore dhe Provimin Përfundimtar, organizimi i komisioneve, - përgatitje për mbrëmjen e maturës dhe të gjitha aktivitetet e komisioneve për mbrëmjen e maturës dhe tablonë e maturës; - pjesëmarrje dhe organizim i garës ndërkombëtare „Automekaniku i ri evropian 2027“, Shkup; - mbështetje dhe pjesëmarrje në ekipet e punës të projekteve „Erasmus+“: - projekt KA1 për mobilitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në kuadër të akreditimit Erasmus për periudhën 2021–2027. - Projekte të tjera
Qershor - Përgatitje për përfundimin e mësimit dhe vitit shkollor; - këshilla të klasave dhe Këshilli arsimor për përcaktimin e suksesit të nxënësve; - përgatitja e planit për numrin e paraleleve, shpërndarjen globale të lëndëve mësimore dhe kujdestarive të klasave për vitin e ardhshëm shkollor; - mbledhje e Bordit të Shkollës lidhur me obligimet që do të dalin nga përfundimi i vitit shkollor; - shqyrtimi i realizimit të Programit vjetor; - seminare dhe takime me të punësuarit për realizimin e aktiviteteve, vështrim kritik dhe udhëzime për vitin e ardhshëm.

Përveç obligimeve të përcaktuara, drejtori do ta ndjekë dhe koordinojë punën e përgjithshme në Shkollë dhe do të kryejë e do t'i përgjigjet çdo obligimi tjetër që do të lindë gjatë vitit shkollor. Një herë në muaj, e sipas nevojës edhe më shpesh, do të realizojë takime me ekipin menaxhues, përmes të cilave do të ndjekë punën dhe realizimin e Programit Vjetor.

Drejtori i Shkollës gjen mënyra krijuese dhe efikase për realizimin e aktiviteteve të parapara në situata të jashtëzakonshme, si pandemi ose gjendje të natyrës tjetër, me qëllim realizimin e suksesshëm të procesit edukativo-arsimor.

Drejtori,
ing. i dipl. i makinerisë Aleksandar Strezov

Shtojca 2: Programi i punës së ndihmësdrejtorit për mësim për vitin shkollor 2026/2027

Puna e ndihmësdrejtorit gjatë vitit shkollor 2026/2027 do të konsistojë në ndërmarrjen e hapave të sistematizuar në drejtim të përmirësimit, përkatësisht avancimit dhe modernizimit të procesit edukativo-arsimor, i cili duhet të paraqesë një sistem të përbërë nga disa segmente funksionalisht të ndërlidhura që do ta realizojnë punën edukativo-arsimore në mënyrën më efikase.

Për realizimin e këtyre qëllimeve nevojitet bashkëpunim i madh me drejtorin e Shkollës, përgjegjësit e mësimdhënies (teorike dhe praktike), shërbimet profesionale në Shkollë, të gjithë mësimdhënësit lëndorë, nxënësit dhe prindërit, si dhe të gjitha subjektet dhe institucionet e tjera të lidhura me arsimin në të gjitha nivelet.

Përveç detyrave të vazhdueshme të ndihmësdrejtorit, të cilat lidhen me organizimin, ndjekjen dhe analizimin e vazhdueshëm të këtij procesi, fushat më të rëndësishme të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje më e madhe gjatë vitit shkollor 2026/2027 janë këto:

- pranimi i nxënësve në vitin e ri shkollor (listat, numri i nxënësve, orari i klasës, dorëzimi i materialit për Kodin e sjelljes së nxënësve dhe obligimet e tjera të nxënësve);
- avancimi i procesit mësimor sipas Programit të mentorimit të mësimdhënësve dhe strategjive të reja për cilësinë e mësimdhënies;
- organizimi i takimeve me prindër dhe njohja e prindërve me programin mësimor, vënia në dukje e rëndësisë së rregullsisë, të nxënit dhe ruajtjes së pronës së shkollës dhe Kodit të sjelljes së nxënësve;
- zbatimi i kritereve për vlerësimin e të punësuarve dhe puna sipas tyre;
- dhënia e udhëzimeve për formimin e bashkësive të klasave dhe bashkësive të nxënësve;
- ndjekja e realizimit të Programit mësimor;
- analiza e rregullsisë së nxënësve dhe propozimi i masave për përmirësim;
- aktivitete për organizimin e suksesshëm të ekskursioneve, festave, garave dhe manifestimeve të tjera;
- ndjekja e organizimit dhe realizimit të punës edukativo-arsimore dhe punës tjetër profesionale-pedagogjike;
- punë me mësimdhënësit fillestarë;
- organizimi i provimit shtetëror për mësimdhënësit;
- punë me organet dhe trupat profesionalë;
- bashkëpunim me mjedisin lokal, prindërit, institucionet dhe ndërmarrjet;
- nxitja dhe mbështetja e programeve për kujdesin dhe mbrojtjen e nxënësve (Programi për orientim profesional, Programi për avancimin e shëndetit, Programi për punë me nxënës me vështirësi të veçanta etj.);
- ruajtja e pronës së shkollës (kabinete etj.);
- krijimi i kushteve për një klimë shkollore të këndshme dhe të sigurt për realizimin e punës edukativo-arsimore;
- organizimi i takimit me drejtuesit e aktiveve, çdo muaj;
- organizimi i takimeve me përgjegjësit e mësimdhënies (teorike dhe praktike) dhe me Shërbimin Profesional, çdo javë;
- kontrolli i kompjuterëve për mësimdhënësit në të gjitha kabinetet.

Program operativ

AKTIVITETET	REALIZUESI	KOHA
- Përgatitjet përfundimtare dhe pritja e nxënësve në ditën e parë të shkollës, përcaktimi dhe orientimi i nxënësve; - Pritja e nxënësve në vitin e ri shkollor 2026/2027 (dhënia e udhëzimeve për mësimdhënësit dhe kujdestarët e klasave). - Organizimi dhe koordinimi i punës së të gjithë pjesëmarrësve në procesin edukativo-arsimor: - zbatimi i kritereve për vlerësimin e të punësuarve; - vlerësimi i të punësuarve me zbatimin e kritereve; - vijueshmëria e mësimdhënësve dhe nxënësve; - dokumentacioni pedagogjik; - orari, kujdestaritë.	Ndihmësdrejtori për mësim, drejtori.	Në vazhdimësi
- Vizita në orët mësimore të mësimdhënësve; - organizimi i aktiviteteve për fillimin e suksesshëm të vitit shkollor dhe përfundimin e suksesshëm të gjysmëvjetorit të parë.	Ndihmësdrejtori për mësim, drejtori.	Gjatë gjithë vitit shkollor
Rritja e efikasitetit në mbajtjen e dokumentacionit pedagogjik: - këshillim, udhëzime dhe trajnime (organizimi i seminareve nga mësimdhënës që i përgatisin me sukses).	Ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional.	Në vazhdimësi
Shqyrtimi dhe ndjekja e mbajtjes së dokumentacionit pedagogjik të mësimdhënësve (kontrolli i ditarëve, librave amë, planeve globale, përgatitjeve tematike...), zbatimi i përgatitjeve globale, tematike dhe ditore në formë elektronike para fillimit të vitit shkollor, ndjekja e punës në e-Ditar.	Ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional.	Çdo muaj me procesverbal të bashkëngjitur dhe propozim-masa
- Biseda, konsultime dhe dhënie këshillash mësimdhënësve lidhur me organizimin e mësimit dhe edukimin e nxënësve.	Ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional.	Gjatë gjithë vitit shkollor
Bashkëpunimi me shërbimin pedagogjik-psikologjik lidhur me shqiptimin e masave pedagogjike; - organizimi i aktiviteteve dhe ligjëratave.	Ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional.	Gjatë gjithë vitit shkollor
Ndjekja e punës së mësimdhënësve të rinj dhe ofrimi i ndihmës së nevojshme.	Ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional.	Gjatë gjithë vitit shkollor
Organizimi i punës me nxënësit problematikë dhe të talentuar.	Ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional.	Në çdo tremujor
Organizimi dhe informimi për data të rëndësishme të historisë sonë gjatë gjithë vitit	Ndihmësdrejtori për mësim, përgjegjësi i fushës mësimore shoqërore-humanitare, përgjegjësit e mësimit.	Sipas kalendarit
Organizimi i aktiviteteve ekologjike, (shkolla jonë është e përfshirë në programin „Eko-shkollë“), organizimi i aktiviteteve për Ditën	Ndihmësdrejtori për mësim, drejtori,	Gjatë gjithë vitit shkollor

e Pemës; vizita në organizata të ndryshme: panaire; autoservise; reparte prodhuese.	mësimdhënësit e lëndëve, përgjegjësit e mësimit teorik dhe praktik.	
Vizita në orët mësimore (dy herë në vit te secili mësimdhënës).	Ndihmësdrejtori për mësim, drejtori.	Gjatë gjithë vitit shkollor
Organizimi i furnizimit me libra për nevojat e shkollës.	Ndihmësdrejtori për mësim, bibliotekari.	Gjatë gjithë vitit shkollor
Pjesëmarrja dhe udhëheqja e punës së këshillave të klasave dhe Këshillit arsimor.	Ndihmësdrejtori për mësim, drejtori, përgjegjësit e mësimit.	Gjatë gjithë vitit shkollor
- Shqyrtimi i realizimit të takimeve me prindër, raport sipas të gjitha pikave të rendit të ditës (katër herë gjatë vitit, me procedurat e takimeve me prindër). - Të mbajë evidencë me shkrim për takimet me prindër, rendin e ditës, praninë (në numra), ndërsa kohë pas kohe të organizohet edhe përmbajtje aktuale.	Ndihmësdrejtori për mësim, Shërbimi profesional.	Shtator, nëntor, janar, prill, qershor
- Realizimi i shpërndarjes së fletëve të evidencës dhe dëftesave.	Ndihmësdrejtori për mësim.	Dhjetor, maj, qershor
- Bashkëpunimi me bashkëpunëtorin e informatikës për përgatitjen e dokumenteve të ndryshme për ndjekjen e suksesit të nxënësve dhe punës së mësimdhënësve.	Ndihmësdrejtori për mësim, bashkëpunëtori profesional për informatikë.	Gjatë gjithë vitit shkollor
- Ndjekja dhe organizimi i një ekskursioni të mundshëm në qytet, mbrëmjes së maturës, ndarjes së diplomave etj.; - Ndihmë koordinatorit për Maturën Shtetërore dhe Provimin Përfundimtar në vitin shkollor 2026/2027 në Shkollë.	Ndihmësdrejtori për mësim, drejtori, përgjegjësit e mësimit kujdestarët e klasave.	Fillimi i gjysmëvjetorit të dytë
- Mbështetja e mësimdhënësve që përgatisin nxënës për gara. - Aktivitete për vazhdimin e bashkëpunimit me shkollat e asociacionit „Automekaniku i Ri“. - Mbajtja e evidencës për të gjitha garat në të gjitha nivelet dhe për vendet e fituara.	Ndihmësdrejtori për mësim, mësimdhënësit e lëndëve.	Shkurt - maj
- Përgatitja dhe zbatimi i anketës ndërmjet nxënësve të vitit të dytë dhe të tretë për lëndët zgjedhore.	Ndihmësdrejtori për mësim, përgjegjësit e mësimit	Prill
- Bashkëpunimi me MPB-në dhe strukturat e tjera kompetente për ruajtjen e rendit dhe disiplinës në shkollë.	Ndihmësdrejtori për mësim, kujdestarët e klasave, Shërbimi profesional.	Gjatë gjithë vitit shkollor
- Portofoli i kujdestarit të klasës – organizim, rishikim, kontroll (4 kontrolle). - Zhvillimi i procedurës për informimin e nxënësve dhe prindërve. - Evidencë edhe për aktivitete të tjera. - Evidencë për çdo festë, mënyrën si është shënuar, ruajtja e referateve.	Ndihmësdrejtori për mësim, përgjegjësit e mësimit. Kujdestarët e klasave. Shërbimi profesional.	Në vazhdimësi Gjatë gjithë vitit shkollor

- Lidhja e mësimit teorik me atë praktik, - përfshirja e mësimdhënësve të mësimit praktik në të gjitha llojet e aktiviteteve në Shkollë, - bashkëpunim më i madh ndërmjet mësimdhënësve të mësimit teorik, veçanërisht të lëndëve profesionale,	Ndihmësdrejtori për mësim, përgjegjësit e aktiveve, grup mësimdhënësish.	Në vazhdimësi
- Bashkëpunimi me mediat, - Strategjia për regjistrimin e nxënësve, - Përgatitja për procesin mësimor në fund të vitit shkollor 2026/2027.	Ndihmësdrejtori për mësim.	Maj, qershor

Ndihmësdrejtori për mësim,
dr. Zekirija Zekiri

Shtojca 3: Programi i punës së ndihmësdrejtorit për kërkim, trajnim dhe zhvillim të Shkollës për vitin 2026/2027

Ndihmësdrejtori për kërkim, trajnim dhe zhvillim, në përputhje me Programin vjetor të punës së Qendrës, do t'i orientojë aktivitetet e tij drejt:

- avancimit të cilësisë së procesit edukativo-arsimor në Shkollë duke ndjekur trendet e reja në arsim;
- zhvillimit të bashkëpunimit me bashkësinë lokale, të gjithë faktorët dhe aktorët relevantë të proceseve arsimore, partnerët socialë dhe bashkëpunëtorët ndërkombëtarë;
- analizimit të nevojave të tregut të punës për vendosjen e profileve të reja arsimore në Shkollë;
- avancimit të bashkëpunimit me partnerët socialë për realizimin e suksesshëm të obligimeve gjatë realizimit të praktikës feriale dhe të mësuarit përmes punës te punëdhënësi, në përputhje me planet mësimore modulare;
- zbatimit të mësimit modular në procesin arsimor në Shkollë;
- organizimit dhe realizimit të trajnimeve për të rritur, si mbështetje e tendencave në arsimin bashkëkohor për të mësuar gjatë gjithë jetës, përmes formimit të Qendrës për Trajnim dhe Karrierë në Shkollë;
- ndjekjes së zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- intensifikimit të bashkëpunimit me prindërit në funksion të promovimit të profileve ekzistuese arsimore në Shkollë dhe tendencave të reja në sistemin arsimor;
- një qasjeje të re në mësimin praktik në aspektin e zbatimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies me përdorimin e pajisjeve, makinerive dhe mjeteve të reja në procesin mësimor;
- sigurimit të kushteve dhe burimeve për realizimin e projekteve të filluara dhe gjatë aplikimit për projekte të reja;
- analizës së punës së veprimtarive plotësuese, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe rezultateve të saj;
- intensifikimit të bashkëpunimit me bashkësinë lokale dhe afariste dhe me sektorin joqeveritar në drejtim të zhvillimit të veprimtarive plotësuese, e me këtë edhe përmirësimit të kushteve të punës dhe cilësisë në mësimdhënie;
- rritjes së pjesëmarrjes së veprimtarive plotësuese në hapësirën mediatike, me qëllim njohjen e publikut më të gjerë me mundësitë dhe kapacitetet e Shkollës në të gjitha fushat;
- ndjekjes dhe zbatimit të dispozitave të reja ligjore.

Puna e ndihmësdrejtorit për kërkim, trajnim dhe zhvillim të Shkollës ndahet në disa fusha:

Punë instruktive-administrative:

- punë këshilluese dhe bashkëpunim me drejtorin e Shkollës, bartësit e përgjegjësisë për sektorë dhe fusha konkrete, si dhe me Shërbimin Profesional në Shkollë;
- shpërndarja e obligimeve lidhur me përgatitjet teknike dhe përgatitjet e tjera për fillimin e vitit shkollor;
- udhëheqja e zbatimit të Planit Zhvillimor të Shkollës;
- kujdesi për zbatimin e Rregullit të Shtëpisë në Shkollë dhe Kodit të nxënësve dhe mësimdhënësve në Shkollë, Kodit të sjelljes së nëpunësve administrativë dhe personelit ndihmës-teknik, si dhe Planit të masave, aktiviteteve dhe përgjegjësive me të cilat sigurohet mjedis i sigurt, profesional dhe i disiplinuar;
- mbështetje për realizimin e të gjitha programeve zhvillimore dhe strategjive për avancimin dhe zhvillimin e Shkollës;
- pjesëmarrje në krijimin e planit për furnizimin me mjete themelore dhe realizimin e tij;
- aktivitete për mirëmbajtjen dhe plotësimin e pajisjeve të TIK-ut;
- ndjekja e konkurseve, tenderëve dhe ofertave për nevojat e Shkollës;
- shfrytëzimi i analizave nga viti i kaluar shkollor dhe ndërmarrja e masave për avancimin e organizimit dhe punës së Shkollës;
- mbështetje për drejtorin gjatë formimit të paraleleve, shpërndarjes së orëve dhe kujdestarëve të klasave, krijimit të ekipeve, përcaktimit të mësimdhënësve përgjegjës dhe obligimeve;
- përgatitje për pranimin e nxënësve të vitit të parë më 1 shtator;
- punë me komisione, koordinim të ekipeve dhe aktiveve;
- mbikëqyrje e organizimit ditor të punës, dokumentacionit pedagogjik dhe dokumentacionit elektronik;
- promovimi i mundësive që i ofron Shkolla para klientëve të rinj dhe ekzistues përmes mediave sociale;
- ndjekja e braktisjes së shkollimit nga nxënësit dhe e rregullsisë në mësim, si dhe krijimi i strategjive për tejkalimin e gjendjeve;
- hartimi i raporteve (gjysmëvjetore dhe vjetore), informatave dhe analizave, si dhe vështrimeve lidhur me realizimin e programeve të punës edukativo-arsimore;
- motivimi për pjesëmarrje aktive në ndjekjen e rregullimit estetik të hapësirës në Shkollë dhe të oborrit;
- iniciativë për organizimin e garave shkollore, debateve dhe diskutimeve;
- nxitja e të punësuarve në veprimtaritë plotësuese për kreativitet në punë, gjë që do të rezultonte me rritje të efikasitetit në këta sektorë.

Ndjekja e punës profesionale-pedagogjike në Shkollë dhe e zhvillimit profesional të kuadrit mësimor:

- mbikëqyrje e mësimdhënies dhe krijimi i programeve për avancimin e saj;
- analizë, përfundime dhe propozim-masa për avancimin e organizimit të Shërbimit Profesional, komisioneve, ekipeve etj., në raport me realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe detyrave të vazhdueshme, si dhe avancimin e komunikimit përmes vendosjes së komunikimit elektronik dhe rrjedhës së informatave;
- krijimi i kushteve për një klimë shkollore të këndshme dhe të sigurt;
- mbështetje dhe hartim i elaborateve zhvillimore për projekte të reja ose veprimtari të reja;
- bashkëpunim me mjedisin lokal, institucionet dhe ndërmarrjet;
- mbështetje për aplikim dhe pjesëmarrje në projekte;
- organizimi i takimeve informuese me mësimdhënësit, aktivet profesionale dhe përfaqësuesit e bashkësive të nxënësve;
- ndjekja aktive e punës ekipore, delegimit të obligimeve, respektimit të afateve dhe realizimit të procesit edukativo-arsimor dhe aktiviteteve jashtëmësimore;
- organizimi dhe ndjekja e planifikimit të mësimdhënies përmes zbatimit të TIK-ut;
- mbështetje për koordinatorin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në përgatitjet për krijimin e planit operativ për trajnime të brendshme (plan trajnimesh, tema, trajnerë, kornizë kohore, fletë vlerësimi etj.);
- prezantime motivuese për kuadrin, me qëllim nxitjen e vetëpërsosjes;

- sigurimi i materialeve të përshtatshme dhe kushteve teknike për përsosjen profesionale të mësimdhënësve;
- takime këshilluese dhe konsultative me aktivet profesionale;
- ndjekja e mësimdhënësit gjatë zbatimit të risive në mësimdhënie;
- ndjekja e akteve ligjore, rregulloreve për veprimtarinë, koordinimeve dhe takimeve;
- prani e rregullt në të gjitha mbledhjet e aktiveve profesionale në Shkollë dhe në Këshillin e Prindërve, si dhe nxitja e diskutimeve profesionale;
- bashkëpunimi me prindërit për përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në procesin e hartimit të planeve dhe programeve në Shkollë, marrjen e vendimeve të rëndësishme shkollore, propozimeve dhe iniciativave për ndryshime të caktuara në drejtim të avancimit të procesit edukativo-arsimor.

Zhvillimi profesional i ndihmësdrejtorit për kërkim, trajnim dhe zhvillim të Shkollës:

- ndjekja e vazhdueshme e trendeve botërore për menaxhimin e institucioneve arsimore përmes përdorimit të literaturës profesionale nga fusha e lidershipit dhe menaxhimit arsimor;
- ndjekja e trajnimeve, edukimeve dhe literaturës në drejtim të avancimit të zhvillimit personal profesional, konkretisht në fushën e nxitjes së motivimit të brendshëm dhe të jashtëm te të punësuarit;
- pjesëmarrje në trajnime, seminare dhe konferenca nga fusha e arsimit gjithëpërfshirës, me qëllim zbatimin më të suksesshëm dhe aplikimin praktik të tij në shkollën tonë;
- pjesëmarrje në seminare për integrimin edhe më të suksesshëm të parimeve të vendosura për integrim ndëretnik dhe arsim multikulturor;
- pjesëmarrje në trajnime profesionale, edukime, seminare, konferenca, punëtori dhe gara të parapara me Programin Vjetor të Shkollës.

SEKTORI	***AKTIVITETET***	***Bashkëpunëtorët/ periudha e realizimit***
PUNA EDUKATIVO–ARSIMORE PUNA ***(MËSIMI TEORIK, PRAKTIK)***	- Ndërmarrja e aktiviteteve lidhur me përgatitjen e Raportit vjetor dhe Programit vjetor të punës së Shkollës; - Bashkëpunimi me institucionet për zhvillimin efikas të procesit arsimor në Shkollë; - Bashkëpunimi me organizatat lokale dhe partnerët socialë, sipas nevojave të Shkollës; - Kontrolli i dokumenteve të kandidatëve të regjistruar në arsimin me korrespondencë; - Përgatitja e orareve për: komisionet për realizimin e provimeve të jashtëzakonshme për arsimin trevjeçar dhe katërvjeçar, komisionet për realizimin e Provimit Përfundimtar dhe Maturës Shtetërore; - Përgatitja e orarit me obligimet gjatë pushimit dimëror dhe veror; - Përgatitja e kalendarit për mbajtjen e sesioneve të provimeve për arsimin specialistik trevjeçar dhe katërvjeçar; - Përgatitja e procedurave për zhvillimin e aktiviteteve të	Ndihmësdrejtori për HKZH, drejtori, ndihmësdrejtori për mësim, përgjegjësit e ndërrimeve, shefat e aktiveve mësimor / në vazhdimësi

	ndryshme në Shkollë sipas nevojave; - Pjesëmarrja në punën e aktiveve; - Përgatitja e raporteve, tabelave dhe evidencave të ngjashme për nevojat e institucioneve lokale.	
	- Pjesëmarrja në ekipet e punës të projekteve „Erasmus+“: - Bashkëpunimi me Qendrën Shtetërore të Provimeve për realizimin e provimeve që i organizon ajo; - Bashkëpunimi me Qendrën për Arsim dhe Aftësim Profesional për organizimin e garave republikane, përcaktimin e profileve të reja, përgatitjen e testeve, programeve mësimore etj.; - Organizimi dhe realizimi i trajnimeve për të rritur në varësi të nevojave. - Vazhdimi i bashkëpunimit me Bursën e Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit të përbashkët	Ndihmësdrejtori për HKZH, drejtori, ndihmësdrejtori për mësim – në vazhdimësi
	- Zbatimi i mësimit modular në programet e reja mësimore; - Zhvillimi i strategjisë për futjen e mësimit përmes punës te punëdhënësi dhe praktikës feriale; - Analiza e nevojave për vendosjen e bashkëpunimeve të reja me partnerët socialë dhe përgatitja e dokumenteve për bashkëpunim; - Futja e programit të ri për trajnimin e nxënësve për siguri dhe shëndet në punë gjatë realizimit të mësimit praktik te punëdhënësi; - Përgatitja e dokumenteve për ndjekjen e nxënësit gjatë realizimit të mësimit praktik te punëdhënësi.	Ndihmësdrejtori për HKZH, drejtori, personi përgjegjës për arsimin praktik / në vazhdimësi
	- Përgatitja e planit të punës për Qendrën për trajnim dhe karrierë; - Përcaktimi i prioriteteve për punën e Qendrës për trajnim dhe karrierë; - Formimi i ekipit të punës në Qendrën për trajnim dhe karrierë.	Ndihmësdrejtori për zhvillim, drejtori, mësimdhënësit / në vazhdimësi.
	- Përcaktimi dhe realizimi i nevojave për mjete të reja demonstrative, pajisje, aparate dhe vegla gjatë zbatimit të programeve të reja mësimore për profilin e ri arsimor Teknik për automjete me repart alternativ	Ndihmësdrejtori për HKZH, drejtori, përgjegjësi i mësimit praktik, mësimdhënësit / në vazhdimësi
	- Zhvillimi i strategjisë për regjistrimin e nxënësve	Ndihmësdrejtori për HKZH, drejtori, ndihmësdrejtori për mësim / në vazhdimësi

	- Përcaktimi dhe zbatimi i strategjive të reja të marketingut dhe marrëdhënieve me publikun	Drejtori, ndihmësdrejtori për HKZH / në vazhdimësi
	- Ndryshime në organizimin e punës në punëtori, në drejtim të përmirësimit të punës, mënyrës së komunikimit, punës ekipore dhe zbatimit të mësimit modular	Drejtori, ndihmësdrejtori për HKZH, përgjegjësi i mësimit praktik, mësimdhënësit / në vazhdimësi
	- Planifikimi dhe furnizimi me mjete dhe pajisje të reja mësimore me qëllim modernizimin e procesit mësimor-arsimor.	Drejtori, ndihmësdrejtori për HKZH
VEPRIMTARI SHTESË ***SKT, BROKER***	- Kontrolli i realizimit të detyrave të punës së të punësuarve; - Ndjekja e ndryshimeve ligjore dhe zbatimi i tyre në punë; - Analiza e kënaqësisë së klientëve nga shërbimet; - Takime mujore për përcaktimin e problemeve aktuale dhe përgatitjen e zgjidhjeve me fokus në realizimin ekipor; - Aktivitete promovuese; - Përmirësimi i punës në Shërbimin Teknik dhe në QSHA Broker.	Drejtori, ndihmësdrejtori për HKZH, drejtori i QSHA Broker, përgjegjësi i SKT-së
AUTOSHKOLLA DHE ***AUTODROMI***	- Përcaktimi i procedurës për përdorimin e automjeteve zyrtare për qëllime zyrtare; - Zbatimi i obligimeve ligjore për punën e Autoshkollës; - Mirëmbajtja e vazhdueshme e automjeteve të Autoshkollës; - Takime mujore për përcaktimin e sfidave aktuale dhe përgatitjen e zgjidhjeve me fokus në realizimin ekipor; - Aktivitete për përmirësimin dhe zhvillimin e punës së Autoshkollës dhe mbulimin mediatik të shërbimeve të Autoshkollës dhe autrodromit; - Pajisja e autodromit me pajisjet e nevojshme; - Mirëmbajtja e vazhdueshme e autodromit; - Kontaktet me përdoruesit e autodromit për përmirësimin e shërbimeve.	Drejtori, ndihmësdrejtori për HKZH, përgjegjësi i Autoshkollës

Ndihmësdrejtori për kërkim, trajnim dhe zhvillim,
ing. i dipl. i elektroteknikës Kristijan Petreski

Shtojca 4: Programi i punës së Këshillit arsimor

Aktivitetet e Këshillit arsimor

Aktivitetet që Këshilli arsimor do t'i realizojë gjatë vitit shkollor 2026/2027 janë këto:

- marrëveshje për fillimin e suksesshëm të punës në vitin e ri shkollor;
- shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për punën e Shkollës në vitin e kaluar shkollor dhe i Programit vjetor të punës së Shkollës për vitin 2026/2027;
- udhëzime për mbajtjen e takimeve të para me prindër;
- udhëzime për përfundimin e suksesshëm të tremujorit të parë të vitit shkollor;
- analiza e suksesit të nxënësve, analiza e rregullsisë, shkaqet dhe ndërmarrja e masave për tejkalimin e dobësive pas çdo tremujori dhe gjysmëvjetori, si dhe pas përfundimit të vitit shkollor, do të jenë veçmas objekt i punës së Këshillit arsimor;
- shqiptimi i masave pedagogjike, si dhe analiza e aktiviteteve të ndërmarra nga kujdestari i klasës, Këshilli i klasës dhe shërbimi pedagogjik-psikologjik, do të jenë tema diskutimi të Këshillit arsimor;
- udhëzime për përfundimin e suksesshëm të gjysmëvjetorit të parë dhe të vitit shkollor;
- udhëzime dhe kalendar pune për realizimin e suksesshëm të provimeve përmirësuese dhe përfundimtare me paralelet e klasave përfundimtare;
- udhëzime për zbatimin cilësor të arsimit të reformuar trevjeçar dhe katërvjeçar;
- udhëzime për realizimin e suksesshëm të maturës dhe provimit përfundimtar;
- udhëzime dhe kalendar pune për realizimin e suksesshëm të mësimit përgatitor për provimet përmirësuese dhe përfundimtare;
- shqyrtimi i politikës së regjistrimit të Shkollës, si dhe përcaktimi i kritereve për regjistrimin e nxënësve në Shkollë;
- informata për efektet e zbatimit të programeve për arsimin e të rriturve;
- informim për të gjitha aktivitetet më të rëndësishme që burojnë nga Qyteti i Shkupit - Sektori i Arsimit, MASH-i, QAPT-ja dhe institucionet e tjera;
- analiza e efekteve të mentorimit të brendshëm të mësimdhënësve, efekteve të vlerësimit të punës së të punësuarve dhe realizimit të projekteve shkollore;
- informon dhe mbështet aktivitete që synojnë avancimin e ndërveprimit ndëretnik të të rinjve në arsim.

Afatet për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara do të caktohen në vazhdimësi, ndërsa disa prej tyre janë përcaktuar në Programin e punës së drejtorit, i cili e thërret dhe e udhëheq Këshillin arsimor

Shtojca 5: Programi i punës së Bordit të Shkollës për vitin shkollor 2026/2027

Bordi i Shkollës është organi drejtues i Shkollës, i vendosur më lart në hierarkinë shkollore. Bordi i Shkollës e drejton Shkollën në të gjitha segmentet e saj dhe askush nuk mund ta kufizojë në këtë, përderisa aktivitetet e veta i ushtron brenda kompetencave të përcaktuara me ligj. Bordi i Shkollës është i obliguar ta ndjekë punën e drejtorit dhe të funksioneve të tjera udhëheqëse, si dhe punën e të gjitha organeve dhe trupave të shkollës, me qëllim sigurimin e udhëheqjes dhe funksionimit efektiv të Shkollës. Rëndësia e Bordit të Shkollës nuk qëndron vetëm në pozitën e tij formalo-juridike të përcaktuar me ligj, por edhe në përgjegjësinë e tij për sigurimin e cilësisë së punës së përgjithshme të shkollës.

Bordi i Shkollës është organ kolegjial, struktura dhe numri i anëtarëve të të cilit përcaktohen me ligj. Gjatë emërimit të anëtarëve të Bordit të Shkollës mbahet llogari për përfaqësimin gjinor dhe etnik të anëtarëve në Bord. Në përputhje me dispozitat ligjore, Bordi i Shkollës ka 12 anëtarë, edhe atë:

- 4 përfaqësues të mësimdhënësve, të cilët i emëron dhe i shkarkon Këshilli arsimor;
- 3 përfaqësues të prindërve, përkatësisht kujdestarëve të nxënësve, të cilët i emëron dhe i shkarkon Këshilli i prindërve;

- 3 përfaqësues të themeluesit, të cilët i emëron dhe i shkarkon Këshilli i Qytetit të Shkupit;
- 1 përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilin e emëron dhe e shkarkon ministri i Arsimit dhe Shkencës;
- 1 përfaqësues i bashkësisë afariste, të cilin e emëron dhe e shkarkon Oda Ekonomike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përfaqësuesi i bashkësisë afariste merr pjesë në punën e Bordit të Shkollës, por nuk ka të drejtë vote gjatë votimit dhe marrjes së vendimeve. Bordi i Shkollës punon në mënyrë të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote. Kompetencat e Bordit të Shkollës janë të përcaktuara me ligj dhe ai:

- miraton Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të qendrës shkollore;
- i propozon Këshillit të Qytetit të Shkupit Programin vjetor të punës dhe Raportin për punën e shkollës;
- shqyrton realizimin e Programit vjetor të punës së shkollës;
- miraton Programin për zhvillimin e shkollës;
- i propozon themeluesit Planin financiar vjetor;
- i propozon themeluesit Llogarinë përfundimtare;
- shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit dhe e zbaton procedurën e paraparë me ligj;
- realizon intervistë me kandidatët për drejtor;
- nga kandidatët e paraqitur në konkursin e shpallur për zgjedhjen e drejtorit, i propozon kryetarit të Qytetit të Shkupit një kandidat;
- miraton Planin Vjetor të prokurimeve publike me propozim të drejtorit;
- vendos për çështje të punës materiale-financiare që me ligj janë vënë në kompetencën e tij;
- merr vendime për përcaktimin e veprimtarive plotësuese të shkollës;
- merr vendime për furnizime dhe përcakton shumën e mjeteve financiare për prokurime publike nga burimet vetanake të shkollës;
- vendos për shpërndarjen e mjeteve të fituara nga ushtrimi i veprimtarive plotësuese të shkollës;
- vendos për kundërshtimet dhe ankesat e të punësuarve;
- vendos për ankesat e nxënësve, prindërve, përkatësisht kujdestarëve të nxënësve;
- zgjedh komisionet e veta të përhershme dhe të përkohshme;
- vendos për çështje nga fusha e Mbrojtjes Popullore që janë vënë në kompetencën e tij;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, statut dhe akte të tjera të shkollës.

Bordi i Shkollës i përcakton qëllimet e veta në bazë të vizionit të shkollës, ndërsa aktivitetet e veta i planifikon dhe i realizon në drejtim të arritjes së qëllimeve që duhet të sigurojnë përparim dhe zhvillim të vazhdueshëm të shkollës në çdo segment të punës së saj. Aktivitetet e planifikuara të Bordit të Shkollës për vitin shkollor 2026/2027 synojnë mbikëqyrjen dhe sigurimin e cilësisë së punës së shkollës në fushën e:

- planeve dhe programeve mësimore,
- arritjeve të nxënësve,
- të nxënit dhe mësimdhënies,
- mbështetjes/ndihmës për nxënësit,
- klimës shkollore,
- burimeve,
- menaxhimit, udhëheqjes dhe krijimit të politikave.

Bordi i Shkollës planifikon ta ndjekë punën dhe të bashkëpunojë me drejtorin në fushat e mëposhtme:

- burimet njerëzore, punësimi dhe rishpërndarja e të punësuarve,
- bashkëpunimi me palët e interesuara dhe përfaqësimi i shkollës,
- zbatimi i Programit vjetor të punës ,
- avancimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar që e realizon shkolla,
- organizimi i funksionimit të përditshëm të shkollës,
- puna në përputhje me ligjet,
- puna financiare,
- udhëheqja pedagogjike.

Aktivitetet prioritare të Bordit të Shkollës për vitin shkollor 2026/2027 do të jenë:

- ndjekja dhe sigurimi i cilësisë së punës së shkollës në të gjitha fushat,
- përmirësimi i klimës shkollore dhe i marrëdhënieve ndërnjerëzore në shkollë,
- përfshirja më e madhe e Bordit të Shkollës në krijimin e politikës së shkollës,
- përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me drejtorin dhe funksionet e tjera udhëheqëse në shkollë,
- rritja e cilësisë dhe vëllimit të bashkëpunimit me organet dhe trupat e tjerë shkollorë,
- rritja e nivelit të transparencës në punën dhe vendimmarrjen e Bordit të Shkollës,
- mbikëqyrje e shtuar mbi punën e veprimtarive plotësuese të shkollës dhe mënyrën e shpërndarjes së mjeteve të fituara nga ushtrimi i veprimtarive plotësuese të shkollës.

Kryetari i Bordit të Shkollës,
Haki Fejzullai

Shtojca 6: Programi i punës së Këshillit të prindërve për vitin shkollor 2026/2027

Këshilli i prindërve është faktor i rëndësishëm në veprimtarinë e përgjithshme edukativo-arsimore në Shkollë. Këshilli i prindërve pranë QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit shqyrton çështjet nga jeta dhe puna e Shkollës, suksesin, sjelljen dhe rregullsinë e nxënësve dhe jep mendim për përmirësimin e tyre. Këtë vit shkollor, përveç pjesëmarrjes në analizat e suksesit dhe sjelljes së nxënësve gjatë periudhave klasifikuese, propozimit të masave e sugjerimeve dhe kujdesit për zbatimin e tyre, Këshilli i prindërve do të jetë rregullisht i pranishëm në Shkollë.

Aktivitetet	Koha
1. Plotësimi dhe miratimi i Programit të punës - bllok informativ për Raportin vjetor; - njohja me Programin vjetor të Shkollës; - njohja e Këshillit me Programin e punës - shqyrtim dhe diskutim; - propozimi i detyrave konkrete; - përcaktimi i realizuesve duke respektuar kriteret për integrimin ndëretnik të të rinjve në arsim; - përcaktimi i formës përfundimtare; - propozime për planet dhe programet mësimore.	Shtator
2. Anketë për prindërit - bashkëpunimi me mësimdhënësit - zbatimi dhe analiza / diskutimi dhe udhëzimet; - njohja e Këshillit me projektet që funksionojnë në shkollë; - organizatat e nxënësve; - mbrojtja shëndetësore; - organizimi i kohës së lirë;	Tetor

- punë me dobi shoqërore; - Qendra për karrierë; - vullnetarizmi.	
3. Analiza e suksesit dhe sjelljes dhe propozim-masa për përmirësimin e tyre. Punëtori: „Si ta përmirësojmë suksesin dhe vijueshmërinë e nxënësve në Shkollë“: pjesëmarrje në përgatitjen e protokolleve dhe procedurave.	Nëntor
4. Promovimi i programeve parandaluese dhe zhvillimore – për përmirësimin e shëndetit, sjelljen jo të dhunshme, zhvillimin psikosocial, të nxënit e pavarur, socializimin dhe ndërmjetësimin, përmbajtjet ekologjike etj.	Dhjetor
5. Analiza e suksesit dhe sjelljes në fund të gjysmëvjetorit të parë. Punëtori: „Si t'i motivojmë nxënësit për të mësuar“.	
6. Ligjëratë – debat: „Sjellja në familje“.	Janar
7. Analiza e suksesit dhe sjelljes: - si të sigurohet prani më e shpeshtë e prindërve në Shkollë; - inicimi i aktiviteteve të përbashkëta me interes për nxënësit dhe Shkollën.	Shkurt
8. Ligjëratë me temë: „Si t'i mbrojmë fëmijët tanë nga ndikimet negative të mjedisit“. - Përfshirja e prindërve në shënimin e Festës së Patronatit të Shkollës.	Mars
9. Prezantimi i rezultateve nga puna e projekteve në Shkollë. 10. Informata për përgatitjen e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore dhe Provimit Përfundimtar; 11. Informata për realizimin e programit për orientim profesional dhe Qendrën për karrierë.	Prill
12. Informim, shkëmbim përvojash për aktivitete nga jeta kulturore-zbavitëse e nxënësve. 13. Informata për pjesëmarrje në gara, vizita në ngjarje kulturore, gara sportive, koncerte humanitare etj.	Maj
14. Të gjitha aktivitetet e lartpërmendura janë në kontekst të projektit MIMO. Punohet në grupe të balancuara mësimdhënësish, prindërish dhe nxënësish, duke u kujdesur për kriteret që i përcakton projekti.	Në vazhdimësi

Kryetari i Këshillit të prindërve,
Natasha Aksent

Shtojca 7: Programi për organizimin e mësimdhënies për vitin shkollor 2026/2027

Aktivitetet e përgjegjësit të mësimdhënies për vitin shkollor 2026/2027 do të realizohen në përputhje me Programin vjetor të punës së Qendrës.

Për këtë qëllim, përgjegjësi i mësimdhënies do ta orientojë punën e tij drejt ruajtjes së nivelit të lartë të cilësisë së mësimdhënies dhe komponentit edukativ në procesin arsimor, bashkëpunimit

me prindërit dhe komunikimit të mirë me nxënësit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet vlerësimit të punës së mësimdhënësve dhe mbajtjes së evidencës pedagogjike përmes ditarit elektronik.

PLAN OPERATIV

Fushat dhe aktivitetet	Bashkëpunëtorët dhe koha e realizimit	
I. OBLIGIME TË VAZHDUESHME **1) Përgatitja për fillimin e vitit shkollor:** • Pritja e nxënësve të rinj dhe njohja e tyre me Rregullin shtëpiak të Shkollës; • Shpërndarja e dokumenteve dhe materialeve për kujdestarët e klasave për mbajtjen efikase të dokumentacionit pedagogjik; • Përfshirja e mësimdhënësve të rinj në procesin e punës së shkollës; • Shpërndarja e planeve mësimore mësimdhënësve të lëndëve dhe dhënia e udhëzimeve për realizimin e mësimit; • Përgatitja e orarit të kujdestarive të mësimdhënësve; • Përgatitja e dokumentacionit për ndjekjen e dëmtimeve të pajisjeve kompjuterike; • Marrëveshje me sigurimin lidhur me detyrat e tyre. **2) Obligime të vazhdueshme gjatë vitit shkollor:** • Bashkëpunimi me institucionet për zhvillimin efikas të procesit arsimor në Shkollë; • Bashkëpunimi me organizatat lokale dhe partnerët socialë, sipas nevojave të Shkollës; • Komunikim i vazhdueshëm me Ministrinë e Punëve të Brendshme për rritjen e sigurisë brenda dhe jashtë Shkollës; • Kontrolli i dokumenteve të kandidatëve të regjistruar në arsimin me korrespondencë; • Përgatitja e orarit me obligimet gjatë pushimit dimëror dhe veror; • Përgatitja e procedurave për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në Shkollë sipas nevojave; • Organizimi i dhënies së provimeve për praktikantë për kandidatët; • Pjesëmarrja në punën e aktiveve; • Përgatitja e raporteve, tabelave dhe evidencave të ngjashme për nevojat e institucioneve lokale; • Përgatitja e materialeve aktuale informuese.	Përgjegjësi për mësim Ndihmësdrejtori për mësim Shërbimi profesional Kujdestarët e klasave Mësimdhënësit Referentët për çështje të nxënësve	Gjatë gjithë vitit shkollor
II. NDJEKJA E PROCESIT MËSIMOR: • Organizimi i mësimit në ndërrime; • Ndjekja dhe vlerësimi i punës së mësimdhënësve; • Organizimi i realizimit të provimeve diferenciale; • Ndjekja e cilësisë së kujdestarive të mësimdhënësve; • Punë konsultative me nxënësit dhe mësimdhënësit; • Pjesëmarrja në informimin e nxënësve të viteve përfundimtare për Maturën Shtetërore dhe provimet përfundimtare, për lëndët zgjedhore dhe zbatimin e anketave; • Përzgjedhja e nxënësve për pjesëmarrje në gara dhe manifestime të ndryshme.	Përgjegjësi për mësim Referentët për çështje të nxënësve Bashkëpunëtori profesional për teknikë kompjuterike	Gjatë gjithë vitit shkollor
III. PUNA ME PRINDËRIT	Përgjegjësi për mësim	Gjatë gjithë

• Përmirësimi i mënyrave të ndryshme të informimit të nxënësve dhe prindërve; • Bashkëpunimi me prindërit e udhëzuar për këshillim në Shkollë; • Komunikimi me prindërit në rast të çregjistrimit ose regjistrimit të nxënësve gjatë vitit shkollor; • Përgatitja e rendit të ditës për mbajtjen e takimeve me prindër dhe materialit të nevojshëm për takimet, për informim më të mirë të prindërve; • Organizimi i ligjëratave për prindërit me përmbajtje aktuale me rëndësi të madhe për procesin edukativ; • Përgatitja e materialeve të ndryshme informuese për prindërit; • Takime me prindër të interesuar për bashkëpunim me Shkollën si partnerë socialë (organizimi i vizitave në kompani, pranimi i nxënësve për mësim praktik dhe praktikë feriale...)	Shërbimi profesional Ndihmësdrejtori për mësim Ligjërues të jashtëm Prindërit	vitit shkollor
IV. PUNA ME KUJDESTARËT E KLASAVE • Ndjekja e vazhdueshme e punës së kujdestarit të klasës; • Ndihmë lidhur me shqiptimin e masave pedagogjike; • Dhënia e udhëzimeve për mbajtjen e evidencës pedagogjike kompjuterike për klasën.	Përgjegjësi për mësim Kujdestari i klasës Shërbimi profesional	Gjatë gjithë vitit shkollor
V. PUNA ME MËSIMDHËNËSIT **1) Realizimi i mësimit** • Kontrolli i vijueshmërisë, kujdestarive dhe punës së përgjithshme duke përdorur kriteret për vlerësimin e punës së mësimdhënësve dhe përgatitja e raporteve; • Ndjekja e aktiviteteve për organizimin e përmbajtjeve edukative-kulturore për nxënësit jashtë Shkollës: vizita në teatro, muze dhe vende të tjera me interes në qytet dhe jashtë tij; • Organizimi i përgatitjes së testeve për nevoja të ndryshme; • Organizimi i aktiviteteve ekologjike brenda dhe jashtë Shkollës; • Organizimi i trajnimeve të ndryshme për mësimdhënësit brenda dhe jashtë Shkollës. **2) e-Ditari** • Mbajtja e evidencës pedagogjike përmes e-Ditarit sipas udhëzimeve të marra dhe përvojës nga viti i kaluar. **3) Shënimi i datave të rëndësishme të historisë** • Përgatitja e referateve përkatëse për shënimin e datave të rëndësishme të historisë ose organizimi i llojeve të tjera të aktiviteteve dhe evidencës përkatëse. **4) Mësimi shtues dhe plotësues** • Organizimi i mësimit shtesë dhe plotësues; • Ndjekja e realizimit të orëve plotësuese dhe shtesë për nxënësit përmes instrumenteve të përgatitura.	Përgjegjësi për mësim Ndihmësdrejtori për mësim Shërbimi profesional Bashkëpunëtori profesional për teknikë kompjuterike Përgjegjësit e aktiveve Mësimdhënësit e lëndëve	Gjatë gjithë vitit shkollor
VI. PRIORITETET PËR VITIN E RI SHKOLLOR • Organizimi i mësimit për fillimin e suksesshëm të vitit shkollor;	Drejtori Përgjegjësi për mësim	Gjatë gjithë vitit shkollor

• Përdorimi i instrumenteve për vlerësimin e punës së mësimdhënësve me qëllim rritjen e motivimit të tyre; • Organizimi i ditës së pranimit dhe ditës së hapur për prindërit; • Sigurimi i dokumenteve për kujdestarët e klasave për fillimin e suksesshëm të vitit shkollor.	Aktivi i lëndëve profesionale Shërbimi profesional Ndihmësdrejtori për mësim	

Që të mund të zbatohen këto aktivitete të parapara, nevojitet bashkëpunim i ngushtë me të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin arsimor, brenda dhe jashtë Shkollës.

Përgjegjësit e mësimdhënies,
Kastriot Kasapi
Koce Tapshanovski

Shtojca 8: Programi i punës së mësimit praktik për vitin shkollor 2026/2027

Prioritetet në punën e Aktivit të mësimit praktik për vitin shkollor 2026/2027:

1. **Përmirësimi i cilësisë së mësimit praktik;**
2. **Përzgjedhja, kualifikimi dhe përgatitja e nxënësve për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare;**
3. **Trajnime për mësimdhënësit e mësimit praktik;**
4. **Përshtatja e mësimdhënësve me programet e reja të reformuara për arsimin trevjeçar dhe katërvjeçar;**
5. **Përfshirja e obligimeve të koordinatorëve për MPP në punën e rregullt të mësimit praktik.**

Aktivitetet e shpërndara sipas muajve janë paraqitur në tabelën në vijim.

Shtator	**Realizuesi**
1. Dorëzimi i përgatitjeve globale, tematike dhe ditore në formë elektronike	1. Aktivi i mësimit praktik
2. Korrigjimi i përgatitjeve globale, tematike dhe ditore me zbatimin e TIK-ut dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor	2. Bashkëpunimi ndërmjet Aktivit profesional dhe Aktivit të mësimit praktik
3. Mbajtja e portofolit të mësimdhënësit dhe të nxënësve me përdorimin e fletoreve të punës me detyra praktike	3. Aktivi i mësimit praktik
4. Udhëzime për seksionin e mësimit praktik për programin e përgatitjes së nxënësve për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare	4. Anëtarët e Seksionit të mësimit praktik
5. Fillimi i realizimit të projektit me Euroimpex për lyerjen e automjetit Peugeot 404	5. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik
6. Shpërndarja e nxënësve të të gjitha viteve dhe përgatitja e dokumenteve për MPP dhe mësimin praktik.	6. Ekipi i mësimdhënësve nga QSHA
7. Shpërndarja e aktiviteteve të bashkëpunëtorëve për realizimin e MPP-së.	7. Koordinatorët e mësimit praktik në bashkëpunim me kujdestarët e klasave
8. Takime me partnerët socialë.	8. Koordinatorët e mësimit praktik 9. Koordinatorët për MPP

9. Pjesëmarrja në trajnime dhe takime të koordinatorëve për MPP në RMV	
Tetor	**Realizuesi**
1. Sistemi i ndjekjes së punës së mësimdhënësve të mësimit praktik 2. Përzgjedhja e nxënësve të paraqitur për pjesëmarrje në seksionin e mësimit praktik dhe njohja e tyre me programin 3. Trajnimi i kuadrit mësimor 4. Bashkëpunim i shtuar me partnerët socialë 5. Përzgjedhja e nxënësve për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare 6. Takim i Aktivit të mësimit praktik dhe Aktivit profesional 7. Raport për aktivitetet e projekteve 8. Pjesëmarrja në trajnime dhe takime të koordinatorëve për MPP në RMV 9. Përgatitje për organizimin e garës Automekaniku i ri evropian 2027	1. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 2. Anëtarët e Seksionit të mësimit praktik 3. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 4. Koordinatorët e mësimit praktik 5. Aktivi i mësimit praktik dhe Aktivi profesional 6. Aktivi i mësimit praktik, koordinatorët e mësimit praktik, përgjegjësi i Aktivit profesional dhe mësimdhënësit e Aktivit profesional 7. Koordinatorët e mësimit praktik 8. Koordinatorët për MPP 9. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik dhe Aktivi profesional
Nëntor	**Realizuesi**
1. Sistemi i ndjekjes së punës së mësimdhënësve të mësimit praktik 2. Trajnimi i kuadrit mësimor 3. Grumbullimi i mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme 4. Formimi i ekipit për përgatitjen e nxënësve për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare 5. Raport për aktivitetet e projekteve 6. Takime me partnerët socialë 7. Pjesëmarrja në trajnime dhe takime të koordinatorëve për MPP në RMV 8. Përgatitje për organizimin e garës Automekaniku i ri evropian 2027	1. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 2. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 3. Aktivi i mësimit praktik në bashkëpunim me kompanitë që blejnë mbeturina 4. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 5. Koordinatorët e mësimit praktik 6. Koordinatorët e mësimit praktik 7. Koordinatorët për MPP 8. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik dhe Aktivi profesional
Dhjetor	**Realizuesi**
1. Përgatitja e nxënësve për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare 2. Kontrolli i portofolit të mësimdhënësve të mësimit praktik për fundin e gjysmëvjetorit të parë 3. Raport për aktivitetet e projekteve 4. Raport për rezultatet e nxënësve që ndjekin mësim në autoservise 5. Takim i Aktivit të mësimit praktik për fundin e gjysmëvjetorit të parë 6. Përgatitja e aktiviteteve për mësimdhënësit e mësimit praktik gjatë pushimit dimëror	1. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 2. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 3. Koordinatorët e mësimit praktik 4. Koordinatorët e mësimit praktik 5. Aktivi i mësimit praktik 6. Aktivi i mësimit praktik

7. Takime me partnerët socialë 8. Pjesëmarrja në trajnime dhe takime të koordinatorëve për MPP në RMV 9. Përgatitje për organizimin e garës Automekaniku i ri evropian 2027	7. Koordinatorët e mësimit praktik 8. Koordinatorët për MPP 9. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik dhe Aktivi profesional
Shkurt	**Realizuesi**
1. Testim eliminues i nxënësve për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare 2. Analiza e suksesit dhe sjelljes për fundin e gjysmëvjetorit të parë dhe udhëzime për përmirësimin e tyre 3. Përgatitja e nxënësve për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare 4. Realizimi i projekteve dhe zbatimi i tyre në mësim 5. Raport për aktivitetet e projekteve 6. Takim dhe udhëzime për Seksionin e mësimit praktik për gjysmëvjetorin e dytë 7. Sistemi i ndjekjes së punës së mësimdhënësve të mësimit praktik 8. Pjesëmarrje në trajnime dhe takime të koordinatorëve për MPP në RMV 9. Përgatitje për organizimin e garës Automekaniku i ri evropian 2027	1. Koordinatorët e mësimit praktik 2. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 3. Ekipi i mësimdhënësve nga QSHA 4. Koordinatorët e mësimit praktik 5. Koordinatorët e mësimit praktik 6. Anëtarët e seksionit të mësimit praktik 7. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 8. Koordinatorët për MPP dhe ndihmësdrejtori për mësim 9. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik dhe Aktivi profesional
Mars	**Realizuesi**
1. Formimi i ekipit për realizimin e Ditës së Hapur 2027 2. Grumbullimi i mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme 3. Bashkëpunimi me partnerët socialë 4. Kontrolli i portofolave të mësimdhënësve të mësimit praktik 5. Raport për aktivitetet e projekteve 6. Pjesëmarrja në trajnime dhe takime të koordinatorëve për MPP në RMV 7. Përgatitje për organizimin e garës Automekaniku i ri evropian 2027	1. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 2. Aktivi i mësimit praktik në bashkëpunim me kompanitë që blejnë mbeturina 3. Koordinatorët e mësimit praktik 4. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 5. Koordinatorët e mësimit praktik 6. Koordinatorët për MPP 7. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik dhe Aktivi profesional
Prill	**Realizuesi**
1. Përgatitja e nxënësve të përzgjedhur për gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare 2. Përzgjedhja e nxënësve për pjesëmarrje në projektin Erasmus+ 3. Bashkëpunimi me partnerët socialë 4. Sistemi i ndjekjes së punës së mësimdhënësve të mësimit praktik 5. Raport për aktivitetet e projekteve 6. Realizimi i Ditës së Hapur 7. Përgatitje për organizimin e garës Automekaniku i ri evropian 2027	1. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 2. Koordinatorët e mësimit praktik 3. Koordinatorët e mësimit praktik 4. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 5. Koordinatorët e mësimit praktik 6. Koordinatorët e mësimit praktik 7. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik dhe Aktivi profesional

Maj	Realizuesi
1. Mbajtja e garave shtetërore për drejtimin e makinerisë dhe elektroteknikës 2. Bashkëpunimi me partnerët socialë 3. Sistemi i ndjekjes së punës së mësimdhënësve të mësimit praktik 4. Bashkëpunimi i mësimdhënësve të mësimit praktik lidhur me plotësimin e portofolave të mësimdhënësve 5. Pjesëmarrja në garën ndërkombëtare Automekaniku i Ri 2027 6. Raport për aktivitetet e projekteve 7. Mbajtja e garës Automekaniku i ri evropian 2027	1. Aktivi i mësimit praktik dhe një pjesë e mësimdhënësve nga Aktivi profesional 2. Koordinatorët e mësimit praktik dhe mësimdhënësit e lëndëve 3. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 4. Aktivi i mësimit praktik 5. Ekipi i mësimdhënësve nga QSHA 6. Koordinatorët e mësimit praktik 7. Ekipi i mësimdhënësve të mësimit praktik dhe Aktivi profesional
Qershor–korrik	**Realizuesi**
1. Analiza e suksesit dhe sjelljes për fundin e vitit shkollor 2026/2027 2. Përgatitja e raporteve përfundimtare për projektet 3. Mbrojtja e detyrave projektuese për provimin përfundimtar për profesione të caktuara 4. Analiza e sistemit për ndjekjen e mësimdhënësve të mësimit praktik 5. Përgatitja e Raportit për punën e Aktivit të mësimit praktik për vitin shkollor 2026/2027 dhe Programit të punës së Aktivit të mësimit praktik për vitin shkollor 2027/2028.	1. Koordinatorët e mësimit praktik 2. Koordinatorët e mësimit praktik 3. Aktivi i mësimit praktik 4. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim 5. Koordinatorët e mësimit praktik dhe ndihmësdrejtori për mësim

Përgjegjësi i mësimit praktik,

mr. Agim Jusufi

Shtojca 9:

A) Programi i punës së fushës mësimore profesionale për vitin shkollor 2026/2027

Fusha mësimore profesionale numëron gjithsej 25 (njëzet e pesë) mësimdhënës, edhe atë:

- grupi i lëndëve të komunikacionit (nëntë mësimdhënës),
- grupi i lëndëve të makinerisë (njëmbëdhjetë mësimdhënës),
- grupi i lëndëve të elektroteknikës (pesë mësimdhënës).

Në këtë vit shkollor mësimdhënësit e fushës mësimore profesionale do t'i orientojnë aktivitetet drejt rritjes së bashkëpunimit me subjektet ekonomike dhe sektorin e biznesit për përsosjen profesionale të mësimdhënësve për punën me automjete me lëvizje alternative, planifikimin dhe organizimin e mësimit praktik dhe praktikës feriale, si dhe shqyrtimin e mundësive për hapjen e profileve të reja arsimore sipas nevojave të tregut të punës. Realizimi i mësimit në terren ka për qëllim njohjen e nxënësve me organizimin dhe punën në ndërmarrjet ku realizojnë mësimin praktik për lëndë të caktuara dhe zhvillimin e aftësive për të nxënë të pavarur. Pjesëmarrja në realizimin e projekteve

të brendshme dhe të jashtme, garave dhe manifestimeve do të mundësojë përfshirjen e drejtpërdrejtë të nxënësve në punë kërkimore, me qëllim nxitjen e shpikshmërisë dhe kreativitetit të tyre gjatë realizimit të aktiviteteve të planifikuara, përmirësimin e aftësive të komunikimit, procesit të vendimmarrjes, shprehive pozitive dhe vetëbesimit.

Prioritetet në punën e mësimdhënësve të fushës mësimore profesionale gjatë vitit shkollor 2026/2027 do të orientohen drejt përmbushjes së plotë dhe cilësore të kërkesave të MASH-it dhe QAPT-së në procesin e realizimit të mësimdhënies, përmes realizimit të aktiviteteve në vijim:

- përsosje profesionale e mësimdhënësve (pjesëmarrje në trajnime, seminare, projekte, diseminime);
- përfshirje aktive e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore: aktivitete praktike, projekte, punëtori, hulumtime, manifestime, ushtrime laboratorike, gara, trajnime, vizita, zgjidhje problemesh etj., ku do të shprehen kreativiteti i nxënësve, puna ekipore dhe zgjidhja e problemeve nga praktika, me ç'rast pritet përmirësim i rregullsisë dhe arritjeve të nxënësve.
- Të mësuarit përmes punës;
- realizimi i ushtrimeve laboratorike dhe punëtorive;
- pjesëmarrje në gara rajonale, shtetërore, ballkanike dhe ndërkombëtare;
- hartimi i literaturës së brendshme profesionale për nevojat e lëndëve të caktuara profesionale;
- përgatitja e nxënësve për dhënien e Provimit Përfundimtar dhe Maturës Shtetërore;
- promovimi i Shkollës përmes inovacioneve, organizimit të manifestimeve tërheqëse, videove etj.

Aktivitetet sipas muajve	**Bartësit e aktivitetit**
Shtator	
1. Teste fillestare për nxënësit e vitit të parë për përcaktimin e njohurive hyrëse	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse
2. Realizimi i trajnimeve për didaktikë të bazuar në situatën e punës, ku do të përfshihen shkolla të mesme dhe planifikohet të realizohen dy trajnime	Aleksandar Georgievski, Dragica Drenkova
3. Vizita në subjekte ekonomike (autoservise, organizata transporti etj.) dhe lidhja e marrëveshjeve për nxënësit e vitit II, III dhe IV për Mësim përmes punës	Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse Drejtori dhe ndihmësdrejtori për hulumtim, trajnim dhe zhvillim
4. Aktivitete në fushën e veprimtarisë shtesë të qendrës - Siguria dhe shëndeti në punë	- Drejtori - Persona profesionalë për siguri dhe shëndet në punë
5. Trajnimi i nxënësve të vitit të dytë, tretë dhe katërt për siguri dhe shëndet në punë – para fillimit të punës praktike te punëdhënësi - Mësim përmes punës	Kristijan Petreski, Natasha Aleksov, Vevait Alimi, Boban Mitevski.
6. Njohja e nxënësve me mundësitë për hulumtim, eksperimentim dhe ushtrime praktike	Boban Mitevski, Miroslav Cvetkovski dhe sipas nevojës një pjesë e mësimdhënësve të tjerë dhe ekip nxënësish
7. Përvetësimi i teknikave të reja për zbatimin e drejtë të përfshirjes në procesin arsimor.	Snezhana Bozhinoska-Risteska (shtator, tetor)

8. Ndjekja, orientimi dhe mbështetja e nxënësve në hulumtime dhe në punën praktike	Miroslav Cvetkovski shtator–maj
9. Formimi i ekipit për ndjekjen e konkurseve nga Fondi për Inovacione dhe nga të gjitha veprimtaritë e tjera të lidhura me procesin edukativo-arsimor	Zoki Stojmirov (punë ekipore) Mësimdhënës profesionalë të propozuar nga drejtoria
10. Trajnimi i nxënësve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë para fillimit të ushtrimeve të mësimit praktik, në përputhje me drejtimin dhe programin e parashikuar për arsimin e mesëm profesional	Boban Mitevski
11. Përditësimi i planeve mësimore vjetore, tematike dhe ditore	Natasha Aleksov, Mimoza Gichevska (gjatë gjithë vitit shkollor)
12. Sistemi i mentorimit të kuadrit mësimor	Drejtori, ndihmësdrejtori, mentori dhe mësimdhënësit
13. Punë hulumtuese me nxënës të vitit të tretë dhe të katërt, drejtimi i makinerisë	Aleksandar Georgievski, Dragica Drenkova
14. Realizimi i bashkëpunimit në aktivitetet e Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacionin Rrugor	Adelon Ajdini
15. Zbatimi i Strategjisë për krijimin e modelit për monitorimin dhe vlerësimin e përparimit të nxënësve	Natasha Aleksov, Mimoza Gichevska (gjatë gjithë vitit shkollor)
16. Punë dhe bashkëpunim me familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (nëse ka në klasat ku japin mësim)	Natasha Aleksov, Mimoza Gichevska (gjatë gjithë vitit shkollor)
17. Njohja e nxënësve me mundësitë për hulumtim, eksperimentim dhe përgatitje punimesh	Aleksandar Pupkov (në vazhdimësi shtator–maj)
18. Vendosja e kontaktit me shkollat e mesme të rajonit për bashkëpunim, shkëmbim idesh dhe përvojash dhe vizita në disa prej tyre	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov mësimdhënësit e lëndëve profesionale
19. Formimi dhe vazhdimi i punës së Seksionit të komunikacionit me përmasa ndërkombëtare dhe program të përbashkët (R. e Serbisë, R. e Kroacisë, R. e Malit të Zi, R. e Sllovenisë)	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, mësimdhënësit e lëndëve profesionale
20. Formimi i një ekipi nxënësish për program pilot për përmirësimin e transportit urban në Qytetin e Shkupit (numërimi i udhëtarëve, analizë, statistikë një ditë në javë për një periudhë dy mujore)	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, mësimdhënësit e lëndëve profesionale
21. Vendosja e kontaktit dhe bashkëpunimit me shkollat e mesme të komunikacionit në rajonin e ish-republikave jugosllave (Kroaci, Serbi, Sllloveni, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë)	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, Aneta Pashoska
22. Aktivitete të vazhdueshme nga procesi edukativo-arsimor dhe fillimi i bashkëpunimit e prezantimit me shkollat fillore nga pjesa lindore e Maqedonisë (prezantim i kulturës teknike të komunikacionit për nxënësit e klasës së nëntë)	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, Aneta Pashoska
Tetor	
1. Të folurit rrjedhshëm në gjuhën angleze	Snezhana Ristevska – në vazhdimësi
2. Fillimi i punës së Seksionit të komunikacionit (nxënës të vitit të parë, dytë, tretë dhe katërt)	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, mësimdhënës të lëndëve profesionale
3. Bashkëpunimi me shkolla të ngjashme nga rajoni dhe vizita në disa prej tyre me grup nxënësish.	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov
4. Punë për krijimin dhe publikimin e një punimi në revistë ndërkombëtare nga fusha e automjeteve motorike	Ivan Gjakovski (në vazhdimësi)

5. Vizita në Stokomak, punëtori, autoservise	Dragica Drenkova, Aleksandar Georgievski
6. Rregullimi i vazhdueshëm i kabinetit elektrik për mësim praktik, për nevojat e nxënësve për realizimin e suksesshëm të ushtrimeve të mësimit praktik dhe ushtrimeve nga lëndët elektrike	Boban Mitevski, ekip nxënësish (në vazhdimësi)
7. Përzgjedhja e nxënësve për garën ndërkombëtare „AUTOMEKANIKU I RI 2027“,	Punë ekipore e mësimdhënësve të drejtimit të makinerisë – bartës i aktivitetit Aleksandar Georgievski
8. Vizita në Qendrën për menaxhimin dhe kontrollin e komunikacionit në territorin e Qytetit të Shkupit	Aleksandar Pupkov me nxënësit e vitit IV
9. Vizita të organizuara në punëtori, autoservise etj.	Kujtim Dulovi, Nexhat Mjaki
10. Rregullimi i tabelës interaktive për realizimin e ushtrimeve të mësimit praktik dhe grupit të lëndëve elektrike	Punë ekipore, bartës Boban Mitevski
11. Shënimi i sinjalizimit horizontal në QSHA	(Punë ekipore e inxhinierëve të komunikacionit) Adelon Ajdini, Refik Sadiki, Neal Abduli, Zoki Stojmirov, Branislav Gligorov, Snezhana Bozhinoska-Risteska
12. Vizita në Qendrën për menaxhimin e sinjaleve ndriçuese në kryqëzimet e Qytetit të Shkupit	Adelon Ajdini me nxënësit e vitit të dytë
13. Trajnimi i nxënësve të viteve përfundimtare për përdorimin e mototesterit	Boban Mitevski, Miroslav Cvetkovski (në vazhdimësi)
14. Plotësimi i profilit të ri DREJTUES I AUTOMJETIT MOTORIK në drejtimin e komunikacionit.	Snezhana Risteska, Slave Dimovski (në vazhdimësi)
15. Vizita të organizuara në punëtori, autoservise etj.	Nexhat Mjaki dhe Suad Xhemaili
16. Hulumtimi dhe mbledhja e informatave më të reja për inxhinierinë e transportit dhe komunikacionit	Nusrije Mejdi, Snezhana Bozhinoska-Risteska
17. Përgatitja e ushtrimeve auditoriale dhe laboratorike	Kristijan Petreski
18. Përzgjedhja e nxënësve për anëtarësim në ekipin e Auto-moto klubit QSHA dhe caktimi i detyrave që duhet t'i kryejnë në periudhën e ardhshme	Aleksandar Georgievski
19. Vizita në panair në përputhje me sektorin	Aleksandar Georgievski
20. Vizita të organizuara në fabrika, autoservise, ngjarje automobilistike etj.	Aleksandar Georgievski
21. Punë hulumtuese me nxënës të vitit të tretë dhe katërt të drejtimit të makinerisë	Aleksandar Georgievski, Dragica Drenkova
22. Aftësimi profesional i mësimdhënësve për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve elektrike	Të gjithë mësimdhënësit nga sektori i makinerisë, elektroteknikës dhe TI-së
23. Zhvillimi dhe njohja e teknikave të reja për përdorimin e drejtë të përfshirjes në procesin arsimor.	Snezhana Bozhinoska-Risteska,
24. Rritja e kompetencave profesionale	Kujtim Dullovi (gjatë gjithë vitit)
NËNTOR	
1. Organizimi i konkursit për ide inovative nga fusha e industrisë automobilistike	Të gjithë përgjegjësit e seksionit elektro-makinerik, të komunikacionit dhe seksionit të mësimit praktik
2. Rritja e bashkëpunimit me sektorin ekonomik	Aleksandar Georgievski, Agim Jusufi

3. Hulumtimi i literaturës profesionale (takim i Aktivit profesional dhe përcaktimi i literaturës së nevojshme dhe burimeve shkollore për trajnim)	Neal Abduli, Nusrije Mejdi
4. Përgatitja e nxënësve për garën ndërkombëtare „Automekaniku i ri evropian 2027“, Shkup	Koordinator: Aleksandar Georgievski dhe punë ekipore me mësimdhënësit e teorisë dhe mësimit praktik
5. Ndjekja, orientimi dhe mbështetja e nxënësve në hulumtime dhe përgatitjen e punimeve, si dhe përgatitja për gara	Aleksandar Pupkov
6. Prezantimi nga nxënësit i analizës për përmirësimin e transportit të udhëtarëve në Qytetin e Shkupit	Zoki Stojmirov, mësimdhënës nga grupi i lëndëve të komunikacionit
7. Vizita te nxënësit që realizojnë punë praktike jashtë shkollës	Mësimdhënës përgjegjës për MPP
8. Mbajtja e trajnimit për nxënësit (autoelektronicist, teknik makinerie për automjete motorike) për përdorimin e osciloskopit digjital për testimin e sinjaleve elektrike në automjete (në vazhdimësi tetor – prill)	Boban Mitevski, Miroslav Cvetkovski, Aleksandar Georgievski
9. Organizimi i garave ndërmjet klasave me nxënësit e vitit të tretë	Mësimdhënësit e seksionit të makinerisë dhe komunikacionit
10. Përkthimi në shqip i testeve për garat e ardhshme	Adelon Ajdini, Nexhat Mjaki, Suad Xhemaili, Merita Grubi
11. Realizimi i ushtrimeve laboratorike me nxënësit	Kristijan Petreski dhe nxënës të vitit III
12. Hulumtimi dhe mbledhja e informatave më të reja për inxhinierinë e transportit dhe komunikacionit.	Snezhana Bozhinoska-Risteska dhe nxënës të vitit II dhe III
13. Përzgjedhja e nxënësve për garën rajonale dhe shtetërore të shkollave elektro-makinerike dhe të komunikacionit në RMV	Aleksandar Georgievski dhe mësimdhënës të tjerë nga seksioni elektro-makinerik dhe i komunikacionit
14. Përgatitja e testeve për garat e ardhshme (rajonale, shtetërore etj.)	Aleksandar Georgievski dhe mësimdhënës të tjerë nga seksioni elektro-makinerik
15. Përgatitja/mentorimi i nxënësve për pjesëmarrje në gara rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare	Mësimdhënës/mentorë dhe nxënësit e përzgjedhur të vitit III dhe IV
16. Mentorimi i nxënësve për përgatitjen e detyrave projektuese për Maturën Shtetërore dhe Provimin Përfundimtar	Mësimdhënësit e lëndëve nga grupi i komunikacionit, elektroteknikës dhe makinerisë
17. Përzgjedhja e nxënësve për garën ndërkombëtare „Automekaniku i ri evropian 2027“, Shkup	Punë ekipore e mësimdhënësve të drejtimit të makinerisë – bartës i aktivitetit Aleksandar Georgievski
18. Vizitë në pikëkalim kufitar	Neal Abduli, Nusrije Mejdi (nëntor, dhjetor)
19. Formimi i ekipit të mësimdhënësve dhe nxënësve në klubin e Auto-moto klubit QSHA dhe prezantimi i detyrave që duhet t’i kryejnë në periudhën e ardhshme	Aleksandar Georgievski
20. Aktivitete të vazhdueshme nga procesi edukativo-arsimor	Zoki Stojmirov
Dhjetor	
1. Mentorimi i nxënësve dhe pjesëmarrja në gara rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare	Aleksandar Pupkov, punë ekipore

2. Përgatitja e ushtrimeve auditoriale dhe laboratorike, me qëllim lidhjen e mësimit teorik me atë praktik. Realizimi i ushtrimeve laboratorike.	Miroslav Cvetkovski
3. Mentorimi i nxënësve për përgatitjen e detyrave projektuese për Maturën Shtetërore dhe Provimin Përfundimtar	Punë ekipore
4. Mbledhja e ideve nga nxënësit për futjen e inovacioneve në organizimin e manifestimeve auto-moto	Aleksandar Georgievski
5. Vendosja e bashkëpunimit me shkollat e komunikacionit nga rajoni	Zoki Stojmirov, punë ekipore
6. Mësim praktik i nxënësve të vitit të tretë - teknikë makinerie për automjete motorike për saldim dhe matje	Boban Mitevski
7. Prezantimi i ideve inovative dhe shqyrtimi i mundësive për realizim - gjatë gjithë vitit	Aktivi profesional dhe Aktivi i mësimit praktik
8. Aktivitete hulumtuese me nxënësit	Miroslav Cvetkovski (në vazhdimësi)
9. Pjesëmarrje në projekte, seminare dhe trajnime për mirëmbajtjen e automjeteve motorike dhe dëmet materiale në automjete	Ivan Gjakovski (në vazhdimësi)
10. Përzgjedhja dhe përgatitja e nxënësve për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare	Punë ekipore
11. Mentorimi i nxënësve për përgatitjen e detyrave projektuese për Maturën Shtetërore dhe Provimin Përfundimtar	Të gjithë mësimdhënësit e fushës mësimore profesionale
12. Mentorimi i nxënësve për pjesëmarrje në gara rajonale dhe shtetërore	Aleksandar Georgievski
13. Zbatimi i strategjive për krijimin e modelit për monitorimin dhe vlerësimin e përparimit të nxënësve. Qasje dhe strategji të ndryshme në forcimin e lidhjes mësimdhënës–nxënës–prind	Snezhana Bozhinoska-Risteska, Slave Dimovski (dhjetor–maj)
Janar	
1. Diseminimi te mësimdhënësit sipas nevojave të përcaktuara gjatë mentorimit dhe kërkesave të mësimdhënësve	Koordinatori i projektit, përgjegjësi i fushës mësimore, drejtori
2. Mentorimi i nxënësve për përgatitjen e detyrave projektuese për Maturën Shtetërore dhe Provimin Përfundimtar	Punë ekipore e mësimdhënësve nga drejtimi i makinerisë, komunikacionit dhe elektroteknikës
Shkurt	
1. Përgatitje/mentorim i nxënësve për pjesëmarrje në gara rajonale dhe shtetërore të organizuara nga ZEMSU	(Punë ekipore) Mësimdhënës nga drejtimi elektro-makinerik dhe i komunikacionit
2. Mbajtja e mini-garave në punëtorinë tonë për lidhjen e suksesshme të teorisë me mësimin praktik	Aleksandar Georgievski, ekip mësimdhënësish nga mësimi teorik dhe praktik
3. Përgatitja e nxënësve për garën ndërkombëtare reviale	Zoki Stojmirov
4. Vizita në autoservise dhe ndërmarrje nga fusha e industrisë automobilistike dhe sigurimi i sponsorëve për Ditën e Hapur 2027	Aleksandar Georgievski
5. Pjesëmarrja në zbatimin e politikës së regjistrimit në shkollat fillore jashtë Shkupit	Zoki Stojmirov
6. Vizita në kompani shpedicioni	Zoki Stojmirov, Neal Abduli
7. Punë me nxënësit gjatë përgatitjes së punimeve shkencore dhe pjesëmarrje në garë shtetërore;	Snezhana Bozhinoska-Risteska, Miroslav Cvetkovski

8. Përkthimi në shqip i testeve për garat e ardhshme (rajonale, shtetërore etj.)	Suad Xhemaili, Nexhat Mjaki, Neal Abduli
9. Vizita në kompani shpedicioni	Zoki Stojmirov, Adelon Ajdini, Refik Sadiki
10. Vizita në byro projektuese për përgatitjen e projekteve të komunikacionit	Aleksandar Pupkov dhe Refik Sadiki
11. Përparësitë dhe mangësitë në zbatimin e aktiviteteve ekologjike në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit	Ekip mësimdhënësish nga të gjitha aktivet dhe nxënës
Mars	
1. Kontrolli i nxënësve për garën ndërkombëtare reviale	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, Aneta Pashoska
2. Përgatitja e maketeve ose modifikimi i një automjeti me pamje karakteristike që do të shërbente për nevojat e politikës së regjistrimit	Aleksandar Georgievski, Ismail Sali, ekip mësimdhënësish të mësimit praktik
3. Paraqitja në zjarrfikës, polici dhe Kryqin e Kuq për nevojat e Ditës së Hapur 2027 dhe EAMJ 2027	Aleksandar Georgievski
4. Vizita në Panairin e Punësimit	Adelon Ajdini, Nexhat Mjaki
5. Mbajtja e takimeve të vazhdueshme me nxënësit dhe ushtrimi i roleve që kanë për manifestimin me automjete	Aleksandar Georgievski
6. Vendosja e strategjisë dhe përgatitja e aktiviteteve për mënjanimin e mangësive në zbatimin e shprehive ekologjike në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit	Ekip mësimdhënësish nga të gjitha aktivet dhe nxënës
7. Përgatitja e doracakut për dhënien e Provimit Përfundimtar dhe Maturës Shtetërore	Punë ekipore
8. Vizita te nxënësit gjatë punës praktike jashtë shkollës	Mësimdhënësit që realizojnë MPP
9. Pjesëmarrja në zbatimin e politikës së regjistrimit në shkollat fillore jashtë Shkupit	Zoki Stojmirov, Aneta Pashoska
10. Punë hulumtuese dhe jashtëmësimore me nxënësit - ndjekja, orientimi dhe mbështetja e nxënësve në hulumtime, përgatitjen e punimeve dhe përgatitjen për gara	(Punë ekipore) Refik Sadiki, Sanja Tonevska – në vazhdimësi
11. Zhvillimi dhe njohja e teknikave të reja për përdorimin e drejtë të përfshirjes në procesin arsimor.	Snezhana Bozhinoska-Risteska
12. Prezantimi i detyrave projektuese të viteve përfundimtare	Zoki Stojmirov
13. Punë me nxënësit gjatë përgatitjes së punimeve shkencore dhe pjesëmarrje në garë shtetërore	Ekip mësimdhënësish nga seksioni elektro-makinerik, i komunikacionit dhe mësimit praktik
14. Bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë. Shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim në projekte për logjistikë dhe transport	Slave Dimovski (në vazhdimësi)
15. Punë me nxënësit për përgatitjen e detyrave projektuese për vitet përfundimtare dhe nxitjen e përgjegjësisë, kreativitetit dhe saktësisë	Mësimdhënësit nga drejtimi elektro-makinerik dhe i komunikacionit
16. Bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë. Shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim në projekte për Logjistikë dhe transport	Snezhana Bozhinoska-Risteska (në vazhdimësi)
17. Pjesëmarrja e nxënësve në gara rajonale për arsimin katërvjeçar:	Drejtori, mentorët, nxënësit, përgjegjësi i fushës mësimore

18. Përgatitja e testeve për provime të brendshme për Maturën Profesionale Shtetërore, Maturën Shtetërore dhe Maturën Profesionale Shkollore nga arsimi i reformuar katërvjeçar për teknik makinerie për automjete motorike, teknik të komunikacionit rrugor dhe teknik të transportit dhe magazinimit	(Punë ekipore) Mësimdhënës nga drejtimi elektro-makinerik dhe i komunikacionit
Prill	
1. Pjesëmarrja në zbatimin e politikës së regjistrimit në shkollat fillore	Boban Mitevski, Zoki Stojmirov, ekip mësimdhënësish
2. Pjesëmarrja në garat e ZEMSU	Mësimdhënës-mentorë nga drejtimi i makinerisë dhe komunikacionit
3. Përgatitja e nxënësve për dhënien e pjesës praktike të Provimit Përfundimtar për drejtimin e elektroteknikës	Boban Mitevski
4. Përgatitja dhe pjesëmarrja me punime në garën shtetërore,	Snezhana B. Risteska
5. Zbatimi i aksionit ekologjik në QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup	Ekip mësimdhënësish nga të gjitha aktivet dhe nxënës
6. Mbajtja e ditëve të hapura sipas komunave, ku do të ftoheshin dhe organizoheshin nxënësit me prindërit dhe mësimdhënësit nga ato komuna, ndërsa ne do të prezantoheshim me elemente karakteristike të shkollës, si: automjete të dhuruara, punime, mototester, simulator etj.	Aleksandar Georgievski, ekip mësimdhënësish
7. Testimi i gazrave të shkarkimit pas instalimit dhe përshtatjes së automjetit Skoda Felicia me pajisje shtesë hidrogjeni të fituar përmes elektrolizës së ujit	Ekip mësimdhënësish nga drejtimi i makinerisë dhe elektroteknikës dhe nxënës me interes për ide inovative
8. Mbajtja e takimeve të vazhdueshme me nxënësit dhe ushtrimi i roleve që kanë për aktivitetet	Aleksandar Georgievski
9. Realizimi i manifestimit Dita e Hapur - Panair karriere për nxënësit e viteve përfundimtare	Drejtori, ndihmësdrejtori për hulumtim, trajnim dhe zhvillim, Agim Jusufi, Aleksandar Georgievski, përgjegjësi i Aktivit profesional
10. Përgatitja dhe pjesëmarrja me punime në garën shtetërore	Aleksandar Georgievski
11. Përgatitja e nxënësve për dhënien e pjesës praktike të Provimit Përfundimtar për drejtimin e elektroteknikës	Boban Mitevski, Miroslav Cvetkovski
12. Pjesëmarrja në zbatimin e politikës së regjistrimit në shkollat fillore	Boban Mitevski dhe ekip mësimdhënësish
13. Pjesëmarrja në garë ndërkombëtare reviale me nxënës në Çaçak, R. e Serbisë	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, Aneta Pashoska
Maj	
1. Pjesëmarrja në Automekaniku i ri evropian 2027, Shkup	Aleksandar Georgievski, Punë ekipore (mentorë, nxënës, drejtor)
2. Aktivitete për realizimin e suksesshëm të praktikës feriale	Agim Jusufi dhe të tjerë nga fusha mësimore profesionale
3. Pjesëmarrja në zbatimin e politikës së regjistrimit në shkollat fillore	Të gjithë mësimdhënësit e fushës mësimore profesionale
4. Bashkëpunimi me MPB-në - njësitë shkollore të komunikacionit	Snezhana Bozhinoska-Risteska dhe mësimdhënës të tjerë nga drejtimi i komunikacionit

5. Pjesëmarrja në aktivitetin: „Ditët e zejtarisë“ të organizuar nga Oda e zejtarëve, Shkup	Boban Mitevski
6. Përgatitja e nxënësve për dhënien e pjesës praktike të Provimit Përfundimtar për drejtimin e elektroteknikës	Boban Mitevski, Miroslav Cvetkovski
7. Pjesëmarrja në garë ndërkombëtare reviale me nxënës në R. e Kroacisë	(Punë ekipore) Zoki Stojmirov, Aneta Pashoska
8. Pjesëmarrja në garën shtetërore të shkollave elektro-makinerike dhe të komunikacionit	Drejtori, mentorët, nxënësit, përgjegjësi i fushës mësimore
9. Përgatitja e nxënësve për dhënien e pjesës praktike të Provimit Përfundimtar për drejtimin e elektroteknikës	Boban Mitevski
10. Prezantimi i rezultateve të arritura nga garat e nxënësve	Drejtori, përgjegjësi i fushës mësimore profesionale dhe mentorët
11. Analiza e efekteve të mentorimit të mësimdhënësve (përparësitë dhe mangësitë)	Përgjegjësi i fushës mësimore, mësimdhënësit, drejtori
12. Përgatitja e prezantimit dhe testeve për trajnim nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë nxënësit që shkojnë në praktikë feriale, në përputhje me drejtimin dhe programin e parashikuar të arsimit të mesëm profesional të reformuar.	Ekipi për siguri dhe shëndet në punë i QSHA-së
Qershor	
1. Trajnim nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë nxënësit që shkojnë në praktikë feriale, në përputhje me drejtimin dhe programin e parashikuar të arsimit të mesëm profesional të reformuar.	Ekipi për siguri dhe shëndet në punë i QSHA-së
2. Vizita në tubime auto-moto	Aleksandar Georgievski
3. Analiza e përfitimeve nga aktivitetet e realizuara	Mentori, drejtori, mësimdhënësit

Përgjegjësi i fushës mësimore profesionale,
ing. i dipl. i komunikacionit Zoki Stojmirov

B) Programi i punës së fushës mësimore natyrore-matematikore për vitin shkollor 2026/2027

Fushën mësimore natyrore-matematikore e përbëjnë 13 mësimdhënës, të shpërndarë sipas aktiveve:

- Matematikë (5 mësimdhënës)
- Fizikë (2 mësimdhënës)
- Informatikë (2 mësimdhënës)
- Art figurativ (2 mësimdhënës)
- Art muzikor (2 mësimdhënës)

Aktivin e matematikës e përbëjnë:

- Aneta Pashoska
- Svetllana Dimitrievska
- Kristina Sokolova

- Sedat Mustafovski
- Dritan Ademi

Aktivin e fizikës e përbëjnë:

- Vevait Alimi
- Jovan Jonovski

Aktivin e informatikës e përbëjnë:

- Marija Dimitrova
- Jonuz Sopa

Aktivin e artit figurativ e përbëjnë:

- Marijana Marioncu Simovska
- Amir Emini

Aktivin e artit muzikor e përbëjnë:

- Kristijan Stojanovski
- Jesir Hoxha

Aktivitetet prioritare të fushës mësimore natyrore-matematikore për vitin shkollor 2026/2027 do të jenë:

1. Avancimi i cilësisë së mësimdhënies;
2. Përsosja profesionale e mësimdhënësve;
3. Përdorimi efikas i pajisjeve të TIK-ut dhe tabelave elektronike;
4. Përgatitjet për Maturën Shtetërore dhe provimet përfundimtare;
5. Përfshirja më e madhe e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimore (seksione, trajnime, projekte etj.);
6. Thellimi i bashkëpunimit me institucione shkencore e kulturore dhe me organizata joqeveritare;
7. Këshillimi dhe orientimi i nxënësve drejt të menduarit krijues dhe kritik, tolerancës dhe mirëkuptimit, sjelljes gjithëpërfshirëse dhe pranimit të dallimeve.

Aktivitetet prioritare në kuadër të fushës sonë mësimore do të realizohen duke i orientuar mësimdhënësit drejt:

- Përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies përmes një sistemi të mentorimit të vazhdueshëm dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet mësimdhënësve që ligjërojnë lëndë të njëjta ose të përafërta.
- Praktikimit të orëve të hapura ku mund të marrin pjesë mësimdhënës të interesuar nga fusha jonë ose fusha të tjera mësimore, me qëllim shkëmbimin e përvojave, ideve, kritikave konstruktive dhe propozimeve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.
- Përshtatjes së brendshme të standardeve të vlerësimit në kuadër të secilës lëndë veçmas.
- Hartimit të testeve objektive, shkëmbimit, përshtatjes dhe përsosjes së tyre me qëllim zbatimin e standardeve të barabarta të vlerësimit në kuadër të një lënde mësimore.
- Pjesëmarrjes në trajnime profesionale të organizuara brenda dhe jashtë shkollës sonë, si dhe motivimit të mësimdhënësve për t'u orientuar drejt zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Vizitave në konferenca ndërkombëtare nga fushat e interesit të fushës mësimore natyrore-matematikore.
- Përdorimit aktiv dhe të rregullt të pajisjeve të TIK-ut dhe tabelave elektronike në Shkollë me qëllim modernizimin e formave dhe metodave të mësimdhënies.
- Organizimit dhe realizimit të orëve intensive të mësimit shtesë në lëndët që janë pjesë e Maturës Shtetërore dhe provimeve përfundimtare.
- Motivimit të nxënësve për pjesëmarrje dhe përgatitje të duhur për gara të ndryshme komunale, rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare.
- Motivimit të nxënësve për pjesëmarrje më të madhe dhe më aktive në aktivitetet jashtëmësimore dhe bashkëpunim me institucione shkencore e kulturore dhe organizata joqeveritare.
- Bashkëpunimit aktiv me nxënësit në kuadër të seksioneve dhe klubeve.
- Shënimit të datave të rëndësishme nga fusha natyrore-matematikore përmes përgatitjes së prezantimeve përkatëse dhe vizitave në institucione shkencore.
- Vizitave të organizuara në institucione kulturore dhe shkencore.
- Bashkëpunimit me organizata joqeveritare.
- Motivimit dhe orientimit të nxënësve drejt të menduarit kritik dhe krijues, tolerancës dhe mirëkuptimit, zgjidhjes paqësore të konflikteve, sjelljes gjithëpërfshirëse dhe pranimit të

dallimeve përmes organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, shoqërimeve joformale, punëtorive, debateve dhe trajnimeve.

Veprimtaria edukativo-arsimore jashtëmësimore
(seksione, klube, organizata të nxënësve, projekte etj.)

- Seksioni i matematikës - qëllimi: punë e vazhdueshme shtesë me nxënës të talentuar dhe përgatitje intensive për pjesëmarrje në gara të ndryshme, si dhe përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore.
- Klubi i fizikanëve të rinj - qëllimi: intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike përmes punës së përbashkët në projekte nga fusha e fizikës.
- Klubi i informatikës - qëllimi: punë e vazhdueshme me nxënës të talentuar dhe përsosja e aftësive të tyre në fushën e informatikës.
- Bendi i shkollës - qëllimi: formimi i një bendi shkollor që do të marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e organizuara në kuadër të shkollës sonë.
- Projekti: „Integrimi ndëretnik i të rinjve në arsim“ - qëllimi: nxënësit nga të gjitha bashkësitë etnike të integrohen në arsim.
- Projekti: Arsimi gjithëpërfshirës - qëllimi: nxënësit të kuptojnë çfarë është arsimi gjithëpërfshirës dhe t'i dallojnë e pranojnë përfitimet e tij.

Një nga detyrat parësore të anëtarëve të aktivit tonë është që përmes aktiviteteve nga më të ndryshmet nxënësit të nxiten të tregojnë përgjegjësi më të madhe ndaj obligimeve të dhëna, të zhvillojnë shpikshmërinë, kreativitetin dhe të menduarit kritik, t'i zhvillojnë e përsosin aftësitë e tyre, të njihen më mirë dhe ta pranojnë njëri-tjetrin, si dhe vazhdimisht të shoqërohen e të bashkëpunojnë.

Plan operativ
e mësimdhënësve të fushës mësimore natyrore-matematikore:

Shtator	**Realizuesit**
• Takim me fushën mësimore natyrore-matematikore - Udhëzime për fillimin e suksesshëm të vitit të ri shkollor	të gjithë mësimdhënësit
• Përgatitja e planifikimeve vjetore, tematike dhe ditore	të gjithë mësimdhënësit
• Përgatitja e programit për mësim plotësues dhe shtesë, si dhe planit individual arsimor për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore	të gjithë mësimdhënësit
• Përshtatja e brendshme e standardeve të vlerësimit	të gjithë mësimdhënësit
• Marrëveshje për realizimin e orëve të hapura	të gjithë kujdestarët e klasave
• Realizimi i takimit të parë të rregullt me prindër	mësimdhënësit e matematikës dhe fizikës

• Zbatimi i testimeve fillestare me nxënësit e vitit të parë	Aneta Pashoska
• Përgatitja e orarit të mësimit dhe pjesëmarrja në organizimin për fillimin e suksesshëm të vitit të ri shkollor	Jovan Jonovski
• Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village	Mësimdhënësit e fizikës
• Vizita në planetarium	Mësimdhënësit e fizikës Marija Dimitrova
• Vizita në Drejtorinë Hidrometeorologjike	
• Formimi i Klubit të Informatikës dhe përfshirja e anëtarëve të rinj	mësimdhënësit e matematikës dhe fizikës
• Përfshirja e anëtarëve të rinj në Seksionin e Matematikës dhe Klubin e Fizikanëve të Rinj	Aneta Pashovska, Svetlana Dimitrievska
• Formimi i grupit të nxënësve që do të përgatiten për Maturën Shtetërore	Jonuz Sopa
• Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale. Përgatitja për krijimin e bazës së re për vitin shkollor 2026/2027 në LOTUS	
• Organizimi dhe realizimi i debateve dhe diskutimeve në shkollë për tema me interes për nxënësit	Kristijan Stojanovski
• Ekspozitë artistike e punimeve të nxënësve me rastin e 8 Shtatorit - Ditës së Pavarësisë	Marijana Marioncu Simovska
Tetor	
• Përgatitja e testeve objektive, shkëmbimi, përshtatja dhe përmirësimi i tyre me qëllim zbatimin e standardeve të barabarta të vlerësimit	të gjithë mësimdhënësit
• Përfshirja e anëtarëve të rinj në Seksionin e Matematikës dhe Klubin e Fizikanëve të Rinj	Aneta Pashoska, Svetlana Dimitrievska, Jovan Jonovski, Vevait Alimi
• Përgatitja e mjeteve demonstrative për nevojat e mësimit (hamerë, pano me formula, modele të trupave gjeometrikë etj.)	Aneta Pashovska, Svetlana Dimitrievska
• Përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore	
• Punë me nxënësit e talentuar në kuadër të klubeve dhe seksioneve	Aneta Pashovska, Svetlana Dimitrievska
• Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale. Përgatitja e memorieve USB për bazën LOTUS	të gjithë mësimdhënësit Jonuz Sopa
• Punëtori me temë „Komunikimi jo i dhunshëm“	
• Vizita në shfaqje operistike	
• Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village	
• Vizita në Fakultetin e Elektroteknikës dhe Teknologjive Informative	Kristina Sokolova
• Përgatitja e prezantimit për risitë në informatikë – nga aspekti i harduerit.	Kristijan Stojanovski Jovan Jonovski Mësimdhënësit e fizikës Marija Dimitrova
Nëntor	

• Takim i Aktivit për shqyrtimin e rezultateve nga aktivitetet e deritanishme, diskutim për orët e hapura dhe shkëmbim përvojash, analizë e tremujorit të parë	të gjithë mësimdhënësit
• Përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore	Aneta Pashovska, Svetlana Dimitrievska
• Punë me nxënësit e talentuar në kuadër të klubeve dhe seksioneve dhe përgatitja e tyre për pjesëmarrje eventuale në gara	mësimdhënësit e matematikës dhe fizikës
• Përgatitja e prezantimit për risitë në informatikë nga aspekti i softuerit	
• Hulumtim me temë „Matematika dhe natyra“	Marija Dimitrova
• Mbështetje teknike gjatë shënimit të 21 Nëntorit - Ditës së alfabetit shqip	mësimdhënësit e matematikës
• Vizita në shfaqje baleti	
• Pjesëmarrje në Konferencën për efikasitet energjetik dhe zhvillim të qëndrueshëm në Fakultetin e Elektroteknikës dhe Teknologjive Informative	Jonuz Sopa, Sedat Mustafovski Kristijan Stojanovski
• Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale. Hapja e bazës LOTUS për futjen e të dhënave të tremujorit të parë	Jovan Jonovski, Vevait Alimi Jonuz Sopa
• Historia e matematikanëve të njohur Gaus, Ojler	
• Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village	Dritan Ademi Jovan Jonovski
Dhjetor	
• Përgatitja e testeve gjysmëvjetore, shkëmbimi, përshtatja dhe përmirësimi i tyre me qëllim zbatimin e standardeve të barabarta të vlerësimit	të gjithë mësimdhënësit
• Përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore	Aneta Pashovska, Svetlana Dimitrievska
• Punë me nxënësit e talentuar në kuadër të klubeve dhe seksioneve	të gjithë mësimdhënësit
• Mjete të reja në përdorimin e internetit për të nxënë më mirë.	Marija Dimitrova
• Vizita në Institutin e Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Matematikës	mësimdhënësit e fizikës
• „Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale“	Jonuz Sopa
• Punëtori me temë „Empatia“	
• Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village	Mësimdhënësit e matematikës Jovan Jonovski
• Vizita të organizuara në koncerte, ekspozita, monumente kulturore-historike dhe lokalitete arkeologjike gjatë punës në projekte	Mësimdhënësit e fizikës
• Vizita në Filharmoninë e Maqedonisë në Shkup	Kristijan Stojanovski

• Pazar humanitar i Vitit të Ri dhe dekorimi i hapësirës shkollore me punime të Vitit të Ri nga nxënësit	Marijana Marioncu Simovska
Janar dhe shkurt	
• Takim i Aktivit për analizën e suksesit dhe vijueshmërisë së nxënësve gjatë gjysmëvjetorit të parë, analizën e testeve gjysmëvjetore dhe shkëmbimin e përvojave nga orët e hapura	të gjithë mësimdhënësit
• Përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore	Aneta Pashoska, Svetlana Dimitrievska mësimdhënësit e matematikës
• Përgatitja e pano-ve me formulat më të rëndësishme	të gjithë mësimdhënësit
• Punë me nxënësit e talentuar në kuadër të klubeve dhe seksioneve	mësimdhënësit e fizikës
• Pjesëmarrje në seminar të organizuar nga Shoqata Astronomike e Maqedonisë – Shkup	mësimdhënësit e matematikës
• Pjesëmarrje në garën komunale të matematikës	Jonuz Sopa
• Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale	Jovan Jonovski
• Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village	Mësimdhënësit e fizikës
• Pjesëmarrje në punëtorinë „Mësimi bashkëkohor“, të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Matematikës, Shkup	Marija Dimitrova
• Si të arrij deri te informatat më të mira që më nevojiten për të nxënë më me sukses – shprehje përmes prezantimeve.	Kristijan Stojanovski
• Vizita të organizuara në koncerte të tjera, ekspozita, monumente kulturore-historike dhe lokalitete arkeologjike gjatë punës në projekte dhe ekskursione njëditore.	
Mars	
• Përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore	Aneta Pashoska, Svetlana Dimitrievska të gjithë mësimdhënësit
• Punë me nxënësit e talentuar në kuadër të klubeve dhe seksioneve	mësimdhënësit e matematikës
• Pjesëmarrje në garën ndërkombëtare të matematikës „KENGUR“	mësimdhënësit e matematikës
• Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Matematikës dhe hulumtime me temë „Numri PI“	Jonuz Sopa, Sedat Mustafovski
• Mbështetje teknike gjatë shënimit të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit Shqiptar	Jonuz Sopa
• Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale	
• Përditësimi i të dhënave në fletushkat për regjistrim dhe posterët për Ditën e Hapur	Jonuz Sopa
• Natyra – na fton të kujdesemi më shumë për të dhe për veten – shprehje përmes prezantimeve.	Marija Dimitrova
• Vizita të organizuara në koncerte të tjera, ekspozita, monumente kulturore-historike dhe	Kristijan Stojanovski

lokalitete arkeologjike gjatë punës në projekte dhe ekskursione njëditore; • Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village • Pjesëmarrje në gara rajonale dhe shtetërore nga lënda e fizikës	 Jovan Jonovski Mësimdhënësit e fizikës
Prill	
• Takim i Aktivit për analizën e suksesit në tremujorin e tretë dhe propozim-masa për përmirësimin e tij • Përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore • Punë me nxënësit e talentuar në kuadër të klubeve dhe seksioneve • Hulumtim me temë: „Zbatimi i gjeometrisë në jetën e përditshme“ • Prezantim me temë: „Historia e matematikanëve të njohur“ • Metoda, mjete dhe burime për mësim efektiv të TIK-ut në kuadër të arsimit profesional • Mbështetje matematikore në përgatitjen e nxënësve dhe përkthimin e materialeve për pjesëmarrje në garën reviale nga fusha e komunikacionit dhe transportit që do të mbahet në R. e Serbisë • Vizita në hidrocentralin „Matka“ • Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale • Përdorimi i ndërgjegjshëm i ujit dhe energjisë elektrike – shprehje përmes prezantimeve • Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village • Pjesëmarrje në garën „Sotrat e Qytetit“ • Ekspozitë e punimeve artistike me rastin e festës së patronatit të shkollës	të gjithë mësimdhënësit Aneta Pashovska, Svetlana Dimitrievska të gjithë mësimdhënësit Aneta Pashoska mësimdhënësit e matematikës Jonuz Sopa Aneta Pashovska Vevait Alimi Jonuz Sopa Marija Dimitrova Jovan Jonovski Kristijan Stojanovski Marijana Marioncu Simovska
Maj dhe qershor	
• Takim i Aktivit, diskutim për Maturën Shtetërore dhe provimet përfundimtare, përgatitje për testimet vjetore dhe analizë e rezultateve të arritura gjatë gjithë vitit shkollor • Përgatitja e testeve vjetore, shkëmbimi dhe përshtatja e tyre me qëllim zbatimin e standardeve të barabarta të vlerësimit • Përgatitja e nxënësve për dhënien e Maturës Shtetërore • Punë me nxënësit e talentuar në kuadër të klubeve dhe seksioneve • Përgatitja e trupave gjeometrikë • Hulumtim me temë: „Ikosaedri“ • Prezantimi i projekteve të përgatitura nga anëtarët e Klubit të Fizikanëve të Rinj • Vizita në Panairin e Librit	të gjithë mësimdhënësit të gjithë mësimdhënësit Aneta Pashoska, Svetlana Dimitrievska të gjithë mësimdhënësit mësimdhënësit e matematikës mësimdhënësit e matematikës mësimdhënësit e fizikës Mësimdhënësit e fizikës Jonuz Sopa

• Mbështetje e vazhdueshme në punën e e-Ditarit dhe për mirëmbajtjen e ueb-faqes dhe profileve në rrjetet sociale • Përgatitja e raporteve vjetore për vitin shkollor aktual dhe programeve vjetore të punës për vitin e ardhshëm shkollor • Përdorimi i sigurt i internetit – shprehje përmes prezantimeve • Pjesëmarrje në garën MASSUM • Aktivitete të vazhdueshme me projektin Solar Village	të gjithë mësimdhënësit Marija Dimitrova Kristijan Stojanovski Jovan Jonovski

Përgjegjësi i fushës mësimore,
Vevait Alimi

C) PROGRAMI VJETOR i fushës mësimore kulturore-gjuhësore për vitin shkollor 2026/2027

I gjithë aktiviteti i planifikuar në këtë program ka për qëllim të sigurojë mësimdhënie bashkëkohore, zgjerimin e njohurive të nxënësve përmes punës kërkimore dhe angazhimit të tyre të drejtpërdrejtë në realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara, të nxisë shpikshmërinë dhe kreativitetin te nxënësit, të përmirësojë aftësitë e tyre komunikuese, shprehitë pozitive dhe vetëbesimin, si dhe afrimin në planin multietnik.

Aktivitetet prioritare për vitin shkollor 2026/2027 janë:

- **Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes:** planeve dhe programeve operative të planifikuara me cilësi, mentorimit si proces i vazhdueshëm, bashkëpunimit profesional, shkëmbimit të brendshëm të përvojave, trajnimeve cilësore në përputhje me trendet e arsimit bashkëkohor evropian, planifikimeve për mësim plotësues dhe shtesë, vlerësimit të arritjeve të mësimdhënësve, projekteve, hulumtimeve, vizitave, shkëmbimit të përvojave, prezantimeve, shënimit të datave të rëndësishme, seksioneve, si dhe formave të tjera në funksion të arsimit cilësor.
- **Modernizimi i mësimdhënies** me përfaqësim më të madh të qasjes interaktive gjatë realizimit të mësimit me teknologji bashkëkohore.
- **Përmirësimi i rregullsisë së nxënësve përmes aktivizimit dhe motivimit gjatë orëve mësimore.**
- **Hartimi dhe zbatimi i testeve të standardizuara të njohurive, veçanërisht në vetëvlerësimin e arritjeve të nxënësve.**
- Proces i vazhdueshëm - zbatimi i standardeve, përdorimi i testeve objektive, komunikimi gojor, detyrat projektuese, punimet me shkrim, esetë dhe garat.
- **Përgatitjet për Maturën Shtetërore, Maturën Shtetërore Profesionale, Maturën Shkollore dhe Provimin Përfundimtar**

- Në këtë drejtim do të hartohen teste të brendshme, ushtrime dhe forma të tjera për realizim cilësor dhe të suksesshëm, si dhe orë shtesë e plotësuese për sukses maksimal.
- **Motivimi i nxënësve për pjesëmarrje në gara, konkurse letrare dhe oratori brenda dhe jashtë Shkollës.**
- **Ngritja e vetëdijes ekologjike te nxënësit përmes mësimdhënies dhe pjesëmarrjes në Eko-bordin e Shkollës.**
- **Veprimtari edukativo-arsimore jashtëmësimore (projekte, seksione, trajnime, punëtori, drama etj.).**
- **Trajnime për përsosjen profesionale të kuadrit mësimor.**

Seksione:

Seksioni letrar - nxënësit që kanë interes për gjuhën amtare, përmes krijimit individual të hartimeve krijuese, poezive dhe krijimeve të llojeve të tjera, të zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese, si dhe talentin për të shkruar krijime të veta në gjuhën letrare;

Seksioni i dramës dhe recitimit - qëllimi është që nxënësit të pasurohen me njohuri dhe aftësi të reja nga fusha e dramaturgjisë. Ata aftësohen për interpretim të talentuar të fjalës artistike. Në veçanti u zbulohet talenti për artin skenik, lëvizjen, të folurit dhe improvizimin. Kjo nxit te nxënësit shpikshmërinë dhe kreativitetin.

Seksioni multimedial „Vozit në QSHA“ - seksioni ka për qëllim që përmes incizimit të videove, mesazheve dhe filmave të shkurtër gjatë vitit shkollor të promovohet Shkolla. (mësimdhënës përgjegjës: Koce Tapshanovski).

Manifestime:

Dita e hapur - qëllimi: promovimi i Shkollës.

Klube, organizata të nxënësve dhe projekte:

- **Organizata rinore** - qëllimi është ndihma në të gjitha aktivitetet në Shkollë (bartës: Koce Tapshanovski);
- **Klubi i oratorëve -** të folurit publik - qëllimi: përmirësimi i aftësive komunikuese, fitimi i shprehive pozitive dhe aftësive të të folurit, nxitja e frymës garuese (bartëse: Lençe Tomova; bashkëpunëtorë: Silvija Mitrevska-Filipova, Koce Tapshanovski, Bunjamin Osmani, Valdeta Kasapi);
- **Qendra e Karrierës** - projekt - qëllimi: orientimi profesional dhe në karrierë i nxënësve gjatë arsimimit të tyre në shkollën tonë (Eleonora Beqiri, këshilltare karriere; bashkëpunëtorë: Lençe Tomova, Bunjamin Osmani).
- **Klubi i Kryqit të Kuq** - zhvillimi i ndjenjës së humanitetit, solidaritetit dhe tolerancës (aksione për dhurimin e gjakut, trajnime për dhënien e ndihmës dhe vetëndihmës, gara të ndihmës së parë, aksione humanitare etj.) (bartës: Koce Tapshanovski).
- **Aktivitete që përsëriten në vazhdimësi dhe lidhen me:** gara, vizita në qendra kulturore, muze, shfaqje muzikore, manifestime, trajnime për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, shënimin e datave të rëndësishme, pano, material vizual, punëtori etj. Qëllimi është modernizimi i mësimdhënies, zhvillimi i frymës garuese, njohja me data dhe personalitete të rëndësishme, zgjerimi i njohurive, zhvillimi i aftësive komunikuese, nxitja e kreativitetit dhe e klimës multietnike.
- **Projekti „Integrimi ndëretnik i të rinjve në arsim“ -** realizimi i orëve të përbashkëta në paralele me gjuhë mësimore maqedonase dhe shqipe; iniciativë që në shkollën tonë funksionon tashmë shtatë vjet, nën udhëheqjen e Qytetit të Shkupit dhe Qendrës Maqedonase për Arsim Qytetar - QMAQ, OSBE. Do të realizohen aktivitete që burojnë nga Strategjia për integrim ndëretnik dhe përfshirje qytetare. Aktivitetet do të realizohen sipas Planit të Veprimit të paraparë dhe të propozuar nga Qyteti i Shkupit. (koordinatore: Silvija Mitrevska-Filipova; mësimdhënëse të gjuhës angleze: Stela Kostovska dhe Vjosa Vojka).

Aktivitete marketingu:

Hartimi i fletëpalosjeve, flajerëve, broshurave dhe materialeve të tjera të marketingut, si dhe prezantimeve me qëllim promovimin e shkollës para publikut më të gjerë dhe përfshirjen në aktivitete të mbështetura nga Qyteti i Shkupit.

Sistemi i mentorimit:

- Vazhdon sistemi i mentorimit të kuadrit mësimor për realizim më të mirë të procesit edukativo-arsimor, me qëllim arritjen e cilësisë më të lartë në krijimin e planeve vjetore dhe tematike, si dhe përgatitjeve ditore me përfshirjen e të gjitha elementeve.
- Ndjekja e vazhdueshme e obligimeve lidhur me plotësimin në kohë të ditarit elektronik.

- Përpunimi cilësor i formularëve gjatë zbatimit të procesit të mentorimit, me vlerësim kritik të cilësisë së orës gjatë vizitës së saj.
- Plotësimi i formularëve për pikëzimin e angazhimit dhe cilësisë së mësimdhënies për secilin mësimdhënës të mentoruar.

Periudha	Aktiviteti	Realizuesi
SHTATOR	Udhëzime të Aktivit për fillimin e vitit shkollor - takim	Përgjegjësi i Aktivit
	Përgatitja e planeve operative të punës	Të gjithë anëtarët e fushës mësimore kulturore-gjuhësore
	Përgatitja dhe zbatimi i testeve fillestare	Mësimdhënësit e lëndëve në vitin e parë
	Projekti „Të folurit publik“ – aktivitete hyrëse (fillestare)	L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova, K. Tapshanovski, B. Osmani, V. Kasapi, J. Asani
	Përgatitja e pano-ve të lidhura me përmbajtjet e programit mësimor nga lënda Gjuhë dhe letërsi maqedonase	S. Atanasovska
	Shënimi i 8 Shtatorit - Ditës Ndërkombëtare të Shkrim-Leximit	J. Petrevska
	Shënimi i Ditës së Falënderimeve	M. Cvetkova, H. Fejzullai
	Shënimi i festimit të kulturave të tjera	S. Kostovska, V. Zeqiri
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai
TETOR	Mentorimi i kuadrit mësimor - proces i vazhdueshëm	Mentor
	Të folurit publik – aktivitete të vazhdueshme	L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova, K. Tapshanovski, B. Osmani, V. Kasapi, J. Asani
	Qendra për karrierë – punëtori, trajnime, këshillim individual dhe grupor	L. Tomova, B. Osmani
	Shënimi i 5 Tetorit - Ditës Botërore të Mësuesit	Të gjithë mësimdhënësit e Aktivit
	Aktivitete me rastin e muajit të librit	J. Petrevska
	Përgatitja e maskave për Halloween	M. Cvetkova, H. Fejzullai, S. Kostovska, V. Zeqiri
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai
NËNTOR	Takim - Fusha mësimore kulturore-gjuhësore	Përgjegjësi i Aktivit
	Mentorimi i kuadrit mësimor - proces i vazhdueshëm	Mentor
	Të folurit publik – aktivitete të vazhdueshme	L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova, K. Tapshanovski, B. Osmani, V. Kasapi, J. Asani
	Qendra për karrierë – punëtori, trajnime, këshillim individual dhe grupor	L. Tomova, B. Osmani
	Shënimi i 22 Nëntorit – Ditës së alfabetit shqip	B. Osmani, V. Kasapi, J. Asani
	Shënimi i ditëlindjes së Krste Petkov Misirkovit – 18 nëntor	J. Petrevska
	Përgatitja e dekorimeve të Vitit të Ri dhe Krishtlindjeve për pazarin e Vitit të Ri	M. Cvetkova, H. Fejzullai, V. Zeqiri, S. Kostovska,
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai
DHJETOR	Mentorimi i kuadrit mësimor - proces i vazhdueshëm	Mentor

	Projekti „Të folurit publik“ – manifestim tradicional – Mbrëmje oratorike/aktivitete përfundimtare	L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova, K. Tapshanovski, B. Osmani, V. Kasapi, J. Asani
	Qendra për karrierë – punëtori, trajnime, këshillim individual dhe grupor	L. Tomova, B. Osmani
	Organizimi i aksionit humanitar në bashkëpunim me Shërbimin Profesional	S. Atanasovska
	Shënimi i ditëlindjes së Blazhe Koneskit – 19 dhjetor	J. Petrevska
	Përgatitja e kartolinave të Vitit të Ri dhe Krishtlindjeve	M. Cvetkova, S. Kostovska, H. Fejzullai, V. Zeqiri
	Dëgjimi i këngëve angleze të Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri	M. Cvetkova, S. Kostovska, H. Fejzullai, V. Zeqiri
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai
JANAR/ SHKURT	Takim - Fusha mësimore kulturore-gjuhësore	Përgjegjësi i Aktivit
	Mentorimi i kuadrit mësimor - proces i vazhdueshëm	Mentor
	Qendra për karrierë – punëtori, trajnime, këshillim individual dhe grupor	L. Tomova, B. Osmani
	Shënimi i 21 Shkurtit - Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare	N. Trajkova
	Kuiz „Thuaje në maqedonisht“ me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare	J. Petrevska
	Përgatitja e kartolinave, dekorimeve dhe gazetës së murit për Shën Valentinin	M. Cvetkova, S. Kostovska, H. Fejzullai, V. Zeqiri
MARS	Mentorimi i kuadrit mësimor - proces i vazhdueshëm	Mentor
	Qendra për karrierë – punëtori, trajnime, këshillim individual dhe grupor	L. Tomova, B. Osmani
	Shënimi i 21 Marsit - Ditës Botërore të Poezisë	N. Trajkova, J. Petrevska
	Mbrëmje në QSHA kushtuar prozës dhe poezisë maqedonase (aktivitete fillestare)	L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova
	Shënimi i 7 Marsit – Ditës së Mësuesit Shqiptar	B. Osmani, V. Kasapi, J. Asani
	Përgatitja e kartolinave me rastin e festës së gruas	M. Cvetkova, S. Kostovska
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai
PRILL	Takim - Fusha mësimore kulturore-gjuhësore	Përgjegjësi i Aktivit
	Mentorimi i kuadrit mësimor - proces i vazhdueshëm	Mentor
	Qendra për karrierë – punëtori, trajnime, këshillim individual dhe grupor	L. Tomova, B. Osmani
	Mbrëmje në QSHA kushtuar prozës dhe poezisë maqedonase (aktivitete të vazhdueshme)	L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova
	Ditë e Hapur në Shkollë	Të gjithë mësimdhënësit e Aktivit
	Shënimi i Ditës Botërore të Librit dhe të Drejtave të Autorit - 23 Prill	N. Trajkova, J. Petrevska

	Përgatitja e pano-ve të lidhura me përmbajtjet e programit mësimor nga lënda Gjuhë dhe letërsi maqedonase	S. Atanasovska
	Përzgjedhja e maskës më të mirë për Ditën e Gënjeshtrave	M. Cvetkova, V. Zeqiri, S. Kostovska, H. Fejzullai
	Përgatitja e dekorimeve të Pashkëve Krahasimi i zakoneve të festimit të kësaj feste te ne dhe në vendet anglishtfolëse	M. Cvetkova, S. Kostovska, H. Fejzullai
	Përgatitja e nxënësve për Maturën Shtetërore, Maturën Profesionale Shtetërore, Maturën Shkollore dhe Provimin Përfundimtar	Mësimdhënësit përgjegjës
	Prezantimi i Shkollës në shkollat fillore	Mësimdhënësit e Aktivit
	Vizita në Panairin e Librit	J. Asani
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai
MAJ	Mentorimi i kuadrit mësimor - proces i vazhdueshëm	Mentor
	Qendra për karrierë – punëtori, trajnime, këshillim individual dhe grupor	L. Tomova, B. Osmani
	Shënimi i 24 Majit - Ditës së iluministëve pansllavë	N. Trajkova, K. Tapshanovski
	Shënimi i 9 Majit - Ditës së Evropës me pjesëmarrje në aktivitete të organizuara nga Europe House Shkup.	S. Atanasovska
	Mbrëmje në QSHA kushtuar prozës dhe poezisë maqedonase (aktivitete përfundimtare)	L. Tomova, S. Mitrevska-Filipova
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai
	Shënimi i Ditës së Nënës dhe Ditës së Babait	M. Cvetkova, S. Kostovska, H. Fejzullai
	Përgatitja e nxënësve për Maturën Shtetërore, Maturën Profesionale Shtetërore, Maturën Shkollore dhe Provimin Përfundimtar	Mësimdhënësit përgjegjës që japin mësim në vitet përfundimtare
QERSHOR/KORRIK	Analiza e mentorimit të mësimdhënësve të fushës mësimore kulturore-gjuhësore - arritjet	Drejtori dhe mentori
	Analiza e suksesit të arritur nga nxënësit në fund të vitit shkollor	Të gjithë mësimdhënësit e Aktivit
	Analiza e suksesit të arritur nga nxënësit në Maturën Shtetërore, Maturën Profesionale Shtetërore, Maturën Shkollore dhe Provimin Përfundimtar	Të gjithë mësimdhënësit e Aktivit
	Shënimi i 7 Qershorit - Ditës së drejtshkrimit maqedonas	J. Petrevska
	Incizimi i materialeve video për promovimin e Shkollës	K. Tapshanovski, H. Fejzullai

Përgjegjësi i fushës mësimore,
Silvija Mitrevska-Filipova

D) PROGRAMI VJETOR i fushës mësimore shoqërore-humanitare për vitin shkollor 2026/2027

Aktivitetet prioritare të fushës mësimore për vitin shkollor 2026/2027 do të orientohen drejt:

- rritjes së shkallës së angazhimit pedagogjik me zbatimin e metodave bashkëkohore dhe TIK-ut në procesin mësimor;
- mbajtjes së punëtorive për avancimin e shëndetit mendor të nxënësve;
- zhvillimit të vetëdijes ekologjike te nxënësit (integrimi i eko-përmbajtjeve në kuadër të lëndëve);
- përfshirjes së nxënësve me NVA në aktivitetet jashtëmësimore;
- përsosjes dhe ngritjes profesionale të mësimdhënësve përmes pjesëmarrjes në seminare, punëtori, forume, tribuna, ligjërata e të ngjashme.

Shërbimi profesional (pedagogu, psikologu, sociologu dhe defektologu) do ta ndjekë vazhdimisht veprimtarinë edukativo-arsimore; do të punojë me nxënës që kanë vështirësi në përshtatjen me mjedisin e ri (viti i parë), me vendosjen në konviktet e nxënësve, si dhe me ndjekjen dhe punën me nxënës që shfaqin sjellje antisociale, vonohen në mësim, tregojnë sukses të dobët ose e shkelin Kodin e sjelljes. Do të bëhet vëzhgimi, identifikimi dhe përfshirja e nxënësve me NVA. Do të ketë bashkëpunim të rregullt me prindërit e nxënësve me sjellje devijuese përmes bisedave individuale dhe grupore (Këshillimi i prindërve), por edhe me prindërit fëmijët e të cilëve tregojnë rezultate dhe sukses të mirë në mësim. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet braktisjes së shkollimit nga nxënësit dhe shkaqeve të saj. Do të vazhdojë bashkëpunimi i vazhdueshëm me mësimdhënësit dhe kujdestarët e klasave për respektimin e protokolleve, evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik, si dhe me organizatat qeveritare dhe joqeveritare. Do të hartohen anketa, raporte statistikore, analiza dhe pasqyra për nevojat e shkollës dhe jashtë saj. Do të realizohen punëtori me tema të ndryshme, veçanërisht për avancimin e shëndetit mendor të nxënësve; komunikimin jo të dhunshëm si model sjelljeje dhe kulture jetese ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve; do të përfshihen në projekte, aktivitete jashtëmësimore dhe në përsosjen e tyre profesionale.

Sport dhe aktivitete sportive: pjesëmarrja në garat e organizuara nga Lidhja e Sportit të Shkollave të Mesme të Qytetit të Shkupit dhe organizimi i stërvitjeve për përgatitjen e ekipeve që do të marrin pjesë në gara; mësimdhënës: Marijan Karapandzhevski, Enver Miftari, Artan Zeqiri, Robert Nestorovski dhe Krste Vojneski - koha e realizimit të këtij aktiviteti programor do të përcaktohet pasi të merret kalendari i garave.

Aktivitetet e shpërndara sipas muajve	
SHTATOR	***Realizues***
Përgatitja e planeve vjetore dhe tematike për mësimin e rregullt, shtesë dhe plotësues Përgatitja dhe formimi i portofolit për çdo nxënës Dorëzimi i Kodit të sjelljes, udhëzimit për shqiptimin e masave pedagogjike dhe rregullave të rendit të brendshëm shkollor Programi për përmirësimin e shëndetit mendor - tema Përmirësimi i shëndetit të nxënësve Identifikimi dhe përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore Vizita për njohjen e nxënësve me mënyrën e punës së shpedicioneve Komunikimi jo i dhunshëm si model sjelljeje dhe kulturë jetese ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve Referat „8 Shtatori“ Dita e Pavarësisë	Të gjithë mësimdhënësit Të gjithë mësimdhënësit Shërbimi profesional Elena Petrovska – në vazhdimësi Teuta Daci – në vazhdimësi Iman Izeri, Shërbimi profesional Halime D. Horuni – gjysmëvjetori i parë Sunçica B. Andov – në vazhdimësi Vl. Kralevska, K. Kasapi

Shikimi i tri episodeve të para të filmit dokumentar të RTVM-së „20 vjet pavarësi maqedonase“ Organizimi i garave shkollore në: hendboll, basketboll, volejboll, futboll, pingpong, atletikë në konkurrencën e meshkujve dhe femrave Përgatitja e orarit për mësimin plotësues dhe shtesë	Mësimdhënës i AQ Aleksandar Andonov Mësimdhënësit e sportit dhe aktiviteteve sportive – në vazhdimësi Halime Demir Horuni
TETOR	***Realizuesi***
Shfaqja e filmave dokumentarë dhe historikë të lidhur me mësimin Referate: „11 Tetori“, „23 Tetori“-VMRO, „24 Tetori“ Aktivitete me nxënësit me qëllim nxitjen, motivimin dhe forcimin e vetëbesimit, respektit dhe tolerancës Vizita në SHA Posta me nxënësit Vizita në Muzeun e Luftës Revolucionare Maqedonase me rastin e 23 Tetorit Përgatitja e planit individual arsimor Shfaqja e filmit „11 Tetori“ të „Vardar Film“ Organizimi i trajnimeve për përmirësimin e ekipeve që do të marrin pjesë në garat e organizuara nga Qyteti i Shkupit Ruajtja dhe kultivimi i shëndetit, krijimi i kushteve për jetë të shëndetshme: punëtori (alkooli, droga, SIDA, tuberkulozi, higjiena personale, pirja e duhanit – shprehi e rrezikshme, pamja e rregullt dhe e përshtatshme etj.) Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna Pjesëmarrje në gara të historisë nëse organizohen Mentorimi i kuadrit mësimor	K. Kasapi – në vazhdimësi V. Kralevska dhe K. Kasapi Sunçica B. Andov – në vazhdimësi Igor Ivanoviq V. Kralevska, A. Andonov – gjysmëvjetori i parë të gjithë mësimdhënësit, defektolog mësimdhënës i AQ Mësimdhënësit e sportit dhe aktiviteteve sportive – në vazhdimësi Teuta Daci – në vazhdimësi Elena Petrovska – në vazhdimësi Violeta Kralevska Violeta Kralevska
NËNTOR	***Realizuesi***
Analiza e rezultateve të arritura në tremujorin e parë, analiza e përparimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore Punëtori me nxënës me probleme psikosociale; nga familje jofunksionale; me sjellje agresive, zhvillimi i interesit për vetëvëzhgim dhe njohjen e ndjenjave dhe nevojave personale Referat: „13 Nëntori“ - çlirimi i Shkupit Prezantime dhe analizë e materialeve vizuale të lidhura me 13 Nëntorin Vizita në SHA Fershped me nxënësit Punë për zhvillimin e tolerancës, mirëkuptimit ndërmjet të rinjve dhe përmirësimin e vlerave morale dhe humane Prezantimi i projekteve të përgatitura nga nxënësit Këshillimi i prindërve Mentorimi i kuadrit mësimor	Të gjithë mësimdhënësit dhe Shërbimi profesional S. Belinska Andov – në vazhdimësi V. Kralevska, K. Kasapi mësimdhënës i AQ Igor Ivanoviq Teuta Daci – në vazhdimësi Halime D. Horuni Elena Petrovska V. Kralevska
DHJETOR	***Realizuesi***
Përgatitja e prezantimeve për figura historike dhe ngjarje të rëndësishme Shoqëria – kujdes dhe kultivim	Kastriot Kasapi Teuta Daci – në vazhdimësi mësimdhënës i AQ, V. Kralevska

- të shërbejë gjithmonë si shembull me pamjen dhe sjelljen e tij dhe të ndërtojë kulturë dhe shprehi estetike te nxënësit;
- të kujdeset për figurën e vet morale;
- të ketë qëndrim të përgjegjshëm ndaj mjeteve dhe kushteve në të cilat ose me të cilat e realizon veprimtarinë e vet;
- të jetë person të cilit mund t'i besohet, me çiltërsinë, autoritetin, kolegjialitetin, taktin, humanizmin dhe mirëkuptimin ndaj të tjerëve, dhe që në shkollë dhe në mjedisin më të gjerë gëzon reputacion si punonjës dhe si njeri;
- të punojë vazhdimisht në përsosjen e vet profesionale-pedagogjike përmes përdorimit të literaturës profesionale, pjesëmarrjes aktive në seminare, shkëmbimit të përvojave me kolegët etj.

Çdo mësimdhënës, si profesionist i një fushe të caktuar, përfaqësues i një shkence të caktuar në shkollë dhe në bashkësinë më të gjerë dhe përgjegjës për krijimin e potencialit intelektual dhe orientimit etik, duhet:

- ta mobilizojë të gjithë potencialin dhe angazhimin e vet për afirmimin e lëndës së tij, përmes zhvillimit te nxënësit të ndjenjës së pasurimit me njohuri të reja dhe nxitjes së respektit për lëndën te kolegët, prindërit dhe publiku më i gjerë;
- ta popullarizojë lëndën e tij edhe jashtë shkollës, përmes pjesëmarrjes në tribuna publike, shkrimit të artikujve, punimeve profesionale, librave e të ngjashme;
- të ketë qëndrim kritik ndaj teorive, ideve dhe ideologjive joshkencore, si dhe ndaj bartësve të tyre;
- të iniciojë dhe të angazhohet në hulumtime dhe projekte zhvillimore dhe të tjera, brenda dhe jashtë shkollës.

3. Detyrat e mësimdhënësit lidhur me organizimin e orës mësimore

Gjatë kryerjes së punës së vet, mësimdhënësi:

- duhet ta fillojë orën me kohë; çdo vonesë e evidentuar dhe e paarsyetuar sanksionohet;
- ta evidentojë rregullisht orën, si dhe nxënësit që mungojnë;
- të mos lejojë prishjen e punës së planifikuar gjatë orës me njoftime, biseda dhe vizita;
- ta planifikojë mirë çdo orë mësimore, për të mundësuar atmosferë pune pozitive, nxitëse, të çlirët dhe të përzemërt dhe angazhimin e të gjithë nxënësve për arritjen maksimale të qëllimit të përcaktuar deri në fund të orës;
- ta realizojë orën sipas teknologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, me përfshirje dhe udhëheqje të shkathët të nxënësve, mësimdhënie cilësore dhe organizim racional të mësimit.
- duhet t'u tregojë nxënësve që pajisjet telefonike t'i vendosin në regjim pa zë dhe t'i lënë në vendin përkatës të dedikuar për telefonat, me qëllim sigurimin e zhvillimit të pandërprerë të procesit edukativo-arsimor, ruajtjen e disiplinës dhe përmirësimin e përqendrimit të nxënësve

gjatë orëve mësimore. Përjashtim do të jetë vetëm përdorimi i arsyeshëm i pajisjeve telefonike nëse mësimdhënësi e ka planifikuar përdorimin e tyre gjatë orës për qëllime arsimore.

4. Mësimdhënësi, përkatësisht punonjësi profesional dhe nxënësi

Mësimdhënësi, përkatësisht punonjësi profesional, ndaj nxënësve sillet si ndaj subjekteve dhe bashkëpunëtorëve, duke zbatuar procedura në frymën e normave bashkëkohore pedagogjike, me ç'rast:

- respekton personalitetin e çdo nxënësi;
- sillet në mënyrë profesionale dhe të ndershme ndaj çdo nxënësi dhe është i drejtë e human, objektiv e i paanshëm, i matur dhe konsekuent, pavarësisht nga mosha, gjinia, feja, kombësia, raca dhe pozita shoqërore-ekonomike;
- në komunikimin me nxënësit shmang stilin dhe shfaqjet e papërshtatshme për profesionin që ushtron;
- beson se çdo nxënës mund të mësojë dhe është i obliguar t'ia mundësojë këtë secilit nxënës;
- nuk guxon të ketë qasje dogmatike ndaj përmbajtjeve mësimore dhe gjithmonë nxit pavarësinë, mendimin kritik dhe individualitetin e nxënësit përmes metodave të mësimdhënies aktive;
- përdor metoda të ndryshme mësimdhënieje në përputhje me njësinë metodike, me qëllim që nxënësit t'i aftësojë për të nxënë të pavarur;
- njohuritë e nxënësit i vlerëson realisht sipas kritereve të ndërtuara, duke u përpjekur të përcaktojë shkallën e njohurive të nxënësit, e jo të kërkojë mangësi ose mosdije, dhe njëkohësisht e informon rregullisht nxënësin;
- kërkon nga nxënësi që detyrat e veta t'i kryejë me kohë dhe me cilësi;
- nuk guxon t'i nënçmojë dhe fyejë nxënësit;
- ndaj nxënësve nuk guxon të shfaqë agresivitet, jotolerancë, dëshirë për dominim, frikë, apati, depresion, vetëbesim të sëmurë, ambicie të tepruar, dobësim të mekanizmave pozitivë të sjelljes e të ngjashme;
- asnjëherë nuk e ndëshkon nxënësin fizikisht, nuk e keqtrajton psikikisht dhe nuk përdor frikësim, shantazh, kërcënime ose forma të tjera të sjelljes negative;
- zgjedh dhe udhëheq aktivitet jashtëmësimor në të cilin e konsideron veten më krijues dhe përmes të cilit do t'u mundësojë nxënësve t'i plotësojnë interesat dhe t'i zhvillojnë talentet e tyre;
- njeh kushtet shoqërore-ekonomike dhe kushtet e tjera në të cilat nxënësit jetojnë dhe mësojnë;
- është i obliguar t'u ndihmojë rregullisht nxënësve që ngecin në përvetësimin e mësimit;
- nga nxënësit kërkon sjellje të rregullt, të denjë dhe të disiplinuar dhe ndaj çdo lloj sjelljeje devijuese reagon me vërejtje;
- është i obliguar ta dëgjojë çdo nxënës kur i drejtohet për ndihmë në zgjidhjen e problemeve personale dhe ta ndihmojë ose ta udhëzojë për ndihmë profesionale te persona kompetentë brenda ose jashtë shkollës;
- në punën me nxënësit nuk i shpreh bindjet dhe përcaktimet e veta politike dhe nuk lejon propagandimin e ideologjive të ngushta politike ose partikulariste (të natyrës politike, nacionaliste, fetare apo tjetër);
- me shembullin personal dhe me të gjitha mjetet lufton kundër shkaktarëve të varësive dhe dukurive të tjera negative - drogës, alkoolit, pirjes së duhanit, kriminalitetit etj.;
- ndërmjet nxënësve ndërton vazhdimisht marrëdhënie shoqërore, mirëkuptim të ndërsjellë, bashkëpunim dhe respekt.

5. Mësimdhënësi, punonjësi profesional dhe prindi

Mësimdhënësi, përkatësisht punonjësi profesional, është në komunikim të vazhdueshëm me prindërit, me ç'rast:

- kujdeset që bashkëpunimi me prindërit të jetë sa më i drejtpërdrejtë dhe efikas;
- nxit interesimin dhe angazhimin e prindërve në zgjidhjen e problemeve me nxënësit;
- për çështjet e jetës personale dhe familjare ruan diskrecion të plotë;
- me vëmendje dhe përgjegjësi të plotë, si dhe me takt pedagogjik dhe kulturor, sillet ndaj atyre prindërve që nuk tregojnë interes të nevojshëm për bashkëpunim dhe kujdesen pamjaftueshëm për sjelljen e fëmijëve të tyre;
- i informon prindërit në kohë dhe në mënyrë objektive;
- i respekton argumentet e prindërve;

- kërkon bashkëpunimin dhe angazhimin e prindërve në zgjidhjen e problemeve;
- udhëzon për ndihmë te persona dhe institucione kompetente kur vetë nuk është në gjendje të ndihmojë.

6. Marrëdhënia e ndërsjellë e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë

Për formimin efikas edukativo-arsimor të nxënësve, si dhe në interes të reputacionit dhe dinjitetit të profesionit dhe shkollës, mësimdhënësi, përkatësisht punonjësi profesional, është i obliguar të kujdeset dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve pozitive, profesionale dhe korrekte me kolegët e vet, me ç'rast:

- marrëdhënia ndërmjet mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë është rreptësisht profesionale, me qëllim sigurimin e kreativitetit dhe punës konstruktive;
- bashkëpunimin e ndërsjellë e bazon në marrëveshje, shkëmbim përvojash, vendimmarrje dhe kryerje të ndërgjegjshme e efikase të detyrave të dakorduara;
- i respekton dhe zbaton qëndrimet dhe vendimet e shumicës, të formuara mbi bazën e lirisë dhe diskutimit publik;
- është solidar me kolegun e tij, veçanërisht kur bëhet fjalë për zgjidhjen e problemeve sociale dhe shëndetësore;
- i ndihmon kolegët e rinj duke u përcjellë përvojën dhe njohuritë e veta pedagogjike dhe profesionale.

7. Mësimdhënësi, përkatësisht punonjësi profesional dhe shkolla

Mësimdhënësi dhe punonjësi profesional, gjatë kohës që ndodhen në shkollë, janë në detyrë gjatë gjithë kohës dhe kudo, me ç'rast obligohen:

- ta respektojnë orarin e punës dhe kohëzgjatjen e orës mësimore;
- ta evidentojnë vetë praninë dhe largimin e tyre nga hapësirat e shkollës përmes evidencës elektronike;
- ta përdorin në mënyrë të arsyeshme pajisjen telefonike vetëm nëse e kanë planifikuar përdorimin e saj në orën mësimore për qëllime arsimore.
- të punësuarit janë të obliguar ta respektojnë orarin e tyre të punës në përputhje me udhëzimet e eprorit;
- mësimdhënësit janë të obliguar të jenë në vendin e punës së paku 10 minuta para fillimit të orës, që të kenë kohë ta përgatisin orën dhe ta fillojnë me kohë;
- të punësuarit vijnë në punë me veshje të pastër dhe të rregullt;
- nuk lejohet veshje e pahijshme dhe provokuese;
- të punësuarave femra u ndalohet veshja transparente, modelet me rripa, modelet që theksojnë dhe nuk mbulojnë gjoksin, minifundet dhe fundet më të shkurtra se 5 cm mbi gjunjë, si dhe veshjet me mbishkrime dhe aplikime të pahijshme;
- të punësuarve meshkuj u ndalohet veshja transparente, bluzat me rripa, çfarëdo modeli pantallonash të shkurtra, si dhe veshjet me mbishkrime dhe aplikime të pahijshme;
- mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë janë të obliguar të kujdesen për të gjithë hapësirën dhe pronën e shkollës, veçanërisht për kabinetin në të cilin realizojnë mësimdhënien.

8. Mësimdhënësi, përkatësisht punonjësi profesional dhe bashkësia shoqërore

Në kushtet bashkëkohore demokratike dhe pluraliste, mësimdhënësi, përkatësisht punonjësi profesional, udhëhiqet ekskluzivisht nga përcaktimet kushtetuese dhe ligjore, me ç'rast:

- e pranon plotësisht dhe pa rezervë realitetin dhe orientimin shoqëror-demokratik të Republikës së Maqedonisë së Veriut si shtet i pavarur dhe sovran dhe si shtet i përbashkët i të gjithë qytetarëve të saj;
- duhet të jetë qytetar besnik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ta ruajë reputacionin dhe autoritetin e saj, të kujdeset për prosperitetin, integritetin dhe sovranitetin e saj dhe të kontribuojë në formimin e nxënësve në frymën e jetës së përbashkët dhe konstruktive, pavarësisht nga përkatësia kombëtare, fetare ose tjetër;
- i përmbahet standardeve, marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut, veçanërisht Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës;
- ka të drejtë dhe detyrë të angazhohet dhe të luftojë për dinjitetin e profesionit të punonjësit arsimor;
- angazhohet dhe lufton për pozitë të denjë materiale të institucioneve arsimore, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të tyre si kusht themelor për organizimin cilësor të procesit edukativ;

- angazhohet dhe lufton për status material të përshtatshëm të profesionit dhe shpërblimin e punës së tij, që do t'i mundësojë t'i përkushtohet plotësisht kryerjes cilësore, profesionale dhe të përgjegjshme të detyrave të punës.

9. Dispozita përfundimtare

Çdo mësimdhënës, përkatësisht punonjës profesional, obligohet ta respektojë dhe zbatojë këtë Kod. Për mosrespektimin dhe moszbatimin e Kodit përgjigjet personalisht shkelësi.

SHËNIM:

Me këtë Kod përfshihen kërkesat dhe parimet themelore që përcaktojnë sjelljen profesionale-etike të mësimdhënësve dhe punonjësve profesionalë. Këto kërkesa dhe parime mund të plotësohen, zgjerohen dhe përsosen.

B) Kodi i sjelljes së nxënësve në QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup

Në shkollë, si institucion edukativo-arsimor, marrin pjesë nxënësi, mësimdhënësi dhe të gjithë faktorët e tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, ndërveprimi i të cilëve mundëson realizimin e procesit edukativo-arsimor.

Në shkollë, çdo nxënësi duhet t'i sigurohen kushte për përvetësimin e të vërtetave shkencore që do të bëhen pjesë e vetëdijes dhe bindjeve të tij dhe do të jenë motive për veprimin e tij praktik.

Nxënësi në mjedisin shkollor paraqet subjekt që ka vendin dhe rolin e vet të veçantë, të drejtat e veta, por edhe obligime dhe detyra që duhet t'i realizojë.

Nxënësit duhet t'i mundësohet që edhe në shkollë t'i zhvillojë drejt të gjithë përbërësit e personalitetit të tij:

- anën intelektuale - të zhvillojë aftësitë mendore për ndjeshmëri, perceptim, vëmendje, të nxënë, kujtesë, të menduar etj.;
- anën fizike dhe shëndetësore - të rritet dhe ta formojë trupin në mënyrë të drejtë dhe ta ruajë shëndetin nga të gjitha ndikimet dhe veset negative: droga, alkooli, cigaret, barnat e rrezikshme etj.;
- përbërësin moral - të zhvillojë vetëdijen morale, ndjenjat morale dhe vlerat morale përmes mësimdhënies, të nxënit dhe aktiviteteve të tjera jashtëmësimore, si mjete themelore të edukimit moral;
- përbërësin funksional - të zhvillojë dhe përsosë aftësitë për punë, të formojë shprehi pune dhe disiplinë pune dhe të aftësohet për kryerjen e detyrave të punës në mjedisin shoqëror;
- përbërësin estetik - përmes mësimdhënies dhe aktiviteteve jashtëmësimore të zhvillojë aftësinë për ta zbuluar të bukurën dhe të krijojë ndjenjë dhe aftësi për krijimtari estetike.

Personaliteti i çdo nxënësi gjatë zhvillimit të tij duhet të respektohet pavarësisht dallimeve në aftësi, gjini, përkatësi fetare, kombësi, pozitë materiale dhe sociale etj.

Çdo nxënës obligohet t'i respektojë rregullat e këtij Kodi.

Për mosrespektimin e këtyre rregullave të sjelljes përgjigjen shkelësit, ndaj të cilëve mund të ndërmerren masat përkatëse pedagogjike të parapara me Statutin e shkollës.

RREGULLAT E SHKOLLËS

Nxënësit që janë regjistruar në QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup obligohen ta respektojnë këtë Kod të sjelljes së nxënësve.

Mësimi në QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup zhvillohet në dy ndërrime: orët në ndërrimin e parë fillojnë në orën 7:30, ndërsa orët në ndërrimin e dytë fillojnë në orën 13:30.

Nxënësit hyjnë në shkollë nga hyrja e dedikuar për nxënësit, ndërsa hyrja kryesore është vetëm për të punësuarit dhe personat që janë në vizitë zyrtare në shkollë.

Nxënësit janë të obliguar të vijnë në shkollë së paku 5 minuta para fillimit të orës, që të kenë kohë të përgatiten për të.

Nxënësit hyjnë në shkollë pa bërë zhurmë, pa vrapuar ose pa e prishur qetësinë e shkollës në mënyrë tjetër.

Ora mësimore në QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup zgjat 45 minuta në ndërrimin e parë dhe 40 minuta në ndërrimin e dytë.

Pushimi i madh për nxënësit është pas orës së dytë dhe pas orës së katërt.

Gjatë pushimit të madh nxënësit janë të obliguar ta lëshojnë klasën për ajrosjen e saj.

Ndalohet qëndrimi në korridore, si dhe bërja e zhurmës, thirrja nga dritaret ose hedhja e sendeve nga dritarja.

Nxënësit paralajmërohen të mos sjellin në shkollë sende me vlerë më të madhe, sepse shkolla nuk mban përgjegjësi për humbjen e tyre.

QËNDRIMI I NXËNËSIT NDAJ MËSIMIT

Nxënësve u ndalohet të sjellin në shkollë cigare, alkool, drogë ose substanca të tjera psikotrope, si dhe lloje të ndryshme sendesh të rrezikshme ose armë.

Nuk lejohet hyrja e nxënësve dhe personave që janë nën ndikimin e alkoolit ose të ndonjë substance tjetër psikotrope.

Nxënësit obligohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, t'i kryejnë detyrat e punës me disiplinë dhe vëmendje, si dhe të përpiqen ta përvetësojnë plotësisht materialin mësimor.

Nxënësi vjen në shkollë i pastër, i rregullt dhe i veshur në mënyrë jo të ekzagjeruar. Nxënësi është i obliguar ta mirëmbajë rregullisht higjienën personale.

Nxënësi është i obliguar t'i marrë me maturi vendimet për reagimet dhe veprimet e veta dhe mban përgjegjësi për to.

Përmes të nxënit, nxënësi aftësohet që në mënyrë të drejtë të ndiejë, të njohë, të mendojë, të dallojë të ngjashmen nga e ndryshmja dhe thelbësoren nga jothelbësorja, si dhe të formojë shprehi dhe aftësi pune.

QËNDRIMI I NXËNËSIT GJATË ORËS MËSIMORE

Gjatë mësimit nxënësit ulen në vendet që u janë caktuar nga kujdestari i klasës ose mësimdhënësi i lëndës.

Nuk lejohet ndërrimi i vendeve me vetëdëshirë.

Nxënësit vijnë me kohë në mësim, të pajisur me mjetet e nevojshme për punë (libra, fletore, laps, stilolaps, vizore etj.) për atë orë mësimore.

Nxënësi që mungon me arsye nga mësimi është i obliguar ta arsyetojë mungesën me vërtetim mjekësor të verifikuar.

Nxënësi me sjelljen e tij nuk guxon ta pengojë punën gjatë orës mësimore (me biseda, të qeshura, krijim të situatave konfliktuoze etj.).

Nxënësit kanë të drejtë t'i kërkojnë mësimdhënësit të lëndës shpjegim, ndihmë ose këshillë lidhur me të nxënit.

Nxënësit kanë të drejtë të mbajnë pajisje telefonike, por gjatë orës mësimore ato duhet të vendosen në regjim pa zë dhe të lihen në vendin përkatës të dedikuar për telefonat.

Përjashtim do të jetë vetëm përdorimi i arsyeshëm i pajisjeve telefonike nëse mësimdhënësi e ka planifikuar përdorimin e tyre gjatë orës për qëllime arsimore.

Gjatë testeve, punimeve me shkrim dhe formave të tjera të kontrollimit të njohurive, pajisjet telefonike duhet të vendosen në regjim pa zë dhe të lihen në vendin e caktuar nga mësimdhënësi.

Nxënësit informohen përmes tabelës së njoftimeve. Ndalohet vendosja me vetëdëshirë e njoftimeve, afisheve ose posterëve në tabelën e shkollës.

QËNDRIMI I NXËNËSIT NDAJ NXËNËSVE TË TJERË

Qëndrimi i nxënësit ndaj nxënësve të tjerë realizohet përmes formave të ndryshme të shprehjes, me ç'rast ndërtohen autoriteti dhe identiteti i nxënësit dhe, njëkohësisht, krijohet klimë pozitive gjatë orës mësimore dhe në shkollë.

Marrëdhënia ndërmjet nxënësve duhet të bazohet në parimin e shoqërisë së sinqertë, miqësisë, respektit të ndërsjellë dhe sjelljes së kulturuar.

Të gjitha mosmarrëveshjet e krijuara duhet të zgjidhen në mënyrë paqësore menjëherë pas situatës konfliktuoze; në të kundërtën, pjesëmarrësit duhet të dërgohen për bisedë te pedagogu i shkollës.

QËNDRIMI I NXËNËSIT NDAJ MËSIMDHËNËSIT

Mësimdhënësi e udhëheq orën, por njëkohësisht bashkëpunon me nxënësit në krijimin e orës mësimore dhe mësimdhënies në përgjithësi.

Përmes marrëdhënies së nxënësit me mësimdhënësin ndikohet në krijimin e atmosferës së punës gjatë orës, si dhe në zhvillimin psikofizik, me ç'rast çdo nxënës duhet ta respektojë personalitetin e mësimdhënësit dhe detyrat e dhëna nga mësimdhënësi t'i kryejë me përgjegjësi, ndërgjegje dhe në kohë.

Çdo vërejtje e mësimdhënësit për dobësitë e konstatuara te nxënësi duhet të kuptohet si dashamirëse dhe pa qëllim të keq.

QËNDRIMI I NXËNËSIT NDAJ PRONËS SË SHKOLLËS

Shkolla krijon kushte optimale për realizimin e mësimdhënies.

Çdo nxënës është i obliguar të kujdeset dhe ta ruajë pronën e shkollës, sepse inventari është një nga kushtet nga të cilat varet përparimi në të nxënë.

Çdo nxënës është i obliguar ta mirëmbajë higjienën në klasë dhe në të gjithë shkollën.

Të mos hedhë mbeturina jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e tyre.

Për mbrojtjen e pronës së shkollës, si dhe për ruajtjen e rendit dhe disiplinës në shkollë, korridoret janë nën mbikëqyrje me video 24 orë.

Do të sanksionohet rreptësisht çdo nxënës për të cilin vërtetohet ose kapet duke dëmtuar ose përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme pronën e shkollës.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky Kod i sjelljes është dokument detyrues për të gjithë nxënësit që janë regjistruar në QSHA „Boro Petrushevski“ - Shkup.

Shkelja e dispozitave të këtij Kodi i nënshtrohet sanksionimit në përputhje me masat pedagogjike të përcaktuara në Ligjin për arsimin e mesëm.

C) Kodi i sjelljes së nëpunësve administrativë dhe personelit ndihmës-teknik

Bordi i Shkollës pranë QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit, në bazë të nenit 89-a të Ligjit për arsimin e mesëm („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017, 64/2018 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 229/2020, 269/2023, 78/2025, 132/25 dhe 250/25) dhe nenit 119 të Statutit të QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit, në seancën e 52-të të mbajtur më 26.08.2026, miratoi këtë:

KOD ETIK I SJELLJES SË NËPUNËSVE ADMINISTRATIVË DHE PERSONELIT NDIHMËS-TEKNIK PRANË QSHA „BORO PETRUSHEVSKI“ TË QYTETIT TË SHKUPIT

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Objekti dhe fusha e zbatimit

Neni 1

(1) Me këtë Kod Etik (në tekstin e mëtejmë: Kodi) përcaktohen standardet etike dhe rregullat e sjelljes së të punësuarve në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit dhe të personave të tjerë që kryejnë punë në të.
(2) Ky Kod nuk i zëvendëson rregulloret ekzistuese, por i shtjellon në mënyrë të hollësishme standardet etike dhe rregullat e sjelljes së të punësuarve në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit.

Qëllimi i zbatimit

Neni 2

(1) Qëllimi i këtij Kodi është nxitja e veprimit dhe sjelljes së mirë të të punësuarve, ligjshmërisë, integritetit profesional dhe personal, moralit të lartë dhe përkushtimit, përgjegjësisë personale dhe forcimit të besimit të qytetarëve në punën e QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit, përmes respektimit konsekuent të vlerave etike dhe përfaqësimit të interesit publik.

Zbatimi

Neni 3

(1) Të punësuarit i zbatojnë standardet dhe rregullat etike në marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe në marrëdhëniet me qytetarët, në raport me punën, si dhe në jetën private dhe në publik.

Mosrespektimi

Neni 4

(1) Gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, të punësuarit janë të detyruar t’u përmbahen dispozitave të këtij Kodi.
(2) Për veprim në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara me këtë Kod, të punësuarit përgjigjen disiplinarisht, në përputhje me ligjin.

Ligjshmëria, profesionalizmi, kompetenca profesionale, promovimi i vlerave demokratike dhe i të drejtave sociale, paanshmëria dhe mosdiskriminimi në punë

Neni 5

(1) Të punësuarit në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit, gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës, veprojnë në përputhje me Ligjin për arsimin e mesëm, Ligjin për nëpunësit administrativë, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, Ligjin për marrëdhëniet e punës, Statutin e shkollës, Marrëveshjen kolektive të shkollës dhe Kodin e shkollës.
(2) Të punësuarit janë të detyruar ta kryejnë punën në mënyrë të ligjshme, profesionale, të ndërgjegjshme, të ndershme, në kohë, efikase dhe me përgjegjësi, duke përdorur kompetencat e tyre të punës, njohuritë dhe shkathtësitë më të mira, në përputhje me rregullat.
(3) Të punësuarit synojnë përsosjen e tyre dhe forcimin e kompetencave të punës, i zbatojnë njohuritë e reja dhe avancohen profesionalisht për përparim personal dhe institucional.

(4) Gjatë punës dhe me sjelljen e tyre, të punësuarit promovojnë vlerat demokratike dhe sundimin e ligjit, duke respektuar parimet e humanizmit, barazisë dhe drejtësisë sociale.
(5) Gjatë veprimit në çështje konkrete dhe marrjes së akteve e vendimeve konkrete, të punësuarit nuk do të udhëhiqen nga vlerësim i gabuar ose i paarsyeshëm i gjendjes faktike për shkak të paragjykimeve, përfitimit personal ose ambicies, konfliktit të interesit, presioneve apo kërcënimeve nga eprori ose ndonjë person tjetër.
(6) Të punësuarit vendosin dhe veprojnë në mënyrë të paanshme, pa asnjë ndikim të brendshëm ose të jashtëm, vetëm mbi bazën e fakteve dhe rrethanave të përcaktuara drejt, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera të miratuara në bazë të ligjit.
(7) Në punën e tyre dhe gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, të punësuarit trajtojnë në mënyrë të barabartë personat fizikë dhe juridikë, duke u kujdesur për realizimin e të drejtave të tyre në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera të miratuara në bazë të ligjit.
(8) Në punën e tyre, të punësuarit mundësojnë realizimin e të drejtave kushtetuese për barazi dhe mosdiskriminim, përmes krijimit të mundësive të barabarta dhe respektimit të dallimeve, si dhe mbrojtjes nga padrejtësia, keqpërdorimi dhe diskriminimi mbi çfarëdo baze.
(9) Të punësuarit sigurojnë qasje, trajtim dhe standarde të barabarta gjatë ofrimit të shërbimeve, trajtimit të kërkesave të qytetarëve dhe marrjes së vendimeve.

Paanshmëria dhe neutraliteti politik

Neni 6

(1) Të punësuarit i kryejnë punët dhe detyrat e punës në mënyrë politikisht neutrale.
(2) Të punësuarit nuk e përfaqësojnë dhe nuk e shprehin bindjen e tyre politike gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe kontakteve zyrtare.
(3) Gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, të punësuarit nuk i përfaqësojnë dhe nuk i shprehin bindjet e tyre politike dhe nuk kryejnë aktivitete partiake politike.

Integriteti profesional

Neni 7

(1) Të punësuarit e ruajnë reputacionin personal dhe reputacionin e QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit, i eliminojnë rreziqet dhe dyshimet për mundësinë e shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe, në këtë mënyrë, sigurojnë besimin e qytetarëve në punën e QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit.

Përfaqësimi i interesit publik

Neni 8

(1) Në punën e tyre, të punësuarit i përkushtohen ekskluzivisht interesit publik dhe të mirës së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qytetarëve të saj.
(2) Të punësuarit nuk e vendosin veten në gjendje konflikti ndërmjet interesave personale dhe interesit publik dhe kundërshtojnë çdo sjellje të pandershme dhe të pandërgjegjshme në shërbim.
(3) Në punën e tyre, të punësuarit përfaqësojnë në mënyrë të paanshme interesin publik, përkatësisht të drejtat dhe interesat e të gjithë qytetarëve dhe subjekteve të tjera, duke marrë parasysh qëllimet zhvillimore të shoqërisë.

Veprimi në përputhje me autorizimet dhe statusin, si dhe parandalimi i korrupsionit dhe konfliktit të interesave

Neni 9

(1) Të punësuarit nuk i shfrytëzojnë përparësitë që burojnë nga statusi i tyre, as të dhënat dhe informacionet që i kanë marrë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, për realizimin e përfitimit personal.
(2) Të punësuarit nuk duhet, me vetëdije dhe qëllimisht, ta vënë në lajthitje publikun ose të punësuarit e tjerë në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit.
(3) Në komunikimin zyrtar ose privat me persona fizikë ose juridikë, të punësuarit nuk duhet të krijojnë ose të paraqesin pretendime të rreme lidhur me pozitën, statusin dhe autorizimet e tyre zyrtare.
(4) Të punësuarit nuk guxojnë t'i përdorin autorizimet dhe statusin për qëllime private dhe për përfitim personal ose për përfitimin e të afërmve, miqve apo personave juridikë.
(5) I punësuari nuk guxon ta përdorë në mënyrë të papërshtatshme autoritetin, të kërkojë, nxisë, detyrojë ose drejtojë një të punësuar tjetër që gjatë orarit të punës të kryejë aktivitete të tjera, përveç aktiviteteve që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave zyrtare ose për të cilat është i autorizuar me ligj dhe rregullore të tjera pozitive.

(6) Të punësuarit nuk e tolerojnë korrupsionin dhe, në përputhje me ligjin, raportojnë dhënien, ofrimin ose premtimin e ryshfetit, shpërblimit, dhuratës ose ndonjë përfitimi tjetër, si dhe veprimin e kundërligjshëm ose ndikimin e kundërligjshëm.
(7) Të punësuarit nuk marrin pjesë në proceset e autorizimit dhe të marrjes së vendimeve në të cilat ata ose anëtarë të familjes së tyre, të afërm të tjerë, miq, bashkëpunëtorë apo persona të tjerë që mund të lidhen me ta kanë interes financiar.

Ndalimi i pranimit të dhuratave dhe llojeve të tjera të përfitimit

Neni 10

(1) Të punësuarit në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit nuk guxojnë të kërkojnë apo të pranojnë dhurata, shërbime, ndihmë ose çfarëdo përfitimi tjetër që mund të ndikojë në veprimin në përputhje me ligjin dhe dispozitat e këtij Kodi, as të lejojnë që një person tjetër, në emër të tyre ose për përfitimin apo llogarinë e tyre, të kërkojë ose të pranojë përfitime, shpërblime, kompensime apo dhurata nga çfarëdo burimi, pavarësisht nëse janë në formë financiare ose jofinanciare.
(2) Të punësuarit nuk pranojnë dhurata ose falënderime në formë materiale apo financiare që mund të konsiderohen shpërblim për punën e kryer, kryerja e së cilës është detyrë e tyre e punës.
(3) Të punësuarit nuk guxojnë ta përdorin statusin ose autorizimin zyrtar duke u dhënë privilegje personave të tretë kundrejt kompensimit, për realizimin e përfitimit pasuror për veten ose dikë tjetër, apo për t'i shkaktuar dëm një personi tjetër.
(4) Të punësuarit të cilëve u ofrohet dhuratë ose ndonjë përfitim tjetër i lidhur drejtpërdrejt me punën që kryejnë në vendin e punës janë të detyruar ta refuzojnë ofertën e tillë dhe, pa vonesë, ta raportojnë te eprori i tyre i drejtpërdrejtë.
(5) Pranimi i një përfitimi, shpërblimi, kompensimi ose dhurate të palejuar paraqet shkelje të dispozitave të këtij Kodi dhe për të parashikohet përgjegjësi disiplinore në përputhje me ligjin.

Veprimi me informacionet

Neni 11

(1) Të punësuarit janë të detyruar të sigurojnë konfidencialitetin e nevojshëm dhe mbrojtjen e informacioneve që i kanë mësuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ose si rezultat i pozitës dhe statusit zyrtar.
(2) Të punësuarit nuk kërkojnë të dhëna konfidenciale që nuk janë relevante për detyrat e tyre.
(3) Të punësuarit nuk publikojnë dhe nuk zbulojnë informacione për të cilat nuk kanë autorizim.
(4) Të punësuarit sigurojnë mbrojtjen e informacioneve edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit.
(5) Gjatë punës dhe kryerjes së detyrës zyrtare, të punësuarit kujdesen që të mos cenojnë të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Mbrojtja dhe përdorimi efikas e ekonomik i mjeteve zyrtare

Neni 12

(1) Të punësuarit sigurojnë përdorimin dhe menaxhimin maksimalisht efikas dhe ekonomik të mjeteve materiale, pajisjeve dhe sendeve që u janë besuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe parandalojnë përdorimin dhe disponimin e tyre të paligjshëm.

Sjellja me palët

Neni 13

(1) Në marrëdhëniet me qytetarët, të punësuarit janë korrektë, të sjellshëm, të mirësjellshëm dhe të qasshëm.
(2) Në marrëdhëniet me qytetarët, si dhe gjatë përgjigjes ndaj korrespondencës, përmes telefonit ose në rrugë elektronike, të punësuarit përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve sa më plotësisht dhe saktë, me shpjegim të qartë ose kështillim, me ton të qetë dhe respektin e duhur, duke pasur parasysh se qytetarët drejtohen për realizimin e të drejtave, detyrimeve dhe interesave të tyre.
(3) Të punësuarit u qasen hapur dhe seriozisht propozimeve të marra nga palët dhe i dëgjojnë me durim të gjitha vërejtjet, kritikat dhe problemet e paraqitura prej tyre; nëse palët nuk janë të kënaqura me përgjigjen, kërkojnë ndërmjetësimin e eprorit të drejtpërdrejtë ose ia përcjellin dhe drejtojnë mesazhin atij.

Sjellja e të punësuarve në vendin e punës, në jetën private dhe në publik

Neni 14

(1) Të punësuarit sillen me mirësjellje ndërmjet tyre, ndaj institucioneve të tjera dhe ndaj personave të tjerë me të cilët vijnë në kontakt gjatë kryerjes së punës.
(2) Pa penguar realizimin e të drejtës për të formuar qëndrim personal dhe për të shprehur publikisht mendimin, të punësuarit përmbahen nga dhënia e deklaratave që mund t'i dëmtojnë shërbimin.
(3) Në jetën private dhe në publik, të punësuarit sillen me dinjitet dhe nuk veprojnë në mënyrë që të dëmtohet reputacioni personal dhe reputacioni i QSHA „Boro Petrushevski" të Qytetit të Shkupit.
(4) Me sjelljen dhe veprimet e tyre jashtë punës, gjatë paraqitjeve në ngjarje publike, në rrjetet sociale ose në çfarëdo forme tjetër komunikimi, të punësuarit paraqesin shembull të sjelljes së përshtatshme dhe dinjitoze.
(5) Të punësuarit zhvillojnë biseda telefonike zyrtare të shkurtra dhe koncize, ndërsa bisedat private telefonike nuk i zhvillojnë në prani të palëve, kur palët presin përgjigje ose kur synojnë të parashtrojnë pyetje.

Sjellja me kolegët

Neni 15

(1) Të punësuarit sillen dhe veprojnë profesionalisht gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.
(2) Në marrëdhëniet me kolegët, të punësuarit kultivojnë frymën dhe parimet e punës ekipore, respektin e ndërsjellë, vlerësimin e dallimeve, solidaritetin dhe bashkëpunimin. Në komunikim me kolegët nuk e ngrenë zërin, nuk fyejnë, shmangin situatat konfliktuale dhe tregojnë iniciativë për parandalimin e tyre.

Sjellja me eprorët

Neni 16

(1) Të punësuarit nuk do të refuzojnë kryerjen e detyrave të punës ose urdhrat e eprorit, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.
(2) Përveç rasteve kur ka arsye të justifikuara, të punësuarit nuk e shtyjnë kryerjen e detyrave të punës dhe nuk ua besojnë të punësuarve të tjerë kryerjen e detyrave të veta ose marrjen e vendimeve që janë përgjegjësi e tyre.
(3) Gjatë kryerjes së detyrave të punës, të punësuarit respektojnë rendin kronologjik të pranimit dhe karakterin urgjent të punëve dhe detyrimeve.

Kujdesi për reputacionin e institucionit

Neni 17

(1) Të punësuarit përmbahen nga dhënia e deklaratave publike që janë të dëmshme për reputacionin e QSHA „Boro Petrushevski" të Qytetit të Shkupit.
(2) Gjatë ushtrimit të autorizimeve dhe detyrave zyrtare, të punësuarit gjithmonë duhet të veprojnë në shërbim të interesit publik, duke përjashtuar interesat e tyre private.

Veshja e përshtatshme

Neni 18

(1) Të punësuarit i kushtojnë vëmendje pamjes dhe mënyrës së veshjes, në mënyrë që të mos krijojnë përshtypje të pahijshme dhe të mos cenojnë reputacionin e QSHA „Boro Petrushevski" të Qytetit të Shkupit. Me mënyrën formale të veshjes shprehin respekt ndaj shërbimit.

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19

(1) Ky Kod hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe duhet të publikohet në tabelën e shpalljeve të QSHA „Boro Petrushevski" të Qytetit të Shkupit.

D) Plani i masave, aktiviteteve dhe përgjegjësive me të cilat sigurohet mjedis i sigurt, profesional dhe i disiplinuar

Aktiviteti / Masa	Qëllimi / Dedikimi	Grupi i synuar	Korniza kohore	Personi/ekipi përgjegjës	Shënime / Udhëzime shtesë
Trajnim për siguri dhe shëndet në punë dhe Kod profesional	Parandalimi i lëndimeve dhe incidenteve në punëtori dhe kabinete	Të gjithë nxënësit në shkollën profesionale	Java e parë e shtatorit	Mësimdhënësi t e mësimit praktik, udhëheqësi i punëtorisë	Nxënësit nënshkruajnë deklaratë se janë njohur me masat për siguri dhe shëndet në punë.
Monitorimi i mësimit praktik te punëdhënësit	Kontrolli i disiplinës dhe vijueshmërisë jashtë shkollës	Nxënësit në arsimin dual / praktik	Në vazhdimësi gjatë vitit	Mësimdhënësi t-koordinatorë të mësimit praktik	Komunikim i rregullt telefonik dhe në terren me mentorët nga kompanitë.
Kontrolli i vijueshmërisë (parandalimi i ikjes nga orët)	Zvogëlimi i numrit të mungesave të paarsyeshme	Nxënësit	Çdo ditë (pas çdo bllok-ore)	Kujdestarët e klasave, mësimdhënësi t e lëndëve	Njoftim automatik i prindërve përmes e-Ditarit për mungesat e bëra.
Mbikëqyrja e zonave specifike (Punëtoritë/Parking u)	Ruajtja e rendit në parking dhe në blloqet për praktikë	Nxënësit	Në fillim, në fund të ndërrimeve dhe gjatë pushimeve	Mësimdhënësi t kujdestarë, personeli teknik, sigurimi	Kontrolli i lëvizjes së automjeteve të nxënësve në parkingun e shkollës.
Takime parandaluese këshilluese për karrierë	Rimotivimi i nxënësve me sjellje destruktive përmes orientimit profesional	Nxënës me rrezik të lartë për mungesë disipline	Sipas nevojës (menjëherë pas shenjave të para të mungesës së disiplinës)	Psikologu, pedagogu, këshilltari i karrierës	Fokus në lidhjen ndërmjet disiplinës shkollore dhe punësimit të ardhshëm.
Evidencë me shkrim për dëmin material	Përdorim i përgjegjshëm i inventarit dhe veglave të shkollës	Të gjithë të punësuarit dhe nxënësit	Menjëherë pas ndodhjes së ngjarjes	Mësimdhënësi kujdestar, përgjegjësi i ndërrimit, drejtori	Përpilohet procesverbal dhe aktivizohet procedura për kompensimin e dëmit nga shkaktari.
Takime urgjente tripalëshe me prindërit	Zgjidhja e shkeljeve të rënda (dhunë, alkool, vandalizëm)	Nxënësit, prindërit	Brenda 24 orëve nga paraqitja	Drejtori, Shërbimi profesional, kujdestari i klasës	Takimi rezulton me Protokoll me shkrim me afate të sakta për korrigjim.

Shtojca 16: Programi për ndjekjen e arritjeve dhe vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2026/2027

1. Përmirësimi i planifikimit të ndjekjes dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve në të gjitha llojet e planifikimeve të punës edukativo-arsimore të shkollës							
Detyrat, aktivitetet	Realizuesit	Grupi i synuar	Burimet	Instrumentet	Ndjekja e informatës kthyese	Korniza kohore	Kriteret e suksesit (treguesit)
Analiza e planifikimeve afatgjata dhe afatshkurtra	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori	Mësimdhënësit	Planifikimet ekzistuese	Lista kontrolli	Analizë dhe raport	Gusht–shtator	Njohuritë e fituara në drejtim të përmirësimit
Përgatitja e programit për ndjekjen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve në kuadër të Programit vjetor të shkollës	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori		Programi vjetor i punës së shkollës		Aktivitetet e realizuara gjatë vitit - raporte, shqyrtime	Gusht	Program cilësor për vlerësim
Përmirësimi i planifikimit të vlerësimit në planifikimet vjetore dhe tematike	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori.	Mësimdhënësit	Planifikime vjetore, tematike, materiale profesionale	Formular për planifikime vjetore dhe tematike	Shqyrtimi i planifikimeve të përgatitura dhe udhëzime për punë	Shtator	Planifikime vjetore dhe tematike cilësore

2. Organizimi i trajnimeve për përmirësimin e ndjekjes dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve							
Detyrat, aktivitetet	Realizuesit	Grupi i synuar	Burimet	Instrumentet	Ndjekja e informatës kthyese	Korniza kohore	Kriteret e suksesit (treguesit)
Përcaktimi i instrumenteve ekzistuese që përdoren në shkollë për ndjekjen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori	Mësimdhënësit	Planifikimet ekzistuese Anketë	Lista kontrolli Fletë anketuese	Analizë dhe raport	Shtator	Njohuritë e fituara në drejtim të përmirësimit
Përgatitja e planit për llojin e trajnimeve dhe mënyrën e realizimit të tyre	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori	Mësimdhënësit	Anketa	Fletë anketuese	Plan i përgatitur	Tetor	Trajnime të realizuara
Organizimi i trajnimeve sipas planit të përgatitur	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori	Mësimdhënësit	Materiale të marra nga trajnimet	Fletë vlerësimi	Analizë dhe raport	Sipas planit të trajnimeve	Instrumente të përmirësuara për ndjekje dhe vlerësim

3. Planifikimi dhe zbatimi i vlerësimit formativ							
Detyrat, aktivitetet	Realizuesit	Grupi i synuar	Burimet	Instrumentet	Ndjekja e informatës kthyese	Korniza kohore	Kriteret e suksesit (treguesit)

Përgatitja e instrumenteve të vlefshme dhe objektive për vlerësimin formativ	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori	Mësimdhënësit	Orë mësimore, përgatitje për orë, instrumente të zbatuara		Analizë dhe raport	Gjatë vitit shkollor	Cilësi e përmirësuar e zbatimit të vlerësimit formativ
Ndjekja e efektit nga zbatimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies, ndjekjes dhe vlerësimit	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori	Mësimdhënësit	Anketa me nxënësit dhe prindërit, analiza të suksesit të nxënësve	Fletë anketuese	Analizë dhe raport	Gjatë vitit shkollor	Efekte pozitive te nxënësit dhe prindërit
Prezantimi i përvojave praktike nga zbatimi i vlerësimit formativ në nivel të aktiveve profesionale	Ekipi për vlerësim, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori	Mësimdhënësit	Orë të realizuara dhe aktivitete projektuese	Materiale të përgatitura nga mësimdhënësit	Procesverbale nga aktivet profesionale	Gjatë vitit shkollor sipas programeve të aktiveve profesionale	Zbatimi i njohurive të fituara në mësim – shkëmbim përvojash

4. Planifikimi dhe zbatimi i vlerësimit përmbledhës							
Detyrat, aktivitetet	Realizuesit	Grupi i synuar	Burimet	Instrumentet	Ndjekja e informatës kthyese	Korniza kohore	Kriteret e suksesit (treguesit)
Sigurimi i informatave për përparimin individual të nxënësve përmes matjes së rezultateve të të nxënit	Ekipi për vlerësim	Mësimdhënësit, nxënësit	Instrumente të zbatuara		Analizë dhe raport	Shtator – nëntor	Njohuritë e fituara në drejtim të përmirësimit
Përgatitja dhe përdorimi i tabelave të specifikimit	Ekipi për vlerësim	Mësimdhënësit	Portofolat e mësimdhënësve	Lista kontrolli	Shqyrtimi i portofolave Lista kontrolli të plotësuara	Në vazhdimësi	Tabela të specifikimit të përgatitura me cilësi
Ndjekja e cilësisë së vlerësimit	Ekipi për vlerësim	Mësimdhënësit		Lista kontrolli	Analizë dhe raport	Në vazhdimësi	Harmonizimi i vlerësimit me standardet

Plani i veprimit për përmirësimin e vlerësimit për vitin 2026/2027

ÇFARË	SI	KUR	ME KË
Planifikimi dhe organizimi, vetëvlerësimi	- Analiza e planifikimeve afatgjata dhe afatshkurtra; - përgatitja e programit për ndjekjen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve në kuadër të Programit vjetor të punës së shkollës; - përmirësimi i planifikimit dhe vlerësimit në planifikimet vjetore dhe tematike; - përgatitja e kritereve të vlerësimit mbi bazën e standardeve sipas lëndëve.	Shtator, tetor	Drejtori, mësimdhënësit e lëndëve, psikologu, pedagogu
Mbështetje	- Takime konsultative lidhur me zbatimin e segmenteve dhe instrumenteve të ndryshme për vlerësim formativ; - Takime konsultative lidhur me zbatimin e segmenteve dhe instrumenteve të ndryshme për vlerësim përmbledhës; - organizimi i punëtorive për përgatitjen e detyrave testuese.	Tetor–maj Dhjetor–maj Nëntor–maj	Drejtori, psikologu, mësimdhënësit, mësimdhënësit përgjegjës për aktivet.
Ndjekja	- Ndjekja e efektit nga zbatimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies /anketë me nxënësit/; - vizita në orë me metoda dhe instrumente të zbatuara për vlerësim formativ; - ndjekja e vlefshmërisë së instrumenteve dhe efektit të informatave kthyese / analizë e pyetjeve nga testet e mësimdhënësve/	Janar–maj	Aktivet profesionale, drejtori, psikologu, pedagogu.
Informimi	- Prezantimi i përvojave praktike nga zbatimi i vlerësimit formativ në nivel të aktiveve profesionale; - format për informimin e prindit: *formale - takime me prindër, fletushka, përshkrime me kartela njoftimi; *joformale - komunikim, shënime; - takime individuale me prindërit e nxënësve që arrijnë nivele të larta dhe të ulëta; - informim në vetëqeverisjen lokale / analiza dhe raporte/.	Gjatë vitit Takimet formale do të realizohen së paku 4 herë gjatë vitit	
Vlerësimi	- Rezultate krahasuese nga arritjet e nxënësve / analizë e notave përmbledhëse gjysmëvjetore dhe vjetore; - anketë me mësimdhënësit dhe nxënësit për efektin e zbatimit të vlerësimit formativ mbi të nxënit.	Maj–qershor	

Shtojca 17: Programi për realizimin e garave të nxënësve për vitin 2026/2027

Garat paraqesin segment të rëndësishëm të procesit edukativo-arsimor në shkollë. Përmes garave nxënësit dhe mësimdhënësit arrijnë qëllime në drejtim të avancimit të njohurive të atyre nxënësve që janë gjithmonë të gatshëm të mësojnë më shumë, të fitojnë përvoja të reja dhe ta zbatojnë në praktikë atë që kanë mësuar.

Mësimdhënësit e ngarkuar me zbatimin, organizimin ose pjesëmarrjen në gara i përzgjedhin nxënësit që janë pjesëmarrës potencialë sipas kritereve të parapara paraprakisht. Këta mësimdhënës realizojnë aktivitete konkrete për përgatitjen e nxënësve:

- mësim shtesë;
- hulumtime;
- analiza;
- sigurim materialesh;
- mbështetje për nxënësit në çdo aspekt (motivim, këshillime, takime etj.).

Përmes garave në shkollë arrihen një sërë qëllimesh në drejtim të:

- Avancimit të njohurive të nxënësve me arritje të larta;
- Zhvillimit të aftësive për punë (gara në lëndët profesionale);
- Zhvillimit të aftësive për punë ekipore;
- Nxitjes së frymës garuese te nxënësit;
- Krijimit të mundësive për bashkëpunim me subjektet e përfshira.

Nr. rendor	EMËRTIMI	NIVELI	VENDI
1.	Automekaniku i ri evropian 2027	Garë ndërkombëtare	Shkup, nikoqir
2.	Ndihma e parë	Nivel qyteti	Shkup
3.	„Kengur“	Nivel qyteti	Shkup
4.	Garë në komunikacion dhe makineri	Garë shtetërore	Shkup
6.	„Mbrojtja nga zjarri“	Nivel qyteti	Shkup
7.	Histori	Garë shtetërore	Shkup
8.	Biznes	Garë shtetërore - „Ndërmarrje me përgjegjësi sociale“ Junior Achievement.	Shkup
9.	Automekanikë	Garë ndërkombëtare	Sarajevë, Bosnjë
10.	Garë aftësish	Shtetërore	Shkup

Shtojca 18: Programi për mënyrën dhe fushat e realizimit të vetëvlerësimit të QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit

Në bazë të nenit 29-a paragrafi 4 të Ligjit për arsimin e mesëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut përcaktohen mënyra dhe fushat e realizimit të vetëvlerësimit të shkollave të mesme:

- Realizimi i vetëvlerësimit nuk duhet të ndikojë në realizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë.
- Vetëvlerësimi zbatohet në fund të çdo viti të dytë mësimor.
- Në prill të vitit 2028 duhet të formohet grup pune për realizimin e Vetëvlerësimit të shkollës.
- Nga maji i vitit 2028, në QSHA „Boro Petrushevski“ duhet të zbatohet vetëvlerësimi dhe të përcaktohen qëllimet prioritare.

- Vetëvlerësimi i përfshin 8 fushat e mëposhtme:

  - Planet dhe programet mësimore;
  - Arritjet e nxënësve;
  - Të nxënit dhe mësimdhënia;
  - Mbështetja e nxënësve;
  - Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë;
  - Burimet;
  - Menaxhimi, udhëheqja dhe krijimi i politikave;
  - Bashkëpunimi me tregun e punës

- Shkolla e realizon vetëvlerësimin në tri faza:

	Faza	Aktivitetet	Realizuesit
1.	**Faza përgatitore**	✓ Formimi i grupeve të punës sipas fushave, të përbëra nga mësimdhënës, prindër dhe nxënës ✓ Përcaktimi i metodave, teknikave dhe instrumenteve për vetëvlerësim, si dhe sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e vetëvlerësimit ✓ Informimi i Këshillit arsimor, Këshillit të prindërve, nxënësve dhe Bordit të Shkollës për fillimin e Vetëvlerësimit të shkollës.	Koordinatori i vetëvlerësimit, personat përgjegjës sipas fushave dhe drejtori
2.	**Faza e realizimit**	✓ analiza e të dhënave dhe dokumentacionit, marrja dhe harmonizimi i gjetjeve dhe përgatitja e raporteve individuale dhe sipas fushave. ✓ Përgatitet projekt-raport i përbashkët për vetëvlerësimin e realizuar dhe përcaktohen qëllimet prioritare.	Grupet e punës sipas fushave dhe koordinatori i vetëvlerësimit
3.	**Faza e raportimit dhe miratimit**	– sigurohet qasja në projekt-raport për Këshillin arsimor, Këshillin e Prindërve, nxënësit, drejtorin e shkollës dhe Bordin e Shkollës	Drejtori, kryetari i Bordit të Shkollës dhe i Këshillit të prindërve, koordinatori për vetëvlerësim, bashkëpunëtori

		– dorëzimi me shkrim i vërejtjeve për projekt-raportin. – Përgatitja e raportit përfundimtar për vetëvlerësimin. – raporti i vetëvlerësimit miratohet nga Bordi i Shkollës (nuk është i detyrueshëm). – raporti i vetëvlerësimit publikohet në ueb-faqen e Shkollës dhe të Komunës.	profesional për informatikë

Koordinatore për vetëvlerësim,
Silvija Mitrevska Filipova

Shtojca 19: Procedura për realizimin e projekteve në shkollë

Aktiviteti	**Realizuesi**	**Koha e realizimit**
5.	Përdorimi i formave, metodave të punës dhe burimeve të përshtatura për mësimin në distancë, të cilat do të jenë lehtësisht të qasshme për nxënësit (prezantime, vendosje teksti, ese, incizim videosh, kuize, lidhje të përshtatshme, projekte, aktivitete hulumtuese etj.)	Mësimdhënësit e lëndëve	Vazhdimisht, sipas nevojës	Incizime, fotografi, prezantime, video të dokumentuara nga mësimdhënësit
6.	Theksimi para nxënësve i detyrueshmërisë së pjesëmarrjes, aktivitetit dhe komunikimit gjatë mësimit në distancë / të mësuarit nga shtëpia.	Mësimdhënësit	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit
7.	Organizimi i diskutimit konferencë me nxënësit përmes platformave elektronike me qëllim sqarimin e materialit, dhënien e udhëzimeve dhe sigurimin e	Mësimdhënësit dhe kujdestarët e klasave	Vazhdimisht, sipas nevojës	Incizime dhe fotografi nga lidhjet konferencë me nxënësit

	informacionit kthyes për punën e realizuar.			
8.	Mbajtja e dosjes elektronike për çdo nxënës me qëllim vlerësimin formativ më efikas në kushtet e mësimit në distancë / të mësuarit nga shtëpia.	Mësimdhënësit	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja elektronike e nxënësit
9.	Futja e evidencës elektronike të përmbajtjeve mësimore dhe notave në e-Ditar.	Mësimdhënësit dhe kujdestarët e klasave	Vazhdimisht, sipas nevojës	Evidencë në e-Ditar
10.	Qasshmëria e Shërbimit Profesional për mbështetje psikologjike, sociologjike dhe pedagogjike të nxënësve gjatë periudhës së mësimit në distancë / të mësuarit nga shtëpia.	Psikologu, sociologu, pedagogu	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit
11.	Nëse mësimdhënësi është i penguar të zhvillojë mësim në distancë / mësim nga shtëpia, ta njoftojë me kohë Drejtorinë e shkollës.	Mësimdhënësit dhe kujdestarët e klasave	Deri më 15.8 të vitit vijues	Deklaratë me shkrim
Nr. rendor	**Përgjegjësitë e nxënësit**	**Personat përgjegjës**	**Koha e realizimit**	**Treguesit**
1.	Prani e detyrueshme dhe qasje aktive në lidhjet konferencë të caktuara paraprakisht nga mësimdhënësit.	Të gjithë nxënësit	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit
2.	Përmbushja me kohë e detyrave të dhëna nga mësimdhënësit.	Të gjithë nxënësit	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit
3.	Qasje interaktive dhe parashtrim i lirë i pyetjeve për përmbajtjet që nuk janë mjaftueshëm të qarta.	Të gjithë nxënësit	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit
4.	Qëndrim i përgjegjshëm në komunikimin me mësimdhënësit e lëndëve dhe kujdestarët e klasave	Të gjithë nxënësit	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit
Nr. Numri	**Përgjegjësitë e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore**	**Personat përgjegjës**	**Koha e realizimit**	**Treguesit**
1.	Bashkëpunim i vazhdueshëm me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe prindërit e tyre.	Nxënësit, mësimdhënësit e lëndëve, kujdestarët e klasave, prindërit, edukatorët	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit

		specialë, ekipi inkluziv		
2.	Përfshirja e nxënësve në mësimin e rregullt në distancë me përmbajtje të përshtatura sipas nevojave të tyre individuale.	Mësimdhënësit e lëndëve, kujdestarët e klasave, prindërit, edukatorët specialë, ekipi inkluziv	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit sipas PIA-së së përshtatur dhe të rishikuar
3.	Angazhim shtesë i mësimdhënësve për t'iu përgjigjur nevojave individuale të nxënësve (biseda intensive me telefon, Viber, e-mail, me prindërit dhe shërbimet në Shkollë)	Mësimdhënësit e lëndëve, kujdestarët e klasave, prindërit, edukatorët specialë, ekipi inkluziv	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit sipas PIA-së së përshtatur dhe të rishikuar
4.	Angazhim shtesë i mësimdhënësve për gjetjen e metodologjisë së përshtatshme për mësim në distancë / të mësuarit nga shtëpia (dërgimi i lidhjeve të përshtatshme për të nxënë, videove, lidhjeve konferencë, prezantimeve të shkurtra, ushtrimeve etj.)	Mësimdhënësit e lëndëve, kujdestarët e klasave, prindërit, edukatorët specialë, ekipi inkluziv	Vazhdimisht, sipas nevojës	Incizime dhe fotografi si dëshmi për aktivitetet e realizuara me nxënësit, dosja e nxënësit
5.	Qasshmëria e Shërbimit Profesional për mbështetje psikologjike, sociologjike dhe pedagogjike të nxënësve gjatë periudhës së mësimit në distancë / të mësuarit nga shtëpia.	Psikologu, sociologu, pedagogu	Vazhdimisht, sipas nevojës	Dosja e nxënësit

Shtojca 30: Tabela e strukturës organizative

Organizimi i burimeve njerëzore sipas sektorëve

Vendi i punës	Arsimi
I. Shërbimet e përbashkëta	
Drejtori	Inxhinier i diplomuar i makinerisë
Ndihmësdrejtori për hulumtim, trajnim dhe zhvillim	Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës
Sekretar	Jurist i diplomuar
Bashkëpunëtor profesional për teknikë kompjuterike	Inxhinier i diplomuar i informatikës
Kontabiliteti	Udhëheqës me arsim të lartë të drejtimit ekonomik dhe arkëtar me arsim të mesëm
Administrata	referent për çështje të nxënësve, sekretar teknik – arsim i lartë dhe i mesëm
Shërbimi teknik	Ekonom, mirëmbajtës, roje, magazinier, punëtor i kualifikuar dhe punonjëse të higjienës / arsim i mesëm, fillor
II. Arsimi i nxënësve të rregullt dhe me korrespondencë	
Ndihmësdrejtori për mësim	Doktor i shkencave të makinerisë
Udhëheqës i mësimit teorik	Arsim i lartë, kualifikim pedagogjik shtesë dhe provim profesional
Koordinatorët e mësimit praktik	Arsim i lartë
Udhëheqës i fushës mësimore	Arsim i lartë, kualifikim pedagogjik shtesë dhe provim profesional
Shërbimi profesional	sociolog, psikolog, pedagog, edukator special, bibliotekar – arsim i lartë
Mësimdhënës të mësimit teorik	Arsim i lartë, kualifikim pedagogjik shtesë dhe provim profesional
Mësimdhënës të mësimit praktik	Arsim i lartë, i mesëm, specialistik, i lartë – kualifikim pedagogjik shtesë dhe provim profesional (10)
III1. Autoshkollë me autodrom	
Udhëheqës	Fakulteti i Komunikacionit
Instruktor	Arsim specialistik
Ligjërues	Fakulteti i Komunikacionit
Referent	Arsim i mesëm
III2. (STK)	
Udhëheqës	Fakulteti i Komunikacionit
Kontrollues	Arsim specialistik
Ekzaminues	Fakulteti i Makinerisë
Referent	Arsim i mesëm
III3. Shërbimi teknik	
Udhëheqës	Inxhinier i diplomuar i makinerisë
Zëvendës udhëheqës	Inxhinier i diplomuar i makinerisë
Menaxher i cilësisë	Inxhinier i diplomuar i komunikacionit
Referent	Inxhinier i diplomuar i komunikacionit
Ekzaminues	Inxhinier i diplomuar i makinerisë

Shtojca 31: PROGRAMI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLTARIT TË KARRIERËS

1. HYRJE DHE BAZA LIGJORE

Programi vjetor i punës së këshilltarit të karrierës për vitin shkollor 2026/2027 është përpunuar në përputhje me:

- Nenin 31-b të Ligjit për arsimin e mesëm;
- Rregulloren për mënyrën e këshillimit në karrierë dhe përzgjedhjen e këshilltarit të karrierës së nxënësve;
- Konceptin për arsimin dhe aftësimin profesional në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Programin vjetor të punës së ASUC-së „Boro Petrushevski“ – Shkup.

Programi paraqet një dokument operacional i cili përcakton qëllimet, aktivitetet e planifikuara, metodat e punës, dinamikën kohore dhe rezultatet e pritshme në procesin e informimit, orientimit dhe këshillimit në karrierë të nxënësve.

2. QËLLIMET E PROGRAMIT

2.1. Qëllimi kryesor:

Mundësimi i mbështetjes sistematike dhe orientimit në karrierë të nxënësve për identifikimin e potencialeve personale, zhvillimin e aftësive për karrierë dhe marrjen e vendimeve të informuara për arsimimin, aftësimin e mëtejshëm ose përfshirjen e drejtpërdrejtë në tregun e punës.

2.2. Qëllimet specifike:

1. Mbështetja e nxënësve të viteve përfundimtare të treta (III) dhe të katërta (IV), si dhe e nxënësve të viteve më të ulëta, në identifikimin e interesave, aftësive dhe vlerave të tyre profesionale.
2. Trajnimi për krijimin e CV-së profesionale (biografisë), letrës së motivimit dhe përgatitjen për intervistë pune.
3. Zhvillimi i aftësive të buta (komunikimi, puna në ekip, të menduarit kritik dhe marrja e vendimeve).
4. Forcimi i bashkëpunimit me sektorin e biznesit, kompanitë lokale dhe partnerët socialë (arsimi dual), fakultetet dhe Agjencinë e Punësimit (AVRSM).
5. Krijimi dhe mirëmbajtja e një sistemi për evidentimin dhe ndjekjen e rrugëtimit në karrierë të maturantëve (baza Alumni).

3. QËLLIMI DHE PËRFSHIRJA E GRUPIT

Programi përfshin të gjithë nxënësit e shkollës, me theks të veçantë te nxënësit e viteve përfundimtare të treta (III) dhe të katërta (IV) të profileve të mëposhtme të komunikacionit, makinerisë dhe elektroteknikës:

- Teknik i komunikacionit rrugor
- Teknik i transportit dhe spedicionit
- Teknik i makinerisë për automjete motorike
- Teknik për automjete me repart alternativ
- Drejtues i automjetit motorik
- Automekanik
- Mekanik i karrocerisë
- Montues i motorëve dhe automjeteve motorike
- Autoelektronicist

(Aktivitetet realizohen në të dyja gjuhët mësimore – në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.)

4. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA DHE DINAMIKA KOHORE

- **Shtator 2026:** Promovimi i këshillimit në karrierë para nxënësve dhe prindërve; realizimi i pyetësorëve për vlerësimin fillestar të interesave të maturantëve; hartimi i Planit Vjetor dhe harmonizimi me ekipin profesional.
  (Metodat: pyetësorë, prezantime, biseda individuale.)
- **Tetor 2026:** Punëtori për vetënjohje: „Kush jam unë – interesat, aftësitë dhe vlerat personale“; fillimi i ciklit të këshillimeve individuale për karrierë; pjesëmarrje në trajnime për këshilltarët e karrierës (MASH/QAPT).
- **Nëntor 2026:** Hartimi/përditësimi i planeve dhe profileve individuale të karrierës për çdo nxënës; përdorimi i mjeteve digjitale dhe të standardizuara për vlerësim; organizimi i informimit të prindërve lidhur me rrugët e karrierës.
- **Dhjetor 2026:** Konsultime individuale me nxënësit e pavendosur; vlerësimi i rezultateve të arritura në gjysmëvjetorin e parë; përgatitja e Raportit Gjysmëvjetor për punën e këshilltarit të karrierës.
- **Janar 2027:** Analiza e nevojave të maturantëve për gjysmëvjetorin e dytë; sesione informuese për mundësitë e arsimit të lartë dhe bursat; planifikimi i bashkëpunimit me sektorin e biznesit për gjysmëvjetorin e dytë.
- **Shkurt 2027:** Punëtori për zhvillimin e aftësive të buta (komunikim, punë në ekip, etikë profesionale); realizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me universitete (IBU, UKIM, UMT etj.).
- **Mars 2027:** Vizita dhe pjesëmarrje në aktivitete të karrierës, panaire të karrierës dhe konferenca IT/teknike; ligjërata informuese për profesionet deficitare dhe tregun e punës në fushën e komunikacionit dhe makinerisë.
- **Prill 2027:** Trajnim dhe ushtrime praktike: hartimi i CV-së, letrës së motivimit dhe përgatitja për intervistë; organizimi i vizitave edukative në fakultete, kompani-partnere në arsimin dual dhe Dita e Hapur e shkollës, e realizuar më 22.04.2026.
- **Maj 2027:** Konsultime individuale përfundimtare me maturantët për zgjedhjen e rrugës arsimore ose profesionale; plotësimi i instrumentit/bazës së detyrueshme për ndjekjen e maturantëve.
- **Qershor 2027:** Analiza e të dhënave të mbledhura për orientimin në karrierë të maturantëve; përgatitja e Raportit të plotë Vjetor për punën e këshilltarit të karrierës dhe dorëzimi i tij në MASH / QAPT.

5. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET

Gjatë vitit shkollor 2026/2027, këshilltari i karrierës do të realizojë bashkëpunim të vazhdueshëm me:

1. Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Qendrën për Arsim dhe Aftësim Profesional (QAPT) – pjesëmarrje në trajnime, shpërndarje të informacionit dhe dorëzim të raporteve.
2. Institucionet e arsimit të lartë (Fakultetin e Makinerisë, Fakultetin e Komunikacionit, UMT, IBU dhe të tjera) – organizimi i prezantimeve dhe vizitave.
3. Komunitetin e biznesit dhe kompanitë – kompani të komunikacionit, logjistikës, servisit dhe kapaciteteve industriale (partnerë në arsimin dual).
4. Agjencinë e Punësimit (AVRSM) – informim për masat për punësimin e të rinjve.
5. Prindërit dhe komunitetin lokal – mbështetje këshilluese në procesin e marrjes së vendimeve për karrierën.

6. REZULTATET E PRITSHME

- Të përfshihen 107+ maturantë në procesin e informimit dhe këshillimit për karrierë.
- Të hartohen plane individuale të karrierës dhe CV/ letra motivimi profesionale për të gjithë nxënësit e klasave përfundimtare.
- Të rritet informimi i nxënësve për mundësitë e punësimit dhe studimit.
- Të realizohen së paku 3 vizita edukative/pjesëmarrje në aktivitete të karrierës dhe fakultete.

Është krijuar dhe përditësuar një bazë të dhënash elektronike për monitorimin e zhvillimit të karrierës së maturantëve

Këshilltare e karrierës:

Eleonora Beqiri

Shtojca 32: Program për trajnim për vetëmbrojtje

Me këtë program përcaktohet mënyra e zbatimit të trajnimit për vetëmbrojtje në QSHA „Boro Petrushevski“ të Qytetit të Shkupit, në përputhje me Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të trajnimit për vetëmbrojtje në institucionet arsimore, të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, në pajtim me drejtorin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr. 139, datë 10.7.2025).

Rregullorja për trajnimin për vetëmbrojtje përfshin tema mësimore që lidhen me: fatkeqësitë natyrore (tërmete, përmbytje, rrëshqitje të dheut, ortekë dhe grumbullime dëbore, akull, breshër,

thatësirë – të cilat me forca natyrore të pakontrolluara rrezikojnë mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve, të mirat materiale, botën shtazore dhe bimore dhe trashëgiminë kulturore); fatkeqësi të tjera (zjarre, aksidente të mëdha në komunikacionin rrugor, hekurudhor dhe ajror, aksidente në miniera, aksidente industriale të shkaktuara nga shpërthime dhe shkaqe të tjera tekniko-teknologjike, reshje radioaktive, pluhur dhe depozitime radioaktive, derdhje të naftës dhe derivateve të naftës dhe kimikateve të tjera helmuese, shpërthime të gazrave, lëngjeve dhe gazrave të ndezshme, si dhe materialeve të tjera të djegshme që me ajrin krijojnë përzierje shpërthyese dhe materiale të tjera shpërthyese në përmasa më të mëdha).

Nxënësit, përmes aktiviteteve të realizuara të trajnimit për vetëmbrojtje, duhet të fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime lidhur me fushat dhe përmbajtjet e mëposhtme:

- njohja dhe kuptimi i nocioneve dhe llojeve themelore të rreziqeve natyrore, tekniko-teknologjike dhe rreziqeve të tjera;
- njohja e shkaqeve, karakteristikave dhe pasojave të mundshme të ngjarjeve të ndryshme me rrezik;
- zbatimi i masave parandaluese dhe operative për mbrojtje dhe shpëtim personal dhe kolektiv;
- njohja me mjetet dhe pajisjet që përdoren gjatë mbrojtjes dhe shpëtimit;
- zhvillimi i aftësive për reagim adekuat përmes pjesëmarrjes në aktivitete praktike, simulime dhe ushtrime për veprim në situata me rrezik.

Njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet nga këto fusha dhe përmbajtje realizohen në përputhje me programet mësimore dhe Programin vjetor të punës së shkollës, dhe pjesërisht tashmë janë zbatuar në disa programe mësimore të lëndëve profesionale dhe mësimit praktik që zhvillohen në shkollën tonë. Temat e parashikuara në këtë program për trajnim për vetëmbrojtje, mësimdhënësit i kanë planifikuar në planifikimet vjetore për realizimin e programeve mësimore, aty ku ekziston mundësia, si dhe gjatë realizimit të aktiviteteve jashtëmësimore.

QSHA „Boro Petrushevski“ e Qytetit të Shkupit planifikon realizimin e përmbajtjeve dhe aktiviteteve për trajnim për vetëmbrojtje, me përfshirjen e aspekteve teorike dhe praktike gjatë vitit shkollor, si:

1. Prezantim për zbatimin e masave parandaluese të mbrojtjes në përputhje me Ligjin për siguri dhe shëndet në punë;
2. Prezantim për dhënien e ndihmës së parë;
3. Pjesëmarrje në gara të qytetit për dhënien e ndihmës së parë;
4. Ushtrim për evakuim.

Për realizimin e disa prej këtyre temave, Shkolla bashkëpunon me institucionet kompetente, si: Brigada Territoriale e Zjarrfikësve e Qytetit të Shkupit, DMSH, QMK etj.

Shtojca 33: Program për edukimin antikorrupsion të nxënësve

Me zhvillimin e proceseve demokratike në Republikën e Maqedonisë së Veriut u paraqit nevoja për luftimin e dukurive negative në shoqëri. Ndër këto dukuri është edhe korrupsioni në të gjitha sferat shoqërore, por ende nuk ekziston një mënyrë më e organizuar për çrrënjosjen e tij. Për këtë arsye, me këtë qëllim futet edukimi antikorrupsion edhe në shkollat e mesme, në mënyrë që nxënësit të mund ta njohin atë si dukuri negative shoqërore dhe të mos e pranojnë si mënyrë sjelljeje në jetën e përditshme.

Edukimi i qytetarëve është njësoj i rëndësishëm për të gjithë, por është më së miri nëse si grup të synuar i zgjedhim nxënësit e shkollave të mesme, të cilët mësojnë si të bëhen qytetarë aktivë,

mësojnë për demokracinë dhe si t'i praktikojnë vlerat e saj pozitive. Në arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut zhvillohet vetëdija për demokracinë përmes disa lëndëve mësimore, siç është lënda Edukim qytetar.

Projekti „Edukimi antikorrupsion për nxënësit e shkollave të mesme" ka për qëllim të krijojë një sistem vlerash që do ta ndryshojë kulturën aktuale të pranimit të korrupsionit dhe do t'i promovojë përfitimet nga qeverisja dhe sjellja e mirë. Duke zëvendësuar shprehitë dhe mesazhet e këqija me të mira dhe duke theksuar shembujt pozitivë, nxënësi i përfshirë në projekt do të mund ta njohë korrupsionin dhe të mbrohet nga kjo dukuri negative shoqërore.

Me moton „Korrupsioni – e pret degën mbi të cilën je ulur" shpjegohet se korrupsioni nuk njeh gjini, fe, kombësi, profesion, moshë, kufij apo nivel arsimimi, duke theksuar se ai është pjesë negative e së sotmes dhe se duhet të mbrohemi prej tij.

Qëllimet që përfshin programi për edukimin antikorrupsion, kushtuar nxënësve të shkollave të mesme, janë që ata të njihen me nocione të caktuara, përkatësisht përmes aktiviteteve të caktuara të kuptojnë korrupsionin dhe antikorrupsionin, të analizojnë situata, persona dhe ngjarje të lidhura me korrupsionin, të vendosen në situata të ndryshme dhe, përmes përvetësimit të materies, të bëhen qytetarë aktivë që do të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë moderne demokratike.

Programi për edukimin antikorrupsion të nxënësve të shkollës do të përfshijë:

- ligjërata për njohjen e nxënësve me nocionet, mundësitë për mbrojtje dhe veprim parandalues ndaj aktiviteteve korruptive;
- punëtori për edukimin antikorrupsion të nxënësve, përmes të cilave ata do të vendosen në situata ku do të marrin pjesë aktivisht;
- plotësimin e pyetësorëve nga nxënësit para fillimit të projektit dhe pas përfundimit të tij;
- njohjen e publikut më të gjerë me aktivitetet që lidhen me luftën kundër korrupsionit përmes punës së nxënësve;
- organizimin e një gare për nxënësit për krijimin më të mirë lidhur me edukimin antikorrupsion;
- edukimin antikorrupsion të mësimdhënësve që do ta zbatojnë projektin në shkollat fillore, por edhe të atyre që punojnë çdo ditë me nxënësit;
- ftesën dhe pjesëmarrjen e personave të përfshirë në luftën kundër korrupsionit.

Përmbajtja	**Qëllimet**	**Lloji i aktivitetit**	**Aktivitetet**	**Koha e realizimit**
Njohuri paraprake për korrupsionin dhe antikorrupsionin	- Të evidentohen njohuritë paraprake të nxënësve	Pyetësor për nxënësit	Plotësimi i pyetësorit nga nxënësit	Gjysmëvjetori i parë
Nxënësit kundër korrupsionit	- Të njihen me nocionet korrupsion, antikorrupsion, integritet, presion shoqëror, etikë; - të dinë format në të cilat mund të paraqitet korrupsioni dhe mënyrën e parandalimit dhe mbrojtjes prej tij; - të kuptojnë ndikimin e dëmshëm të korrupsionit në shoqëri	punëtori	Aktivitet gojor Diskutim Ligjëratë e shkurtër	
Fitimi i njohurive të përgjithshme	- Të njihen me nocionet korrupsion,	Ligjëratë dhe ushtrime		

	antikorrupsion, integritet, presion shoqëror, etikë; - Të dinë format në të cilat mund të paraqitet korrupsioni dhe mënyrën e parandalimit dhe mbrojtjes prej tij; - Të kuptojnë ndikimin e dëmshëm të korrupsionit në shoqëri. - Të kuptojnë rolin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mekanizmat përmes të cilëve vepron.			
Shkaqet dhe pasojat e korrupsionit		Ligjëratë dhe ushtrime	Aktivitet aktivitet, Diskutim, ligjëratë e shkurtër e shkurtër	Prezantim PowerPoint; diskutim; fjalëkryq
Luftë aktive kundër korrupsionit	- Të njihen me kuptimin e „rezistencës ndaj presionit shoqëror“; - të dinë format në të cilat mund të paraqitet korrupsioni dhe mënyrën e parandalimit dhe mbrojtjes prej tij; - të njohin mekanizmat për parandalimin e korrupsionit; - të kuptojnë ndikimin e dëmshëm të korrupsionit në shoqëri	punëtori	Aktivitet aktivitet, ligjëratë e shkurtër diskutim	Gjysmëvjetori i dytë
Luftë aktive kundër korrupsionit: postera	- Të vendosen në situata ku do të kenë rol aktiv, përmes të cilit do të kuptojnë antikorrupsionin dhe nevojën për edukim; - Të vendosen në rolin e qytetarëve aktivë që do të kontribuojnë në zhvillimin e kulturës	punëtori		

	qytetare në shoqërinë bashkëkohore.			
Vërtetimi i njohurive për korrupsionin dhe antikorrupsionin	- Të vërtetohen njohuritë e nxënësve; - Të shihet nëse nxënësit kanë mësuar nga projekti „Programi për edukimin antikorrupsion të nxënësve“	Pyetësor për nxënësit dhe aktivitete për përsëritje	Plotësimi i pyetësorit nga nxënësit	

1. **Nocione**

Korrupsion, antikorrupsion, integritet, etikë, presion social, mekanizma për parandalimin e korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, para, dhurata, veshje, ushqim, shërbime.

2. **Shpjegimi i nocioneve**

Korrupsioni për shoqërinë paraqet të njëjtën gjë si krimbi në mollë. Ai anashkalon ndershmërinë dhe drejtësinë dhe favorizon ata që, me ndihmën e parave ose duke kryer shërbime të tjera, „blejnë“ nota në shkollë, vend në ekipin shkollor, një vend pune më të mirë ose një pozitë më të lartë shoqërore. Edhe pse ekzistojnë njerëz që me dijen, punën, angazhimin, shkathtësinë dhe aftësitë e tyre janë më të mirë dhe sipas të gjitha rregullave e meritojnë, për shkak të të lartpërmendurave nuk mund ta marrin atë që dëshirojnë.

Antikorrupsioni paraqet aktivitet ose luftë të orientuar drejt pamundësimit të korrupsionit, përkatësisht luftë për barazi për të gjithë. Në arsim, vlerësimi i njohurive bëhet publikisht gjatë orës, para të gjithë nxënësve. Secili ka të drejtë të dijë se cila notë merret sipas numrit të pikëve në test, secili mund të kërkojë dhe të ketë qasje në gabimet e veta në punën me shkrim ose, me fjalë të tjera, secili mund të kërkojë trajtim të barabartë nga mësimdhënësi dhe shoqëria. Ndër të tjera, këto janë masa antikorrupsion.

Integriteti tregon gatishmërinë e individit për t'iu kundërvënë ose për
mos e pranuar të keqen. Me fjalë të tjera, për individin që është rezistent ndaj së keqes themi se është person me integritet.

Etika paraqet qëndrimin personal ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me të mirën dhe të keqen. Për atë që është gjithmonë i gatshëm ta zgjedhë të mirën si mënyrë dhe stil personal të jetesës, sjelljes **dhe komunikimit, themi se është etik ose njeri me vlera dhe cilësi të larta morale.**

Presioni social krijohet nga njerëzit e rrethit të afërt dhe më të gjerë, si rezultat i kulturës, shprehive, zakoneve dhe ligjeve në shoqëri. Ky presion përjetohet si një lloj pritjeje nga mjedisi që individi të bëjë diçka ose të heqë dorë nga diçka si rezultat i faktorëve të përmendur.

Mekanizmat për parandalimin e korrupsionit janë ato institucione dhe organe në shtet që kanë të drejtë dhe detyrë të ndërmarrin masa për zbulimin e korrupsionit, gjetjen, kapjen dhe ndëshkimin adekuat të personave të korruptuar.

Ato janë Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, policia, prokuroria publike dhe gjykatat. Më e rëndësishmja është bashkëpunimi i tyre me qytetarët.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është ekip profesionistësh që planifikojnë masa parandaluese për parandalimin e korrupsionit dhe, me dokumentet që miratojnë, i obligojnë të gjitha institucionet në shtet të zbatojnë masa antikorrupsion.

Paratë janë mjet për blerjen e produkteve, ndërsa në raste të caktuara (korruptive) edhe për „blerjen“ e notave, vendit të punës ose një pozite më të lartë në shoqëri.

Dhuratat paraqesin të mira materiale ose jomateriale që më së shpeshti jepen në shenjë vëmendjeje, por në korrupsion pasqyrojnë një vlerë – që dikush të bëjë diçka për individin që ai nuk e meriton, ose t'i japë diçka që nuk i takon. Si të mira materiale mund të përmendim paratë, veshjet, ushqimin, parfumet dhe gjithçka tjetër që është e prekshme.

Në të mirat jomateriale përfshihet një lloj shërbimi që do t'i mundësojë një personi të përparojë më shpejt, të marrë diçka që nuk i takon ose që nuk guxon ta ketë.

Bartësit e edukimit:
Violeta Kralevska
Kastriot Kasapi

Shtojca 34: Plani dhe programi vjetor për punën e Këshillit të Nxënësve pranë QSHA „BORO PETRUSHEVSKI“ të Qytetit të Shkupit

Këshilli i nxënësve është organ përfaqësues i nxënësve në shkollë. Ai përfaqëson interesat e nxënësve, merr pjesë në marrjen e vendimeve për çështje që kanë të bëjnë me jetën dhe punën e nxënësve dhe kontribuon në zhvillimin e kulturës demokratike në shkollë.

Detyrat	Aktivitetet	Koha	Realizuesit	Treguesit
Mbledhja konstituive	Zgjedhja e kryetarit, zëvendësit, sekretarit, miratimi i programit	Shtator	Koordinatori, nxënësit	Procesverbal, këshill i formuar
Mbledhje	Mbledhje të rregullta mujore	Çdo muaj	Këshilli i Nxënësve	Procesverbale

Iniciativa të nxënësve	Mbledhja e propozimeve dhe realizimi i tyre	Gjatë vitit	Këshilli, kujdestarët e klasave	Numri i iniciativave
Punëtori	Udhëheqje, komunikim, të drejta dhe obligime	Tetor–Maj	Shërbimi profesional	Vlerësimi
Shënimi i datave të rëndësishme	Organizimi i punëtorive, përgatitja e posterave	Gjatë vitit	Këshilli, Shërbimi profesional	Aktivitete të realizuara, materiale të përgatitura, përfshirje e rritur e nxënësve, fotografi
Aksione ekologjike	Rregullimi i mjedisit shkollor	Prill	Nxënësit, mësimdhënësit	Fotografi
Aktivitete parandaluese	Dhuna, varësitë, shëndeti mendor	Gjatë vitit	Shërbimi profesional	Anketa
Përcjellja dhe analiza e suksesit shkollor	Shqyrtimi dhe analiza e suksesit pas çdo tremujori, diskutim për shkaqet e rezultateve të arritura dhe masat për përmirësimin e suksesit dhe rregullsisë	Pas çdo tremujori	Këshilli, Shërbimi profesional	Përfundime, propozime dhe procesverbale të miratuara; përmirësim i suksesit shkollor dhe rregullsisë
Vlerësimi	Raport dhe analizë	Maj–Qershor	Koordinatori	Raporti vjetor

Shtojca 35: Plani vjetor i punës së Avokatit të Nxënësve

1. Qëllimet kryesore

- **Mbrojtja e të drejtave** të nxënësve në shkollë, në punëtoritë shkollore dhe gjatë realizimit të mësimit praktik në kompani.
- **Edukimi** për të drejtat e punës, sigurinë në punë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.
- **Ndërmjetësimi** dhe zgjidhja paqësore e konflikteve (nxënës-mësimdhënës, nxënës-mentor në kompani, nxënës-nxënës).

2. Plani mujor i aktiviteteve

SHTATOR: Konstituimi dhe informimi

- **Zgjedhja dhe promovimi:** Zgjedhja e Avokatit të Nxënësve dhe zëvendësve të tij. Promovimi në rrjetet sociale të shkollës dhe në grupet shkollore Viber/Discord.
- **Fushata informuese „Të drejtat në klasë dhe në praktikë“:** Hartimi i një fletëpalosjeje digjitale që përcakton saktësisht të drejtat dhe detyrimet e nxënësve të shkollave të mesme profesionale (p.sh. e drejta për pajisje mbrojtëse të përshtatshme, orar i përcaktuar i praktikës, e drejta për kundërshtim ndaj notës).
- **Kanalet për raportim:** Vendosja e një „Kutije për ankesa dhe lëvdata“ fizike në hollin e shkollës, si dhe krijimi i një formulari anonim online (Google Forms) për raportimin e problemeve nga nxënësit që ndodhen jashtë shkollës.

TETOR: Siguria dhe të drejtat gjatë mësimit praktik

- **Monitorimi i praktikës:** Zbatimi i anketës së parë të shpejtë online: „A i kryejnë nxënësit gjatë praktikës te punëdhënësit detyrat përkatëse sipas profilit dhe a i kanë pajisjet e nevojshme mbrojtëse?“
- **Konsultime me partnerët socialë:** Takim me koordinatorin për mësim praktik në shkollë, me qëllim harmonizimin e protokolleve në rast të ankesave eventuale të nxënësve ndaj mentorëve në kompani.

NËNTOR: Lufta kundër dhunës dhe diskriminimit

- **Dita Botërore e Fëmijëve (20 nëntor):** Organizimi i punëtorive për dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve (bullizëm dhe bullizëm kibernetik), në bashkëpunim me psikologun e shkollës.
- **Fokusi te profesioni:** Diskutim dhe edukim për luftimin e stereotipeve gjinore në profesionet „tradicionalisht mashkullore“ ose „tradicionalisht femërore“ (p.sh. mbështetje për vajzat në sektorët teknikë ose për djemtë në drejtimet mjekësore/të kujdesit).

DHJETOR: Të drejtat gjatë vlerësimit dhe mbrojtja në punë

- **Të drejtat në fund të gjysmëvjetorit:** Sesione informuese për rregulloren e vlerësimit. Përkujtim i nxënësve për procedurat e kundërshtimit nëse konsiderojnë se janë dëmtuar gjatë përfundimit të notave.
- **Mbrojtja gjatë dimrit:** Ngritja e çështjes së ngrohjes së përshtatshme të punëtorive dhe kabineteve shkollore ku zhvillohet mësimi praktik.

JANAR: Edukim për tregun e punës

- **Përgatitja për punësim:** Organizimi i një ligjërate me temë „Të drejtat e punëtorëve sipas Ligjit për marrëdhëniet e punës“, në bashkëpunim me një ekspert juridik ose përfaqësues të sindikatës.
- **Temat**: Çfarë është kontrata e punës, sa është paga minimale, puna jashtë orarit dhe si të njihet shfrytëzimi i një punëtori të ri.

SHKURT: Shëndeti mendor dhe Dita e Këmishave Rozë

- **Parandalimi i stresit:** Punëtori për menaxhimin e stresit të shkaktuar nga ngarkesa e dyfishtë (mësimi + praktika fizike në kompani).
- **Dita e Këmishave Rozë:** Fushatë e madhe shkollore për tolerancë, mosdhunë dhe pranimin e dallimeve.

MARS: Trajtimi i barabartë dhe gjithëpërfshirja

- **Hulumtim anonim:** Zbatimi i një ankete me pyetjen: „A ekziston diskriminim i fshehtë ose favorizim i nxënësve nga ana e profesorëve apo punëdhënësve?“
- **Tryezë e rrumbullakët:** Prezantimi i rezultateve të anketës para Këshillit arsimor dhe Drejtorit, me propozim-masa për përmirësim.

PRILL: Të drejtat e gjeneratave përfundimtare (maturantëve)

- **Informimi për maturën dhe provimin profesional:** Paraqitje e qartë e të drejtave të nxënësve gjatë dhënies së maturës shtetërore, provimit shkollor ose provimit përfundimtar profesional (afatet, paraqitja e ankesave, qasja në teste).

MAJ: Takime procedurale dhe ndërmjetësim përfundimtar

- **Ndërmjetësimi gjatë notave përfundimtare:** Kujdestari intensive dhe biseda me nxënësit që përballen me probleme para përfundimit të vitit shkollor.
- **Pjesëmarrja në masat pedagogjike:** Prania e Avokatit të Nxënësve në mbledhjet ku vendoset për masa të rënda pedagogjike (përjashtim ose qortim), me qëllim që të sigurohet respektimi i plotë i së drejtës së nxënësit për t’u mbrojtur**.**

QERSHOR: Raporti dhe tranzicioni

- **Raporti vjetor:** Përgatitja e një raporti me shkrim me numrin e ankesave të pranuara, rasteve të zgjidhura dhe rekomandimeve për vitin e ardhshëm. Raporti i dorëzohet Drejtorit, Këshillit arsimor dhe Këshillit të Nxënësve.
- **Arkivimi:** Përgatitja e materialeve për dorëzimin e funksionit te Avokati i ardhshëm i Nxënësve.

3. Mjetet, materialet dhe burimet e nevojshme

Materialet dhe pajisjet:

- **Materiale fizike:** Kuti druri ose plastike me çelës, material zyrtar (letër, markerë, dosje), postera.
- **Mjete digjitale:** Qasje në faqen e internetit/rrjetet sociale të shkollës, Google Forms për paraqitje anonime, Canva për dizajnimin e fletëpalosjeve.

Burimet e mbështetjes dhe mjetet:

- **Mbështetja e shkollës:** Buxhet nga shkolla për shtypjen e broshurave dhe materialeve.
- Mbështetje profesionale: Bashkëpunim me Ekipin gjithëpërfshirës të shkollës, pedagogun dhe psikologun si mentorë në procesin e ndërmjetësimit.
- **Burime të jashtme**: Zyra e Avokatit të Popullit të RMV-së (Sektori për të Drejtat e Fëmijës), Unioni i Nxënësve të Shkollave të Mesme dhe organizata joqeveritare që ofrojnë trajnime falas për ndërmjetësim ndërmjet bashkëmoshatarëve dhe të drejtat e të rinjve.

Shtojca 36: Plani vjetor i punës së ekipit për integrim shkollor

Ky plan është në përputhje me standardet gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore, me fokus të veçantë në integrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësve nga mjedise sociale të cenueshme, si dhe nxënësve që përballen me barriera kulturore ose gjuhësore.

I. QËLLIMET DHE DETYRAT E EKIPIT

- **Gjithëpërfshirja holistike**: Krijimi i një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe stimulues për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga gjendja e tyre etnike, sociale ose shëndetësore.
- **Parandalimi i margjinalizimit:** Identifikimi në kohë i nxënësve që janë në rrezik nga izolimi social, dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve (bullizmi) ose braktisja e parakohshme e arsimit.
- **Kohezioni ndërkulturor:** Ndërtimi i urave të bashkëpunimit, respektit dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme në kuadër të shkollës së mesme.
- **Mbështetja në të nxënë:** Koordinimi me asistentët arsimorë, ndërmjetësuesit dhe profesorët për zbatimin e suksesshëm të Planeve Individuale Arsimore (PIA).

II. PARAQITJA TABELARE E AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA

Aktivitetet e planifikuara të ekipit	**Koha e realizimit**	**Rezultatet e pritshme**	**Personat përgjegjës për ndjekje (monitorim)**

1. Përgatitja dhe hartëzimi • Formimi i Ekipit për integrim shkollor. • Identifikimi i nxënësve që kanë nevojë për integrim (nxënës me aftësi të kufizuara, të kthyer nga jashtë vendit, nxënës në rrezik social).	• Shtator	• Ekip i konstituuar me role të qarta. • Bazë fillestare e të dhënave për nxënësit e krijuar.	• Drejtori i shkollës • Koordinatori i ekipit
2. Përshtatja psikosociale • Organizimi i "Ditëve të mirëseardhjes" dhe punëtorive njohëse për nxënësit e vitit të parë. • Koordinimi me asistentët arsimorë dhe ndërmjetësuesit për përshtatje më të lehtë në mjedisin shkollor.	• Shtator – Tetor	• Ulje e ankthit te nxënësit e rinj. • Komunikim i vendosur me sukses me mësimdhënësit.	• Psikologu i shkollës • Kujdestarët e klasave
3. Hartimi i programeve gjithëpërfshirëse • Pjesëmarrje në përgatitjen dhe rishikimin e PIA-së. • Sigurimi ose përgatitja e mjeteve të përshtatura mësimore dhe materialeve didaktike për nxënësit me nevoja specifike.	• Tetor – Nëntor	• Plane funksionale të PIA-së për çdo nxënës të synuar. • Kushte hapësinore dhe teknike të siguruara për punë.	• Shërbimi profesional (defektolog / pedagogu)
4. Ndërtimi i mbështetjes nga bashkëmoshatarët • Formimi i një rrjeti të "Nxënësve-mentorë" (mbështetje nga bashkëmoshatarët në mësim dhe socializim). • Realizimi i anketave për klimën në klasa dhe shkallën e pranueshmërisë.	• Nëntor – Janar	• Empati dhe solidaritet i zhvilluar ndërmjet nxënësve. • Zvogëlim i shenjave të izolimit nga bashkëmoshatarët.	• Bashkësia rinore / Parlamenti i nxënësve
5. Promovimi i multikulturalizmit • Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore, sportive dhe artistike që promovojnë bashkëjetesën dhe barazinë. • Punëtori kundër stereotipeve, paragjykimeve dhe gjuhës së urrejtjes.	• Shkurt – Mars	• Aktivitete multikulturore të realizuara. • Ndërgjegjësim i rritur për pranimin e dallimeve në shkollën e mesme.	• Mësimdhënësit e gjuhëve / artit figurativ / muzikës
6. Bashkëpunimi me familjet • Organizimi i takimeve edukative për prindërit me qëllim përfshirjen e tyre aktive në jetën shkollore. • Këshillimi i prindërve për tejkalimin e krizave familjare që ndikojnë te nxënësi.	• Mars – Prill	• Rritje e besimit të prindërve në sistemin shkollor. • Pjesëmarrje e rregullt në takimet prindërore.	• Ndërmjetësuesi arsimor • Psikologu
7. Vlerësimi dhe tranzicioni • Vlerësimi i suksesit të arritur dhe socializimit në fund të vitit. • Hartimi i raportit me rekomandime për orientim në karrierë ose kalim në vitin vijues.	• Maj – Qershor	• Portofola të përgatitur për përparimin. • Raporti Vjetor i miratuar nga Këshilli arsimor.	• Drejtori i shkollës • Koordinatori i ekipit

Shtojca 37: Plani vjetor i punës së Komisionit për përgatitjen dhe realizimin e maturës

I. QËLLIMET KRYESORE TË KOMISIONIT

- **Ligjshmëria dhe rregullsia:** Sigurimi i zbatimit ligjor, transparent dhe të rregullt të të gjitha pjesëve të provimeve të maturës.
- **Informimi:** Informimi në kohë dhe i saktë i maturantëve dhe mësimdhënësve për afatet, programet dhe materialet e provimit.
- **Përgatitja logjistike:** Organizimi i hapësirës, shpërndarja e testuesve dhe sigurimi i konfidencialitetit të materialeve të provimit.
- **Mbështetja në përgatitje:** Koordinimi me mësimdhënësit lëndorë për realizimin e mësimit përgatitor për maturantët.

II. PARAQITJA TABELARE E AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA SIPAS MUAJVE

Aktivitetet e planifikuara të komisionit	**Koha e realizimit**	**Rezultatet / produktet e pritshme**	**Personat përgjegjës për ndjekje**
1. Formimi i KMSh-së dhe informimi • Konstituimi i Komisionit të Maturës së Shkollës dhe ndarja e roleve. • Mbajtja e takimit të parë informues me maturantët dhe kujdestarët e klasave për konceptin e maturës.	• Shtator – Tetor	• Vendim i miratuar për formimin e KMSh-së. • Nxënësit të informuar për lëndët dhe strukturën e maturës.	• Drejtori i shkollës • Kujdestarët e klasave
2. Paraqitja e provimeve **• Përgatitja dhe shpërndarja e fletëparaqitjeve për maturë.** **• Kontrolli, futja dhe finalizimi i të dhënave në bazë (e-Ditari / baza e Qendrës Shtetërore të Provimeve).** **• Publikimi i listave preliminare të nxënësve të paraqitur.**	• Nëntor – Dhjetor	• Fletëparaqitje të plotësuara dhe të nënshkruara plotësisht nga nxënësit. • Bazë elektronike e saktë e kandidatëve të paraqitur sipas lëndëve.	• Sekretari i KSHM-së • Administratori i TI-së
3. Miratimi i temave për detyrën projektuese • Publikimi i listës së temave dhe mentorëve për Detyrën projektuese. • Paraqitja e temave nga nxënësit dhe verifikimi nga KMSh-ja. • Ndjekja e përgatitjes së detyrave projektuese.	• Dhjetor – Janar	• Listë e verifikuar e nxënësve, temave dhe mësimdhënësve-mentorë. • Proces i filluar i hulumtimit dhe shkrimit të projekteve.	• Kryetari i Komisionit të Maturës së Shkollës • Mësimdhënësit-mentorë
4. Organizimi i mësimit përgatitor • Koordinimi i orarit për mbajtjen e orëve plotësuese/përgatitore për lëndët e maturës. • Shpërndarja e programeve të provimit dhe shembujve të testeve nga viti i kaluar për ushtrime.	• Shkurt – Mars	• Fondi i orëve për përgatitje i realizuar. • Rritje e vetëbesimit të nxënësve për zgjidhjen e testeve.	• Ndihmësdrejtori • Aktivi i mësimdhënësve
5. Realizimi i Detyrës projektuese • Formimi i komisioneve shkollore prej tre anëtarësh për mbrojtjen e Detyrës projektuese. • Organizimi dhe realizimi i mbrojtjes së detyrave projektuese. • Evidentimi i notave në dokumentacionin zyrtar.	• Mars – Prill	• Detyra projektuese e përfunduar dhe e vlerësuar me sukses nga të gjithë maturantët. • Raporte të dorëzuara nga komisionet e mbrojtjes.	• Komisioni i Maturës së Shkollës • Komisionet për mbrojtje
6. Përgatitja operative për provimet • Përcaktimi dhe rregullimi i hapësirave për provim (salla, klasa). • Hartimi i renditjes së uljes së nxënësve (shifrat). • Caktimi i testuesve të shkollës dhe udhëzimi i tyre për rregullat e realizimit.	• Prill – Maj	• Hapësira të provimit të përgatitura sipas standardeve. • Orar i qartë për testuesit dhe nxënësit.	• I gjithë përbërja e KSHM-së • Mësimdhënës-testues
7. Realizimi i provimeve dhe vlerësimi • Pranimi, ruajtja e sigurt dhe	• Maj – Qershor	• Provimet janë realizuar qetë, pa incidente dhe parregullsi.	• KMSh • Vëzhgues të jashtëm / QSHP

shpërndarja e materialeve të provimit në ditën e provimeve. • Realizimi i provimeve të jashtme (shtetërore) dhe të brendshme. • Paketimi dhe dorëzimi i testeve në Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP).		• Materialet janë transportuar në mënyrë të sigurt.	
8. Rezultatet, ankesat dhe raporti përfundimtar • Publikimi i rezultateve paraprake të maturës. • Pranimi dhe përpunimi administrativ i ankesave eventuale nga nxënësit. • Hartimi i Raportit përfundimtar statistikor për suksesin në maturë.	• Qershor – Korrik	• Procedurat administrative për ankesat të përfunduara. • Raporti përfundimtar i miratuar nga Këshilli arsimor.	• Kryetari i KSHM-së • Drejtori

III. DETYRAT E ANËTARËVE KRYESORË TË KOMISIONIT TË MATURËS SË SHKOLLËS

1. **Kryetari (Drejtori):** Përgjigjet për rregullsinë e përgjithshme, sigurinë e materialeve, nënshkruan procesverbalet dhe udhëheq mbledhjet e komisionit.
2. **Sekretari:** Mban dokumentacionin e plotë me shkrim, përgatit listat, i fut të dhënat në softuer dhe komunikon me Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP).
3. **Administratori i TIK-ut / Anëtar:** Përgjigjet për mbështetjen teknike, gjenerimin digjital të shifrave dhe kodeve, si dhe përgatitjen e sistemeve kompjuterike për përpunimin e të dhënave.

DATA E PËRPUNIMIT DHE PERSONAT PËRGJEGJËS

PERIUDHA E PËRPUNIMIT:
Deri më 15.08.2026

INSTITUCIONI – PËRGJEGJËS PËR KRIJIMIN:
QSHA „Boro Petrushevski“ i Qytetit të Shkupit

PERSONI PËRGJEGJË:
Drejtori, Aleksandar Strezov

Programin e hartoi:
Aleksandar Strezov

Bashkëpunëtor:
Kristijan Petreski

Bashkëpunëtorët në përgatitjen e Shtojcave të Programit:

- Aleksandar Strezov
- Zekirija Zekiri
- Kristijan Petreski
- Kastriot Kasapi
- Koce Tapshanovski
- Iman Izeri
- Haki Fejzullai
- Agim Jusufi
- Zoki Stojmirov
- Violeta Kralevska
- Vevait Alimi
- Silvija Mitrevska-Filipova
- Elena Petrovska
- Sunchica Belinska-Andov
- Teuta Daci
- Lençe Tomova
- Aleksandar Jovanov
- Nikolçe Spasovski
- Jana Ivanovski

Përpunimi teknik:

- Kristijan Petreski
- Jonuz Sopa

Lekturoi:

Silvija Mitrevska-Filipova

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Jehona Asani

Data 27.8.2026
Shkup v.v.

Nënshkrimi i drejtorit

_____

Nënshkrimi i kryetarit të Bordit të Shkollës

_____

MIRATIMI I PROGRAMIT VJETOR

Programi vjetor për vitin shkollor 2026/2027 u propozua nga Këshilli arsimor, ndërsa u miratua nga Bordi i Shkollës me vendim nr. 02-1277/4, më 27.08.2026.

FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT VJETOR

1.9.2026